

Tetor 2020
Numri: 151
E përmuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.revistaetika.com

ETIKA

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den
Evropë: 7 Euro



NEVOJA PËR NJË MODEL




revistaetika



progresibotime

E çfarë mund të jetë tjetër
qëndrimi indiferent,
pandjenja dhe injorant përballë
mrekullive të pafundme
madhështore, që prej
grimcës më të vogël, e deri tek
trupi më i madh, prej botës
mikro, e deri në atë makro,
të cilat ndriçojnë më së miri
mendjen dhe zemrën,
përveçse një çoroditje
dhe falimentim i mendjes!?



Profeti (a.s.), thotë:

“Ditën e Kiametit asnjë rob
nuk do të bëjë qoftë edhe një hap
pa u pyetur se ku e ka kaluar jetën
e tij, se çfarë ka bërë me dijen e
tij, se ku e ka (tuar dhe shpenzuar
pasurinë e tij dhe se ku e ka
konsumuar trupin e tij.” (Tirmidhi,

Kiamet, 1/2417)

“Allahu i Madhëruar e do të riun e
pjekur, që nuk sillet si fëmijë, që
është drejtuar kah e mira dhe ka
braktisur dëshirat e kënaqësitë (e
ulëta të egos).” (Ahmed, IV, 151.)



I Dërguari i Allahut (a.s.), ishte njeriu që e zbotoi Islamit në formën më të mirëfilltë. **"I Dërguari i besoi asaj që iu zbrit..."** (Bekare, 285)

-Resulullahu (a.s.), është mbartësi i mesazhit hyjnor për te njerëzit e tjerë.

-Resulullahu (a.s.), është ai që ua ka dhënë të gjithë besimtarëve detyrën për ta mbartur Islamit te të tjerët duke u shprehur në Hytben e Lamtumirës: "Ata që gjenden këtu, le t'ua tregojnë fjalët e mia atyre që nuk janë prezentë."

Cilësinë e "mbrojtjes nga mëkatet" që e kanë pejgamberët, nuk e kanë njerëzit e tjerë. Por ata që janë në pozitën për të marrë përsipër përgjegjësinë e "predikimit të Islamit" apo "udhërrëfimit" duhet të largohen nga mëkatet që janë një lloj "papastërtie e zemrës" siç shprehet Resulullahu (a.s.).

Në këtë periudhë çdo mysliman me sjelljen e vet shfaq natyrën e tij pozitive apo negative për sa i përket çështjes së predikimit dhe udhërrëfimit. Njerëzit mund t'i shohin një e nga një myslimanët apo të gjithë umetin Islam dhe të vrapojnë drejt Islamit apo të largohen prej tij duke thënë: "Nëse ky qenka Islami."

Ndërsa cilësitë e tjera si sinqeriteti, besnikëria dhe zgjuarsia që duhet t'i kenë Pejgamberët, duhet t'i posedojnë patjetër edhe ata që e ndjejnë përgjegjësinë e udhërrëfimit.

Këtu mund të themi edhe këtë: Cilësia e të qenët shembull i mirëfilltë e të Dërguarit të Allahut (a.s.), është një sunet që duhet ta posedojnë edhe ata që ndjekin gjurmët e Pejgamberit.

Është e vërtetë se Kurani Fisnik, në të cilin përmendet qoftë shembulli i mirëfilltë i Resulullahut apo qofshin cilësitë që duhet t'i kenë besimtarët, në të gjitha kohërat ka vendosur para njerëzimit një portret të "cilësisë së besimtarit". Kur në Kuranin Fisnik flitet për pjekurinë e besimtarit, shumë herë nënvizohen dy cilësi:

-Ata që besojnë...

-Ata që bëjnë vepra të mira...

Besimi është vepër e zemrës. Ibadeti është marrëdhënia ndërmjet Allahut dhe robit. Cilësia e kësaj marrëdhënieje është në raport me thellësinë e besimit në zemër.

Ndërsa vepra e mirë është ana e besimtarit që interesohet për marrëdhëniet sociale. Njerëzit nuk mund ta shohin zemrën. Për rrjedhojë nuk mund ta shohin cilësinë e besimit dhe të adhurimit. Por gjërat që bëhen apo që nuk bëhen për sa i përket fushës së marrëdhënieve sociale, vlerësohen menjëherë.

Në suren Asr pas shprehjes "betohem në kohën", thuhet: "Njeriu me të vërtetë është në humbje." – dhe pastaj përmenden rastet e veçanta. Këto raste të veçanta radhiten nën katër pika:

-Ata që besojnë

-Ata që bëjnë vepra të mira

-Ata që këshillojnë për të vërtetën

-Ata që këshillojnë për durimin

E vërteta përbëhet nga të gjitha rregullat që ka sjellë Islami.

Tetor 2020

VITI: XIV

NUMRI: 151

BOTUESI

Shtëpia botuese "Progresi"

DREJTOR

Albert Halili

KRYEREDAKTOR

Alban Kali

REDAKTOR

Zija Vukaj

PËRKTHYES

Albert Halili

Fatmir Sulaj

Ilir Hoxha

DIZAJN

Bledar Xama

ADRESA

Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"

Shkodër; Shqipëri

MOBILE

+355 67 340 6182

E-MAIL

rev.etika@gmail.com

WEBSITE

www.progresibotime.com

KOSOVË

Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin

Prizren; Kosovë

Mob: +377 45 639 143

Prishtinë; Kosovë

Mob: +377 44 566 577

MAQEDONI

Drvarska 28; Stara Carsija

Skopje; Makedonija

Mob: +389 7145 6003

ABONIMI VJETOR

Shqipëri: 2000 lekë

Kosovë: 15 Euro

Maqedoni: 900 Denar

Evropë: 80 Euro

Ju bëjmë të ditur se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Koha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini t'i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese "Progresi" ose pranë zyrave të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.

Përmbajtja

Përpjekja për të kuptuar paradigmen islame
Idris Arpat

14




10

Etika e mëshirës
kundrejt të gjitha krijesave
Prof. dr. Sulejman Derin



Askush nuk është i vogël
Nuredin Jëldëz

22



18

34

Lumturia Familjare
Osman Nuri Topbash



- 5 Koha e shembujve të mirëfilltë
Ahmet Tashgetiren
- 8 Njeriu plekset nga njeriu
Dr. Adem Ergyl
- 12 Pas tyre nuk qau as qielli as toka
Ali Riza Temel
- 16 Thirrje për adhurim ndaj Zotit
Doç. dr. Mustafa Karabaxhak
- 18 Të drejtat e Kuranit kundrejt nesh
Xhafer Durmush
- 20 Dhënia përparësi umetit në mendime,
ndjenja dhe veprime
Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan
- 24 Si mund të jemi më të lumtur?
M. Ali Eshmeli
- 29 Pjekuria në predikim
Sami Byjkkajnak



42

Një Ajet - Një Hadith 32

Një lutje dhe një mallkim 40

Irfan Ezturk

Vigjilenca dhe nxitimi 42

Ahmet Zijlan

Si të shpëtojmë 48

nga kurthi i hedonizmit?

Ajnur Tutkun

Zjarri i zemrës 50

Fatih Garxhan

Përse nuk edukohen 54

njerëz cilësorë?

Ajdën Tallaj

Xhamia Aksa, amaneti i muslimanëve 56

Naim Drijaj

38




Në këtë botë kemi ardhur
për të shkuar në Ahiret
Rabia Brodbeck

Rënia dëshmor,
pozita më sublime pas profetisë
Doç. dr. Mustafa Karabaxhak

46





KOHA E SHEMBUJVE TË MIRËFILLTË

— Ahmet Tashgetiren —

Kur Allahu Teala e vendosi Muhamedin (a.s.), si një udhërrëfyes para njerëzimit, e cilësoi atë si “Shembulli i Bukur”. (Shik. Ahzab, 21)

Domethënë, ai krahas misionit “për t’i sjellë lajme njerëzimit nga Krijuesi” ka pasur edhe cilësinë “Shembulli i Bukur” për sa i përket anës së personalitetit. Kur i Dërguari i Allahut (a.s.), tregoi për pjekurinë e personalitetit të tij, tha: “*Mua më ka edukuar Zoti. Ai më ka dhënë një edukatë dhe kulturë të bukur.*” (Sujuti, Xhamiu’s-Sagir, I, 12.)

Domethënë se një njeri që do të dërgohej si një udhërrëfyes për njerëzimin, ishte vepër e “edukimit hyjnor”. Jurisprudenca islame i ka ndarë në pesë pika kryesore cilësitë e pejgamberëve: Mbrojtja nga mëkatet, zgjuarsia, sinqeriteti, besnikëria dhe predikimi. Cilësia e fundit prej këtyre pesë cilësive, domethënë predikimi, shpreh detyrat e pejgamberëve. Ata ua predikojnë njerëzve mesazhin që ua ka dërguar Allahu (xh.xh.). Ndërsa katër cilësitë e para kanë të bëjnë me cilësitë e personalitetit të prijesve të njerëzimit. Mbrojtja nga mëkatet, zgjuarsia, sinqeriteti, besnikëria...

Krahas këtyre vlerave personaliteti që duhet të gjenden te të gjithë pejgamberët, në Kuranin Fis-

nik flitet edhe për cilësi specifike të të Dërguarit të Allahut (a.s.). Për shembull thuhet: “*Me të vërtetë ti ke një moral të lartë.*” (Kalem, 4) Çfarëdo që mund të përfshijë përkufizimi i “moralit të lartë”, ai është personaliteti i të Dërguarit të Allahut (a.s.). Gjithashtu në Kuranin Fisnik thuhet: “*Ne të kemi dërguari (o Muhamed) vetëm si mëshirë për botët.*” (Enbija, 107) Pra, këtu bëhet fjalë për t’u dërguar vetëm si mëshirë për botët... Mbi të gjitha, aq sa përfshin “dimensioni i botëve”, aq ishte e gjerë mëshira e të Dërguarit të Allahut (a.s.).

Kur përshkruhen marrëdhëniet njerëzore të të Dërguarit të Allahut (a.s.), thuhet: “U solle butë kundrejt njerëzve.” Po ashtu theksohet edhe fakti që të mos ketë “zemër të ngurtë dhe natyrë të ashpër”. “*Në sajë të mëshirës së Allahut, u solle butësisht me ta (o Muhamed). Sikur të ishte i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje...*” (Al Imran, 159)

Po ashtu Allahu Teala atributet e Tij si “Rrauf dhe Rrahim” që janë prej Esmau’l-Husna-së i përmend edhe për Resulullahun (a.s.). Domethënë na njofton se këto cilësi janë shfaqur në një formë të vërtetë te Pejgamberi (a.s.). Edhe fjalët e bashkë-

shortes së nderuar të Resulullahut, Hatixhesë që ia tha Pejgamberit (a.s.), kur po zbriste nga Hira dhe dukej qartë shqetësimi i tij ngaqë i ishte dhënë detyra e profecisë, përfshijnë të vërteta shumë të rëndësishme në lidhje me cilësitë e një udhërrëfyese universal që do të dërgohej te njerëzimi.

Nëna jonë Hatixheja i tha: “Mos u shqetëso!” – pastaj shtoi: “Betohem se Allahu asnjëherë nuk të poshtëron dhe nuk të mërzit, sepse ti përkujdesesh për të afërmit, flet të vërtetën, i ndihmon të dobëtit, i ushqen të varfrit, i respekton mysafirët dhe nxiton për ta ndihmuar atë që i është bërë padrejtësi.”

Çfarë kuptojmë prej të gjitha këtyre fjalëve?

Kuptojmë se personat që do të dalin si udhërrëfytes para njerëzve së pari duhet të jenë “shembuj të mirëfilltë” dhe se shembulli i mirëfilltë mbart të gjithë përmbajtjen e fjalës “i mirëfilltë” në formën që është shfaqur te personaliteti madhështor i Resulullahut (a.s.).

-Islami është i bukur.

-I Dërguari i Allahut (a.s.), ishte njeriu që e zbatoi Islamin në formën më të mirëfilltë. **“I Dërguari i besoi asaj që iu zbrit...”** (Bekare, 285)

-Resulullahu (a.s.), është mbartësi i mesazhit hyjnor për të njerëzit e tjerë.

-Resulullahu (a.s.), është ai që ua ka dhënë të gjithë besimtarëve detyrën për ta mbartur Islamin te të tjerët duke u shprehur në Hytben e Lamtumirës: “Ata që gjenden këtu, le t’ua tregojnë fjalët e mia atyre që nuk janë prezentë.”

Cilësinë e “mbrojtjes nga mëkatet” që e kanë pejgamberët, nuk e kanë njerëzit e tjerë. Por ata që janë në pozitën për të marrë përsipër përgjegjësinë e “predikimit të Islamit” apo “udhërrëfimit” duhet të largohen nga mëkatet që janë një lloj “papastërtie e zemrës” siç shprehet Resulullahu (a.s.).

Në këtë periudhë çdo mysliman me sjelljen e vet shfaq natyrën e tij pozitive apo negative për sa i përket çështjes së predikimit dhe udhërrëfimit. Njerëzit mund t’i shohin një e nga një myslimanët apo të gjithë umetin Islam dhe të vrapojnë drejt Islamit apo të largohen prej tij duke thënë: “Nëse ky qenka Islami.”

Ndërsa cilësitë e tjera si sinqeriteti, besnikëria dhe zgjuarsia që duhet t’i kenë Pejgamberët, duhet t’i posedojnë patjetër edhe ata që e ndajnë përgjegjë-

sinë e udhërrëfimit.

Këtu mund të themi edhe këtë: Cilësia e të qenët shembull i mirëfilltë e të Dërguarit të Allahut (a.s.), është një sunet që duhet ta posedojnë edhe ata që ndjekin gjurmët e Pejgamberit.

Është e vërtetë se Kurani Fisnik, në të cilin përmendet qoftë shembulli i mirëfilltë i Resulullahut apo qofshin cilësitë që duhet t’i kenë besimtarët, në të gjitha kohërat ka vendosur para njerëzimit një portret të “cilësisë së besimtarit”.

Koncepti “Birr” që përmendet në Kuran dhe që në përgjithësi përkthehet si mirësi, është një koncept që ka një kuptim më të gjerë dhe të veçantë. Allahu Teala dëshiron ta shohë besimtarin në pjekurinë e një personaliteti brenda kornizës së konceptit “Birr”. Ajeti është si më poshtë:

“Mirësia (Birr) nuk është të kthyerit e fytyrës suaj nga lindja dhe perëndimi, por mirësia është (cilësi) e atij që beson Allahun, Ditën e Fundit, engjëjt, Librin dhe profetët; e atij që me vullnet jep nga pasuria e vet për të afërmit, jetimët, të varfrit, udhëtarët e mbetur rrugës, lypësit dhe për lirimin e të robëruarve; e atij që fal namazin dhe e jep zekatin; dhe e atyre që i plotësojnë premtimet, kur marrin përsipër diçka; e atyre që durojnë në kohë skamjeje, sëmundjeje dhe lufte. Këta janë besimtarët e vërtetë dhe këta janë ata që e kanë frikë Allahun.” (Bekare, 177)

Nëse e shqyrtojmë ajetin, do të vëmë re se krahas dimensionit të besimit e ibadetit të besimtarit,

theksohet se ai duhet të jetë shembull i mirëfilltë edhe në marrëdhëniet humane. Sa shumë u ngjajnë këto cilësi fjalëve të nënës sonë, Hatixhesë kur ajo foli për pjekurinë e personalitetit të të Dërguarit të Allahut (a.s.).


Nëse shohim ajetin e 92-të të sures Al Imran në të cilin thuhet: **“Nuk do ta arrini birrin/mirësinë përderisa të mos shpenzoni** (në rrugë të Allahut) **prej atyre që doni.”**, vihet re se besimtarëve u vendoset përpara një përmasë tjetër e mirësisë.

Kur në Kuranin Fisnik flitet për pjekurinë e besimtarit, shumë herë nënvizohen dy cilësi:

-Ata që besojnë...

-Ata që bëjnë vepra të mira...

Besimi është vepër e zemrës. Ibadeti është marrëdhënia ndërmjet Allahut dhe robit. Cilësia e kë-



Është e vërtetë se Kurani Fisnik, në të cilin përmendet qoftë shembulli i mirëfilltë i Resulullahut apo qofshin cilësitë që duhet t’i kenë besimtarët, në të gjitha kohërat ka vendosur para njerëzimit një portret të “cilësisë së besimtarit”.

saj marrëdhënieje është në raport me thellësinë e besimit në zemër.

Ndërsa vepra e mirë është ana e besimtarit që interesohet për marrëdhëniet sociale. Njerëzit nuk mund ta shohin zemrën. Për rrjedhojë nuk mund ta shohin cilësinë e besimit dhe të adhurimit. Por gjërat që bëhen apo që nuk bëhen për sa i përket fushës së marrëdhënieve sociale, vlerësohen menjëherë.

Në suren Asr pas shprehjes “betohem në kohën”, thuhet: “Njeriu me të vërtetë është në humbje.” – dhe pastaj përmenden rastet e veçanta. Këto raste të veçanta radhiten nën katër pika:

- Ata që besojnë
- Ata që bëjnë vepra të mira
- Ata që këshillojnë për të vërtetën
- Ata që këshillojnë për durimin

E vërteta përbëhet nga të gjitha rregullat që ka sjellë Islami.

Durimi në të vërtetën, në besimin dhe në vepra të mira është të rezistuarit me vendosmëri. Ndërsa besimi dhe vepra e mirë janë të lidhura fort me njëri-tjetrin. “Vepra” shpreh të gjitha veprimet e njeriut. Njeriu përgjatë jetës i bën disa gjëra. Allahu Teala kërkon nga besimtari që të bëjë vepra të mira. Vepra e mirë (amel salih) është pikërisht si “Birri”. Ajo është një fjalë që Kurani Fisnik i jep kuptime të veçanta. Salih përkthehet “e mirë”, por nëse zbrësim te rrënja e saj do të gjejmë edhe kuptime të tjera si “sulh / paqe”, “islah / rregullim” dhe “salah / mirësi”. Domethënë se besimtari është njeri rregullues, njeri i paqes dhe njeri që i sjell mirësi vendit ku gjendet.

I Dërguari i Allahut (a.s.), i pyeti njerëzit që gjendeshin në xhami:

-A ka ndonjë prej jush që ka vizituar sot ndonjë të sëmurë?

-A ka ndonjë prej jush që ka përcjellë sot ndonjë xhenaze?

-A ka ndonjë prej jush që ka ushqyer sot ndonjë të varfër?

Pejgamberi tha: “Ai që i ka bërë këto është prej banorëve të xhenetit.”

Kur thuhet “amel salih” përmenden ato veprime siç janë këto të cilat e ngjallin një fushë të jetës. Brenda kulturës islame në këtë mënyrë ka hyrë edhe “lumturimi i një zemre”. Resulullahu (a.s.), na inkurajon që të fusim gëzim në zemrën e dikujt.

* * *

Resulullahu (a.s.), filloi ta predikonte Islamin në shoqërinë e Mekës ku shirku kishte arritur pikën kulmore dhe marrëdhëniet humane kishin marrë fund. Një herë kur përjetoi shqetësimin se “kush do të më besojë mua tani”, nëna jonë, Hatixheja i

NXJERRJA NË PAH E “SHEMBULLIT TË MIRËFILLTË” TË TË DËRGUARIT TË ALLAHUT (A.S.), SIGURISHT QË AQ SA KEMI MUNDËSI DUKE FILLUAR NGA FAMILJA, SHTËPIA, RRUGA, XHAMIA, SHKOLLA, VENDI I PUNËS, MEDIA DHE UDHËHEQJA, MBART NJË RËNDËSI JETIKE NË EMËR TË FAKTIT QË NJERËZIMI TA FORMOJË SAKTË OPINIONIN NDAJ ISLAMIT.



përmendi cilësitë e larta njerëzore të tij. Domethënë, ajo i dha kurajë të Dërguarit të Allahut (a.s.), duke i thënë se këto cilësi mund ta thyenin rezistencën e njerëzve edhe në atë shoqëri. Ata mund ta mohonin shpalljen hyjnore, sepse besimi kërkonte një pjekuri shpirtërore tjetër, por nuk mund ta mohonin cilësinë njerëzore që atë kohë gjendej shumë rrallë. “She-mbulli i mirëfilltë” ishte realiteti më influencues që i vinte në vështirësi të gjitha zemrat mohuese.

Nxjerrja në pah e “shembullit të mirëfilltë” të të Dërguarit të Allahut (a.s.), sigurisht që aq sa kemi mundësi duke filluar nga familja, shtëpia, rruga, xhamia, shkolla, vendi i punës, media dhe udhëheqja, mbart një rëndësi jetike në emër të faktit që njerëzimi ta formojë saktë opinionin ndaj Islamit. Le ta shprehim edhe këtë se ndërmjet pranimit të Islamit duke parë myslimanin dhe largimit nga Islami duke parë myslimanin ka dallim shumë të thellë.

Njerëzimi në ditët e sotme ka nevojë aq sa për bukë dhe ujë edhe për një mysliman që e zbaton Islamin me rigorozitet, që me karakterin e tij i sjell vendit ku gjendet vetëm paqe e siguri, që është i mëshirshëm ndaj krijesave, që mbart në sjelljet e tij gjurmë nga morali i lartë i Resulullahut (a.s.), që është besimtar e mysliman në kuptimin e vërtetë të fjalës. Ndërsa mëkati për largimin e njerëzve nga Islami për shkak të sjelljeve (të këqija), sigurisht se është aq i madh saqë nuk mund të mbartet.

Njeriu plekset nga njeriu

— Dr. Adem Ergyl —

Përgjatë gjithë historisë edhe një justifikim tjetër i atyre që nuk kanë dashur t'i pranojnë profetët si të Dërguarit e Zotit ka qenë ky mendim: “A mund të ketë profetë prej njerëzve si ne? Nëse do të vijë ndonjë profet, atëherë ai duhet të jetë një engjell, apo jo?” Zoti (xh.xh.), thotë në lidhje me ata që e kanë shprehur këtë mendim:

“Thuaj: “Sikur në Tokë të kishte engjëj që ecnin qetësisht, Ne do t’u çonim atyre nga qielli një engjell si të dërguar.” (Isra, 95)

Po, njeriu në sistemin e edukimit hyjnor është paralajmëruar, informuar dhe edukuar nëpërmjet një njeriu tjetër që është si vetë ai. Vetëm se njeriu influencues nuk është një njeri i zakonshëm, por është një njeri të cilit i është dhënë dije e urtësi dhe që është zgjedhur e edukuar në një mënyrë të veçantë nga Allahu (xh.xh.). Kjo në një kontekst do të thotë se Zoti i Lartësuar ka vendosur para nesh një “model njeriu të edukuar”.

Pika jonë e përbashkët me peygamberët është të qenët njerëz. Ndërsa dallimi ndërmjet nesh me ata është dija dhe edukata. Zoti kërkon që ne t'i shohim këta njerëz shembullorë, t'i ndjekim dhe ta ngremë nivelin e humanizmit e të adhurimit duke marrë prej tyre dije, moral dhe edukatë. Kjo sepse njeriu nuk është një krijesë e zakonshme, por është një qenie fisnike që është dërguar me një mision të veçantë. Njeriut i është dhënë detyra për të vendosur në tokë një rënd dhe rregull prej të cilit është i kënaqur Allahu (xh.xh.). Ndërkohë të mos harrojmë se njeriu i prishur nuk ka mundësi të vendosë rregull në këtë botë. Atëherë puna më e rëndësishme që duhet të bëhet është edukimi i njeriut derisa të arrijë pjekurinë e duhur. Tregohet një histori e tillë:

Një burrë kur u zgjua në mëngjesin e të dielës pas një lodhjeje të javës, e mori me plot kënaqësi



gazetën në dorë dhe u ul i qetë në kolltuk duke imagjinuar se do të pushonte përgjatë gjithë ditës në shtëpi. Në ato momente djali i vogël i shkon me vrap dhe i thotë se kur do të dilnin në park.

Babai i kishte dhënë fjalën më parë birit të tij. Këtë fundjavë do ta çonte atë në park. Por për shkak se nuk dëshironte aspak të dilte jashtë, i duhej të nxirrte ndonjë pretext. Në ato moment i shkuan sytë te harta e botës që e kishte shpërndarë gazeta si promocion. Në fillim e ndau hartën e botës në pjesë të vogla, ia zgjati të birit dhe i tha:

“Shiko bir! Nëse mund ta rregullosh këtë hartë, do të të çoj në park.” Pastaj mendoi: “Oh sa mirë! Shpëtova. Edhe nëse sjell profesorin më të mirë të gjeografisë nuk mund ta rregullojë deri në mbrëmje.”

Pasi kaluan dhjetë minuta, djali shkoi me vrap te i ati dhe i tha:

“Baba! E rregullova hartën. Tani mund të shkojmë në park.”

Babai në fillim nuk i besoi. Kështu që i kërkoi ta shikonte hartën. Kur e pa u mahnit jashtë mase. Djalin e pyeti se si kishte arritur ta bënte këtë. Fëmija ia shpjegoi në këtë mënyrë:

“Baba! Në anën e pasme të hartës që më dhe gjendej figura e një njeriu. Kur e rregullova njeriun, edhe bota u rregullova vetvetiu.”

Po, nëse e rregulloni njeriu, rregullohet edhe bota. Mirë, por si do të realizohet kjo detyrë? Të ndërtosh njeriun do të thotë që ai të shpëtojë nga papjekuria

dhe të arrijë nivelin e pjekurisë së duhur. Ky është një proces. Përgjatë këtij procesi synohen të arrihen një strukturë e shëndetshme mentale, një thellim shpirtëror dhe sjellje të bukura që kanë arritur gradën e xhentesës e edukatës. Ky është një ndërtim hap pas hapi. Përgjatë gjithë historisë ky proces ka pasur rrugë të panumërta që kanë rezultuar të suksesshme dhe të pasuksesshme. Pika e përbashkët që është parë pothuajse te të gjitha rrugët e suksesshme është shembulli që i ngjall ndjenjat e admirimit dhe që lind dashurinë. Ky shembull më shumë se sa shenjtërimi i personit është të qenët lider në sjellje. Domethënë, mendimet, ndjenjat dhe sjelljet shembullore që i zgjojnë ndjenjat e admirimit, e nxjerr personalitetin nga të qenët i zakonshëm dhe me kalimin e kohës e shndërrojnë atë në një lider që pasohet. Ja pra, ky leadership nuk është një leadership i zakonshëm, por është një leadership etik dhe praktik që pleks humanizëm.

Edhe në sistemin e edukimit hyjnor për të cilin flitet në Kuranin Fisnik, vihen në pah “sjelljet shembullore” dhe kërkohet nga njerëzit që t’i përvetësojnë ato qëndrime dhe sjellje. Kështu, edhe në edukimin e të Dashurit të Allahut, Muhamedit (a.s.), Zoti i Lartësuar ka përdorur të njëjtën metodë. Për shembull, pasi në suren En’am përmenden njëri pas tjetrit Ibrahim, Is’haku, Jakubi, Nuhu, Davudi, Sulejmani, Ejubi, Jusufi, Musai, Haruni, Ismaili, Eljasa, Junusi, Luti, Zekerija, Jahja dhe Isai, alejhimu’s-salam, përmenden edhe cilësitë dhe qëndrimet e tyre më të veçanta. Pastaj thuhet:

“Këta janë ata, të cilët Allahu i ka udhëzuar në rrugën e drejtë, andaj edhe ti (o Muhamed) ndiq rrugën e tyre...” (Shik. Bekare, 83-90.)

Sa shumë që kemi nevojë në ditët e sotme si familje njerëzore, madje si umeti Islam për “shembullin e myslimanit të mirëfilltë” që e kanë shfaqur pejgamberët! Është shumë e qartë se kemi nevojë si për bukën dhe ujin në fshatin, lagjen dhe qytetin tonë për këta njerëz të tillë që janë si yjet ndriçues të cilët na ndihmojnë për të gjetur rrugën në errësirën e natës. Nëse humbin njerëzit e mirë, edhe njerëzimi e humb xhevahirin e humanizmit. Adresa e rimëkëmbjes në këtë situatë janë njerëzit e stolisur me besim, Islam dhe ihsan (mirësi). Plotësimi i kësaj nevoje është farz (obligim) për umetin Islam, sepse amaneti i Islamit është mbi këtë umet ngaqë është umeti i pejgamberit të fundit. Ajo që duhet të bëjë çdo mysliman është që të vendosë dhe të përpiqet për t’u bërë një njeri i mirëfilltë duke i përdorur deri në fund mundësitë dhe aftësitë në fushën e tij.

Është krejt e qartë se kemi nevojë në çdo fushë për shembuj të mirëfilltë. Ne kemi nevojë për dijetarët që janë shembull me dijen, punën, moralin dhe xhihadin e tyre. Kemi nevojë për njerëz të urtë që e kanë zemrën të gjallë, që kanë urtësi, butësi,

mëshirë dhe më e rëndësishmja, dijetarë që u tregojnë rrugën të tjerëve me gjendjen dhe qëndrimet e tyre sikur të jenë yje polare. Ne kemi nevojë për udhëheqës besnikë dhe të zgjuar që e çojnë në vend drejtësinë dhe që mbartin vetëdijen për përgjegjësi. Ne kemi nevojë për tregtarë dhe njerëz që e njohin industrinë të cilët janë të ndershëm, kanë frikë nga Allahu, që përpiqen për të ngrënë vetëm hallall dhe që mundohen për mirëqenien e popullit.

Ne kemi nevojë për prindër shembullorë që e shndërrojnë këtë botë në një vatër xheneti dhe që meritojnë çdo lloj respekti. Ne kemi nevojë për arsimtarë që i përkushtohen me gjithë zemër detyrës së tyre me qëllimin për t’i mbrojtur dhe arsimuar brezat. Ne kemi nevojë për artistë që ia shtojnë vlerat shoqërisë dhe që lënë vepra afatgjata në ndërtimin e civilizimit. Ne kemi nevojë pothuajse në çdo fushë për shumë njerëz të tillë.

Mendimet e bukura që nuk kanë një shembull të gjallë është e vështirë që të kenë ndikim dhe të praktikohen në jetë. Mendimet e tilla mund të vazhdojnë të ekzistojnë nëpër rreshtat e librave si shpresa boshë. Andaj ato nuk mund ta lartësojnë njeriun gradë pas grade dhe nuk mund të ndërtojnë civilizim. Lartësime dhe përparime të tilla mund të ndodhin vetëm nën prijësinë e liderëve shembullorë.

Nevoja për shembull është një nevojë për përparim që e ka çdo moshë dhe çdo nivel. Sa kapital i madh është posedimi i këtyre shembujve të gjallë që mund ta plotësojnë këtë nevojë! Ata që nuk e kanë dot një kapital të tillë, nuk duhet ta nënvlerësojnë të ushqyerit nga shembujt që kanë jetuar më parë.

Dijetarët dhe të urtët tanë e kanë kuptuar këtë nevojë. Andaj kanë bërë shumë shkrime dhe kanë formuar shumë biografi në këtë çështje si një metodë edukimi. Madje në emër për t’i mbajtur aktivë këta libra i kanë lexuar herë pas here. Për shembull, Imam Neveviu i cili është njëri prej dijetarëve të mëdhenj të jurisprudencës islame dhe hadithit, transmetohet se tri orë të ditës në çdo fazë të jetës i ka kaluar duke lexuar jetën e të devotshmëve, prijësve dhe dijetarëve.

Ndërsa Imam Azami, Ebu Hanifja, rahmetull-llahi alejh, ka thënë: “Historitë që tregojnë virtytet e dijetarëve më pëlqejnë më shumë se shumica e rregullave të jurisprudencës islame, sepse këto histori na mësojnë edukatën dhe moralin e dijetarëve.”

Si përfundim, edhe përpjekja për të gjetur një njeri shembullor është diçka e bukur, por ndoshta më e rëndësishme se kjo është përpjekja për t’u bërë një mysliman i mirëfilltë dhe shembullor. Në këtë mënyrë, të vendosim një tullë më tepër për edukimin e njerëzve shembullorë.

ETIKA E MËSHIRËS

kundrejt të gjitha krijesave

— Prof. dr. Sulejman Derin —

Çështja më e rëndësishme ndaj të cilës bëjnë kujdes mistikët në aspektin fetar nuk është marrja e dijes, por zbatimi i saj. Pra, jo vetëm marrja e dijes, por të jetuarit sipas saj. Argumentet e mistikëve në lidhje me këtë çështje kanë qenë fakti që Zoti i Madhëruar në suren Xhuma i përngjan me gomerët e ngarkuar me libra ata që nuk punojnë me dijen e tyre (Shik. Xhuma, 5.) - dhe të shprehurit e Tij: **“O ju që keni besuar! Përse thoni atë që nuk e bëni?”** (Saf, 2) Ata nën dritën e këtyre ajeteve kanë synuar që ta zbatojnë Islamin në nivelin e ihsanit, pra, me vetëdijen për të mos harruar qoftë edhe një moment se jemi në audiencën e Zotit (xh.xh.). Meqë situata është e tillë, miqtë e Allahut, mistikët janë përpjekur që ta mbarin moralin e lartë të Kuranit dhe Sunetit në formën më të bukur në kohën e tyre. Në fakt sipas atyre një dije fetare që nuk shoqërohet me punë nuk është gjë tjetër vetëm se një dije e thatë. Imam Rabbani e shpreh me këtë bejte këtë situatë:

“Nëse dikush nuk ka informacion për veten, çfarë vlere do të kishte të jepte informacion për të tjerët?” (Mektubat, letra e 101-të)

Sipas Imam Rabbanit baza e udhëtimit shpirtëror është arritja e moralit të lartë. Madje sipas atij Ebu Bekri i cili është hallka e parë e Nakshibendive, i ka kaluar sahabët e tjerë me suksesin që ka pasur

në përvetësimin e moralit të të Dërguarit të Allahut (a.s.). “Ebu Bekri zuri një vend të veçantë ndër-mjet sahabëve të tjerë në përparimin përgjatë kësaj rruge për shkak se përvetësoi në kuptimin e vërtetë moralin e Resulullahut (a.s.).” (Mektubat, II, letra e 290-të.)

Në këtë shkrim dëshirojmë të ndajmë me ju disa prej historive të vërteta të mistikëve të ditëve të sotme dhe që kanë jetuar me parë. Këto histori bëjnë fjalë për moralin e lartë të tyre. Në këtë mënyrë le t'i shohim me sytë tanë shembujt e gjallë se Islami mund të zbatohet në çdo kohë dhe në çdo vend. Për moralin e lartë të të Dërguarit të Allahut (a.s.), nuk folëm, sepse vetë Kurani Fisnik dëshmon për këtë duke thënë: **“Me të vërtetë, ti ke një moral të lartë.”** (Kalem, 4) Qëllimi ynë është që ta ndajmë me lexuesit tanë faktin se mrekullia e moralit të Resulullahut nuk ka mbetur në histori, por se ka ardhur deri në ditët tona duke u përjetuar. Le të shpresojmë që edhe ne t'i bashkohemi mobilizimit me këtë moral për të cilin kemi nevojë çdo ditë e më shumë.

Parimi më i rëndësishëm i miqve të Allahut është zbatim i urdhrave dhe shfaqja e butësisë ndaj robërve të Tij. Adhurimet e tyre të singerta ndaj Zotit (xh.xh.), janë bërë objekt i shumë shkrimeve. Siç janë interesante agjërimet, pehrizet dhe namazet e tyre, po ashtu është interesante edhe butësia që kanë shfaqur ndaj robërve të Allahut. Siç ka thënë edhe hoxha i nderuar, Musa Topbashi, nuk mund të ketë përparim shpirtëror pa pasur rregull etik:

“Shumë njerëz pandehin se përparimi shpirtëror bëhet vetëm me shumë adhurime... Andaj ka shumë njerëz që bëjnë shumë ibadete nafile (vullnetare). Ata gjithmonë mbajnë agjërim dhe vazhdimisht e falin namazin e natës, por nuk bëjnë kujdes ndaj hallallit e haramit dhe nuk përpiqen për të përvetësuar moralin e Islamit. Si rrjedhojë, kohën e lirë e kalojnë duke u preokupuar me thashetheme dhe duke bërë përgojime. Ah sikur t'i pakësonin ibadetet nafile dhe të përpiqeshin për të përvetësuar moralin e lartë e për të qenë të zgjuar (të kujdesshëm) në çështjet e të drejtave!”

Tani le t'ia vëmë veshin Ubejdullah Ahrarit, i cili ishte prej mistikëve që edhe e kryente adhurimin në mënyrën më të përsosur kundrejt Zotit, edhe u shërbente robërve të Tij:



“Në Semerkand pata marrë përsipër shërbimin ndaj dy-tre të sëmureve në medresenë Mevlana Kutbuddin. Kur iu përkeqësua sëmundja, i ndynin shtrëtërit. Unë i laja ata me duart e mia dhe u vishja rroba të pastra. Për shkak se u shërbeja vazhdimisht, sëmundja e atyre mu ngjit edhe mua dhe rashë në shtrat. Edhe pse isha në atë gjendje, prapë se prapë vazhdova të sillja disa enë me ujë dhe t’ua pastroja papastërtitë të sëmureve.” (Reshatat)

Edhe Bahaddin Nakshibendi i cili i ka vendosur emrin e vet Nakshibendizmit, ka marrë edukim shpirtëror nëpërmjet butësisë dhe shërbimit. Bahaddin Nakshibendit, i cili mori edukim shpirtëror me shtatë vjet shërbim ndaj njerëzve, shtatë vjet shërbim ndaj kafshëve dhe shtatë vjet pastrim të rrugëve, murshidi i tij Emir Kulali i dha këtë këshillë: “Përpiqu të fitosh zemrat (e njerëzve) dhe shërbeju të dobëtëve! Mbroji njerëzit e dobët dhe ata që u është thyer zemra. Këta janë njerëz të atillë që nuk kanë asnjë të ardhur nga populli. Krahas kësaj, shumë prej tyre jetojnë në një prehje shpirtërore, një modesti dhe një thjeshtësi të plotë. Kërkoji e gjeji njerëzit e tillë dhe shërbeju!”

Të mëdhenjtë e rrugës së mistikës kanë shfaqur një mëshirë të madhe jo vetëm ndaj njerëzve, por edhe ndaj kafshëve. Ky tregim i cili është prej këtyre shembujve, me të vërtetë është udhërrëfyes. Bejazid Bistami përgjatë një udhëtimit të gjatë pushoi nën një pemë. Pasi u çlodh, i hipi devesë dhe përsëri eci një kohë të gjatë. Në pushimin e dytë që e bëri për t’u çlodhur, gjeti dy milingona në torbë. Ai tha me vete: “Mos! I paskam larguar nga vendi i tyre këto dy milingona.” Kështu i hipi devesë dhe u kthye pas vetëm e vetëm për t’i lënë te foleja e tyre këto dy milingona edhe pse ishte një rrugë e gjatë. Këtë e bëri, sepse edhe milingonat janë gjallesa si ne dhe në emër të atyre ka zbritur një sure në Kuranin Fisnik.

Në ditët e sotme shohim me pikëllim se si u bëhen tortura kafshëve dhe se si i keqtrajtojnë. Ndërsa mistikët në këtë mënyrë e kanë mbartur në kohët e tyre urdhrin e Kuranit për mëshirë dhe dashurinë e thellë që i Dërguari i Allahut (a.s.), kishte kundrejt të gjitha gjallesave.

Një ngjarje tjetër e vërtetë në lidhje me këtë temë është kjo që e kam dëshmuar me sytë e mi. Një zonjë e nderuar nga Australia pranoi Islamit bashkë me bashkëshortin e saj. Ata e vazhduan jetën duke punuar si mësues anglishteje në një vend arab. Për fat të keq, disa injorantë në këtë vend u hapnin zjarr me armë maceve dhe qenve që kalonin në rrugë. Ata bënë qitje mbi këto qenie të gjallë duke i shndërruar në shënjestër. Ndërkohë ky veprim është ndaluar nga i Dërguari i Allahut (a.s.). Kjo zonjë e cila nuk e dinte se ky veprim është i ndaluar në Islam, ra në dyshim kundrejt kësaj mizorie që pa. Ajo filloi të kaplohej nga dyshimet në formën: “Mos vallë kjo fe urdhëron tiraninë?” Ndërsa i vazhdonin këto përplasje në shpirt, një ditë i bie në dorë libri në anglisht me titull “Mahmud Sami Ramazanogllu, Sulltani i të Urtëve” i cili

fliste për jetën e Mahmud Sami Ramazanogllusë. Ajo filloi të lexonte ngjarjen: “Jashtë është dikush i uritur. Jepini ushqim atij.”, të cilën e dinë të gjithë. I nderuari e trajtonte qenin sikur të ishte njeri. Ai e kuptoi se qeni kishte uri dhe i kërkoi Musa Efendiut që t’i jepnin ushqim kësaj kafshe të shkretë. Ndërsa e bënte këtë, përdorte një gjuhë me shumë respekt. Kjo ndjeshmëri dhe butësi që shfaqti ky mik i Allahut kundrejt qenit të shkretë, mjaftoi për t’ia shuar dyshimet kësaj zonje nga Australia në lidhje me fenë tonë. Në këtë mënyrë, ia shpëtoi besimin. Ajo përsëri u kthye fuqishëm në Islam duke thënë: “Vallë, sa shumë i mëshirshëm mund të jetë kundrejt njerëzve një mysliman që e mëshiron kaq shumë një qen?”

Morali i lartë i mistikëve është një botëkuptim i thellë i cili përfshin në vetvete njerëzit dhe të gjitha gjallesat. Madje të gjitha krijesat që duken sikur nuk kanë shpirt. Ibn Arabiu na këshillon që gurët e butë nuk duhet të shqetësohen me një gur të fortë. Edhe historia e Aziz Mahmud Hydajit i cili i çoi një lule të vyshkur shehut të tij të nderuar, në mënyrë që lulet e tjera të mos ndërpriteshin nga dhikri, është e njohur për shumë lexues tanë. Kur shehu e pyeti për shkakun e këtij veprimi, ai iu përgjigj:

“I nderuar! Çfarëdo që t’ju jap, ajo është pak për ju!.. Por cilësdo lule që ia zgjata dorën për ta këputur, e gjeta duke bërë tesbih “Allah, Allah”. Zemra nuk më bëri që t’ua ndërprisja dhikrin. Andaj edhe unë ngela pa rrugëzgjidhje. Kështu që u detyrova t’ju sillja këtë lule që nuk kishte mundësi ta vazhdonte dhikrin!..”

Stili i jetës moderne po kërcënon jo vetëm njerëzit, por edhe të gjitha gjallesat dhe natyrën. Për shkak se njerëzit po i kalojnë kufijtë në çdo aspekt, detet, lumenjtë, malet dhe pyjet po ndoten. Të gjitha këto pothuajse po rënkojnë nën tiraninë e njeriut. Në ilahitë e Junus Emresë, të cilat i njohim shumë prej nesh, autori flet me lulet, përmend Zotin me malet e gurët dhe jeton në miqësi me të gjitha krijesat. Morali i mistikëve është një moral me bazë mëshirën që i përfshin në vetvete të gjitha krijesat. Me këto shembuj të gjallë të cilët përbëjnë vetëm një pikë uji të detit, pamë se ky moral mund të praktikohet edhe në ditët e sotme. Mistikët e mëdhenj nuk janë bërë të mëdhenj për shkak të mrekullive, por për shkak të ndjekjes së rrugës së drejtë dhe përvetësimit të moralit të lartë.

I përgjrohemi Zotit (xh.sh.), që të na e mundësojë ta mbartim në ditët tonë moralin e lartë të të Dërguarit të Allahut (a.s.), siç u pa në shembujt e mësipërm!

Zija Pasha është shprehur se përsosmëria e njeriut në fe nuk shihet te fjalët boshe të tij, por shihet te punët dhe veprimet që bën.



PAS TYRE NUK QAU AS QIELLI, AS TOKA

— Ali Riza Temel —

Kur vdiste ndonjë i rëndësishëm ndërmjet arabëve i cili kishte pozitë të lartë, thoshin: “Pas tij qau qielli dhe toka.” Domethënë, ata tregonin rëndësinë e atij, dashurinë e respektin ndaj tij dhe faktin se ai ishte një burim begatie duke thënë se për shkak të vdekjes së tij çdo anë e ka kapluar pikëllimi. Ndërsa kur thonë: “Qielli dhe toka nuk qau pas tij.”, kanë si qëllim se ai ishte një njeri i pavlefshëm, i padobishëm dhe mbi të gjitha i rrezikshëm e i dëmshëm. Allahu i Madhëruar është shprehur kështu për Faraonin dhe ushtrinë e tij që u mbytën në det: **“Eh, sa e sa kopshte dhe burime i lanë ata. Sa ara të mbjella dhe ndërtesa fisnike dhe sa begati, në të cilat kënaqeshin! Kështu, Ne ua lamë trashëgim ato një populli tjetër. Nuk i vajtoi ata as qielli, as Toka, as nuk iu dha afat atyre.”** (Duhan, 25-29)

Në lidhje me vdekjen e të këqijve banorët e qiellit dhe të tokës lëre që nuk qajnë, por pothuajse bëjnë festë, sepse shpëtojnë nga padrejtësitë, përçarjet dhe shkatërrimet e tyre që e dërrmojnë botën. Sikundër të mirëve, ekzistenca e tyre nuk është mëshirë, por fatkeqësi. Shkaku i të gjitha gjërave negative të cilat përjetohej janë Nemrudi, Faraoni, Ebu Xhehli e njerëz të ngjashëm me këta dhe veprat e këqija të tyre.

Sikundër kësaj, toka dhe qielli mbajnë zi kur vdes ndonjë njeri i mirë. Banorët e tokës dhe të qiellit qajnë për të. I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë në lidhje me këtë çështje: **“Për çdo besimtar ka dy dyer në qiell. Nga njëra derë i zbret rrësku dhe nga dera tjetër i lartësohen veprat e mira. Këto dyer mbajnë zi për vdekjen e tij.”** (Tirmidhi, Hadithi nr: 3552.) Edhe një hadith tjetër fisnik është: **“Pas (vdekjes) së besimtarit qan vendi ku ka pas falur namaz e ka pas bërë ibadet. (Gjithashtu) qan edhe vendi ku i ngrihej puna në qiell.”** (Durrull-Mensur, 6/30.)

Të këqijtë dhe veprat e liga të tyre i ndyjnë qiejt e tokën. Ndërsa punët dhe veprat e mira të njerëzve besimtarë ua shtojnë bukurinë qiejve dhe tokës. Ata i pastrojnë ligësitë dhe ndyrësitë e të këqijve. Besimtarët, pra njerëzit që bëjnë vepra të mira janë garancia e sipërfaqes së tokës. Nëse nuk janë ata, edhe kjo botë nuk ka ndonjë kuptim. Të këqijtë duhet ta dinë se jetojnë falë të mirëve. Andaj duhet të shqetësohen prej pakësimit të tyre. Zoti (xh.xh.), u jep rrësk dhe jetë atyre në sajë të besimtarëve.

I Dërguari i Allahut (a.s.), është garancia e umetit dhe të gjithë njerëzimit. Allahu Teala thotë: **“Por Allahu nuk do t’i ndëshkonte ata, përderisa ti ishe në mesin e tyre dhe, Allahu nuk do t’i ndëshkojë ata, përderisa ata i kërkojnë falje Atij.”** (Enfal, 33) I Dërguari i Allahut (a.s.), duhet të gjendet ndërmjet nesh shpirtërisht dhe sunetet e tij duhet të vihen në praktikë, në mënyrë që të jemi të sigurt. Suneti është e gjithë jeta e Pejgamberit. Jeta e vërtetë është jeta që ka bërë dhe ka treguar Ai. Ndërsa metodat e tjera të jetesës janë të pavlera. Kjo botë në një farë mënyre është mejdani i luftës ndërmjet të mirëve dhe të këqijve si domosdoshmëri e sprovës. Secili prej nesh sipas qëndrimeve

të tij, ose e fiton, ose e humb sprovën. Kjo sprovë nuk është e lehtë. Përfundimi i saj është ose lumturi e përhershme, ose ndëshkim i përhershëm.

Edhe pse besimtari bën një jetë të vështirë, në fund arrin lumturinë dhe prehjen. Ndërsa jeta e qafirit dhe e të prishurit është e gjitha dëshpërim dhe pikëllim.

Një herë para të Dërguarit të Allahut (a.s.), kaloi një xhenaze. Ai tha: *“Musterihun ve musterahun minhu.”* Sahabët e pyetën: “Kush është ai që bën rehat dhe ai që të tjerët kanë rënë në rehati prej tij?” Pejgamberi ynë i nderuar tha: *“Musterihun / Ai që bën rehat është robi besimtar. Kur të ndërrojë jetë shpëton nga vuajtjet dhe vështirësitë e kësaj bote dhe arrin mëshirën e Allahut. Musterahun minhu është ai person prej të keqes së të cilit shpëtojnë robërit, vendet, bimët dhe kafshët.”* (Buhari, Xhenaiz, 42.)

Po ashtu, bazuar në ato që ka thënë i Dërguari i Allahut (a.s.), kur të hyjë në xhenet besimtari i varfër dhe i devotshëm i cili ka përjetuar vështirësi në këtë botë, do t'i harrojë të gjitha vështirësitë e dynjasë. Sikundër këtij, jobesimtari dhe mëkatari që kanë jetuar në mirëqenie në këtë botë, do t'i harrojnë të gjithë kënaqësitë dhe dëfrimet që i kanë përjetuar në këtë botë kur të hyjnë në xhehenem. Lumturia e vërtetë është lumturia e përhershme.

Ata që janë qafirë dhe zullumqarë, siç shprehet edhe në hadithin fisnik, janë burim problemesh dhe vështirësish për vetë njerëzit e tjerë në fillim dhe pastaj për vendet, bimët dhe kafshët. Kur këta të ndërrojnë jetë, njerëzit e tjerë përjetojnë gëzimin e shpëtimit prej tyre dhe ligësive të tyre. Ata përkujtohen me mallkime në vend se të përkujtohen me lutje e mëshirë. Kështu që vazhdimisht marrin mallkimet e të tjerëve. Prej këtyre mallkimeve marrin pjesën që meritojnë edhe prindërit e këtyre që nuk i kanë edukuar në mënyrë të mirëfilltë. Kur përmenden emrat e njerëzve të tillë, te njerëzit e tjerë vetvetiu shfaqet një ndjenjë urrejtjeje. Kur përmenden pejgamberët, të singertët, dëshmorët dhe të devotshmit, në zemrat e njerëzve formohet ndjenja e dashurisë dhe respektit kundrejt tyre. Ndërsa kur përmenden Nemrudi, Faraoni, Ebu Xhehli, Ebu Lehebi dhe pasuesit e këtyre, në zemrat e njerëzve formohet ndjenja e urrejtjes dhe neverisë. Kur përmendet pejgamberi dërgohen salavate. Kur përmenden sahabët thuhet “radijallahu anhum / Allahu qoftë i kënaqur prej tyre”. Kur përmenden dijetarët dhe njerëzit e virtytshëm thuhet “Rahimehumu'll-llah / Allahu i mëshiroftë”. Ndërsa kur përmenden të padrejtët thuhet: “Allahu i mallkoftë! Shkofshin në xhehenem!”

Libri i veprave të besimtarit nuk mbyllet. Sevapet e tij vazhdojnë për shkak të veprave dhe gjurmëve të mira që ka lënë pas në këtë botë. Si jeta ashtu edhe vdekja e tij është burim mëshire për të tjerët.

Njerëzit për të cilët nuk qajnë qielli e toka, por përkundrazi bëjnë festë kur këta ndërrojnë jetë, përkujtohen për keq deri në kiamet. Edhe libri i veprave të tyre vazhdon të mbushet me gjynahe për shkak të kujtimeve dhe veprave të këqija që kanë lënë pas. Ka shumë shembuj për njerëzit që banorët e qiellit e të tokës nuk qajnë, por përkundrazi gëzohen. Njëri prej këtyre është Neroni tiran dhe i çmendur.

Në romanin historik me titull Kovadis, janë treguar në mënyrë shumë interesante krimet që Neroni ka bërë kundër të krishterëve në Romë. Aty është nxjerrë në pah edhe përfundimi i dhembshëm i një të çmenduri. Neroni i çmendur e i lajthitur që e vendosi veten në vend të Zotit, u tërbua krejt kur dëgjoi se edhe Spanja dhe Galia kaluan në anën e kryengritësve. Ai dëshironte të vriteshin të gjithë njerëzit nga Galia që banonin në Romë, të digjej përsëri Roma, të lireshin të lira nëpër qytet kafshët e egra që gjendeshin te arena dhe kryeqyteti të mbartej në Aleksandri. Por punët filluan të shkonin ters. Ditë pas dite po afrohej fundi i Neronit. Ai e kuptoi këtë gjë. Atëherë iu kujtuan nëna, bashkëshortja, vëllai dhe njerëzit e panumërt që kishte vvarë.

Ai dëgjoi vendimin e senatit për “vdekje”. Sipas këtij vendimi ndaj t'i do të ekzekutohej ndëshkimi që u jepej atyre që vrisnin prindërit. Mbas qafe do t'i ngulej një sforc dhe do të rrihej me kërbac derisa të vdiste. Ai vrapoi drejt një bataku ngaqë u frikësua se do të arrestohej dhe u përpoq të fshihej në ndyrësinë e batakut. Kur e kuptoi se do të kapej, e vuri thikën te fyti. Dikush ia nguli thikën deri në fund. Prej qafës së trashë të Neronit, i cili u shemb përtokë, shpërtheu gjaku si rrëke e zezë. Ai dha shpirt duke u përpëlitur ashtu i shtrirë përdhe. Ja pra, edhe Neroni u zhduk pikërisht siç merr fund një uragan, një fatkeqësi zjarri, një luftë apo një sëmundje ngjitëse (epidemi).

Të njëjtin përfundim të tmerrshëm kanë pasur edhe Ebu Xhehli, Ebu Lehebi, Nemrudi dhe Faraoni. Qielli dhe toka nuk derdhën goftë edhe një pikë loti për ta. Përkundrazi, njerëzit që u ishte bërë padrejtësi derdhën lot gëzimi.

E gjithë çështja është që të jetojmë në tokë si “mëkëmbësi i Allahut”, të përkujtohemi me mëshirë dhe të lëmë një zë të mirë në kupën e qiellit. Le ta përfundojmë fjalën tonë me këtë strofë të të ndjerit Mehmet Akif Ersojtit:

“A të kujtohet koha kur linde?

Ti po qaje, ndërsa të tjerët po qeshnin.

Andaj bëj një jetë që,

Vdekja të jetë hare për ty dhe vajtim për të tjerët.”

Domethënë, kur të vdesësh, ti qesh, ndërsa të tjerët le të qajnë. Këtij vajtimi le t'i bashkohen edhe qielli dhe toka.

PËRPPJEKJA PËR TË KUPTUAR PARADIGMËN ISLAME

— Idris Arpat —

Në Kuranin Fisnik thuhet: “...Përmendeni shumë Allahun, në mënyrë që të shpëtoni.” (Xhuma, 10)

Ndërmjet shpirtit të njeriut dhe Allahut (xh.xh.), ka një lidhje të fortë. Kur kjo lidhje të dobësohet, njeriu ndjehet më pak i lumtur dhe fillon të bjerë në aspektin e moralit. Qëllimi me përmendjen e Allahut mendoj se është që e gjithë kauza jonë të jetë Allahu, të bëjmë një jetë e cila e tërheq kënaqësinë e Tij dhe ta kemi zemrën të mbushur plot e përplot me dashurinë ndaj Atij.

Kur njeriu bën krimin e “harrimit të Allahut”, edhe Allahu Teala si ndëshkim e bën njeriun që të harrojë vetveten. (shik. Hashr, 19.) Harrimi që njeriu i bën vetvetes do të thotë që të mos u japë rëndësi aspak çështjeve themelore. Kur themi çështje themelore synojmë qëllimin e krijimit tonë dhe të jetuarit në përputhje me këtë qëllim. Çfarë është jeta? Çfarë është vdekja? Çfarë ka pas vdekjes? Të gjithë duhet ta dinë se këto pyetje janë pyetje shumë jetike.

Të mos harruarit e Allahut (xh.xh.), është kusht themelor për gjallërinë tonë shpirtërore, për harenë e jetës dhe për lumturinë e gëzimin tonë. Të jetuarit e një jete që e pëlqen Krijuesi ynë i Lartësuar është i mundur vetëm duke e mbajtur Atë vazhdimisht në mend në ditë.

Kuptimi i ajetit të njëzet e dytë i sures Jasin është: “Përse të mos e adhuroj Atë, i Cili më ka krijuar e tek i Cili do të ktheheni të gjithë?” Nëse mendojmë sadopak qoftë rreth këtij ajeti si myslimanë që jemi, do të vëmë re se ardhja në këtë jetë është një mirësi e Allahut (xh.xh.). Të jesh i krijuar do të thotë të jesh i nderuar për shkak të Krijuesit dhe për shkak se je robi i Tij. T’ia përkushtosh zemrën Fuqisë sublime do të thotë të lartësohesh. “Të adhurosh Zotin dhe të mbrosh të vërtetën” është një gradë shumë e lartë. Të jesh i krijuar do të thotë të jesh kandidat për të hyrë në xhenet. Të jesh i krijuar do të thotë të jesh lexuesi i librit të tokës e të universit dhe nxënësi i Allahut të Lartësuar. Të jesh i krijuar do të thotë të jesh bashkëbisedues i Allahut të Madhëruar. Të qenët bashkëbisedues i Zotit na shpie te admirimi. Ndërsa admirimi na shpie te nënshtrimi dhe adhurimi i Zotit (xh.xh.). Adhurimi është falënderim për mirësinë e të qenët i krijuar. Ngaqë Allahu i Lartësuar është poseduesi i tokës, i qiejve dhe i çdo gjëje ndërmjet këtyre, ne si fëmijët e Ademit jemi vetëm amanetqarë. Ne nuk jemi poseduesi i vërtetë i asnjë gjëje në këtë botë provizore. Një ditë prej ditësh jemi të detyruar që t’ia lëmë amanetet poseduesit të vërtetë të tyre dhe të kalojmë në një botë tjetër. Allahu i Lartësuar siç është poseduesi i tokës dhe i qiejve, është edhe poseduesi i trupit, fëmijëve, bashkëshorteve dhe pasurisë sonë.

Nëse çdo gjë është amanet duke përfshirë këtu edhe trupin tonë, atëherë sigurisht që Zoti i botëve do të vendosë se si do të përdoren këto amanete. Ja pra, pikërisht në këtë pikë del në pah se “të jetuarit nuk është një e drejtë, por është një detyrë”. Kur të themi se “të jetuarit është një e drejtë”, atëherë mund të na pyesin: “Çfarë ke dhënë që e ke arritur këtë të drejtë?” Kjo pyetje nuk ka përgjigje. Për më tepër, nuk mund të themi: “Kam hequr dorë nga e drejta për të jetuar.” Ndërkohë që heqja dorë nga të drejtat mund të jetë një gjendje sublime, heqja dorë nga e drejta e jetës konsiderohet si një mëkat i madh.

Fakti që vetëvraska është mëkat ka edhe shkaqe të tjera, por para së gjithash ajo absolutisht është arratisje nga “detyra e jetës”. Ky veprim mbart kundërshtim ndaj atij që e ka dhënë këtë detyrë. Pra do të thotë: “Rolin që ma ke dhënë ti nuk e pëlqej.”





Andaj ne nuk mund të ikim nga detyra, por duhet të bëjmë programe të planifikuara dhe punime serioze, në mënyrë që ta kryejmë atë.

Nëse jeta është një detyrë, sigurisht që edhe natyrën e kësaj detyre do ta caktojë Ai që e ka dhënë atë. Allahu i Lartësuar i Cili çdo gjë na e ka dhënë si amanet për të përfutur prej tyre, sigurisht që do të na e shpjegojë se si duhet ta jetojmë jetën. Andaj përgjigja "...huden lil muttekin / udhëzim për të devotshmit" për kërkesën tonë "Ihdina / na udhëzo", është për këtë arsye. (Shik. Bekare, 2.)

Allahu Teala sigurisht që për njeriun, të cilin e ka ngritur mbi shumë krijesa, dëshiron të bëjë një jetë sa më të mirë. Ai nuk është i kënaqur që njeriu të bëjë një jetë si dele. Për këtë arsye ka dërguar Kuranin Fisnik plot rregulla dhe peygamberë të nderuar. Njeriu i cili ka pajisje shumë speciale, nuk duhet ta çojë dëm jetën. Nëse njeriu të cilit i flet Allahu i Lartësuar, nuk njuh asnjë vlerë tjetër përveç "kënaqësisë dhe shpejtësisë", atëherë do të thotë se po bën një harxhim shumë të dhimbshëm. Një primitivitet i tillë nuk mund të flasë me Zotin e Lartësuar. Çfarë mund të flasin me njerëz që kanë mendime të zakonshme ata që posedojnë një perceptim jete të nivelit të lartë? Është e qartë se ata që dëshirojnë të bëjnë një jetë si dele nuk do të kenë vlerë për t'u kujtuar te Allahu (xh.xh.). Pra, atyre do t'u vihet vizë. Përveç të tjerash, ata do të merren në llogari se përse nuk kanë dashur ta perceptojnë seriozitetin e punës edhe pse i kanë pasur të gjitha pajisjet e nevojshme.

Atëherë çfarë pritet prej nesh "në jetë e cila është një proces detyre"? Kur po kërkoja përgjigje në Kuranin Fisnik për këtë pyetje, më bënë përshtypje shtatë ajetet e para të sures Muddeththir. Në këto ajete fisnike Zoti i drejtohet Pejgamberit (a.s.) dhe si rrjedhojë të gjithë umetit. Ajo që kuptojmë është:

"O njeri që je mbyllur në shtëpinë dhe vetveten tënde me shqetësimet që t'i sjellë marrja përsipër e përgjegjësive të rënda që mund t'i lëkundin malet! Përderisa të mos i largosh dot këto shqetësime në vendin ku je mbyllur, nuk mund të përparosh aspak. Andaj hidhu në veprim. Filloje punën nga një vend i përshtatshëm. Fillo t'i mbartësh në fushën e jetës parimet që të janë dhënë. Jepi edhe këto përpjekje si shtesë ndaj barrës së sigurimit të të ardhurave për jetën. Përpiqu për ta shndërruar në një vend të jetueshëm tokën e cila është mbushur plot me vështirësi e harxhime. Bëji disa përpjekje në seri për ta bërë të pëlqyeshme dhe të jetueshme jetën që nuk e pëlqen. Po, ty të kemi dhënë një detyrë shumë të rëndë. E gjithë bota është kundër teje, por këto vështirësi nuk janë asgjë kundrejt fuqisë Sime. Pastaj ne nuk të bëjmë përgjegjës për gjërat që e kalojnë mundësinë tënde. Ti vetëm përkushtoj madhësitë Sime dhe përmende emrin Tim e mos e nxirr nga zemra dashurinë ndaj Meje. Përsipër ke marrë një detyrë shumë të rëndë, por ti ke Zotin tënd i Cili është miku, ndihmuesi, mbrojtësi dhe përkujdesësi yt që posedon mundësi të pakufishme. Unë jam Ai që e kam dhënë atë detyrë. Andaj di çdo gjë në lidhje me ty. Ty të kam marrë shumë seriozisht."

Tani njeriu i cili thirret për te një kauzë kaq sublime, kaq fisnike dhe kaq e dëlirë, duhet të jetë i pastër si në pamjen e jashtme ashtu edhe në botën e brendshme. Ai nuk duhet ta shndërrojë kauzën e fesë në një kauzë urrejtjeje. Zemra e tij duhet të jetë e mbushur plot me ndjenjat sublime të dashurisë ndaj Allahut dhe ndaj njerëzve. Gjithashtu ajo duhet të jetë e mbushur plot me ndjenjat e admirimit dhe aderimit. Andaj duhet t'i fshish nga gjuha të tjerët. Fshiji, në mënyrë që të ndjesh ekzistencën e Zotit. Ta ndjesh këtë ekzistencë ashtu që të mos ndjehesh i vetëm dhe i dëshpëruar. Ta ndjesh, në mënyrë që Miku i Madhëruar të jetë gjithmonë me ty.

O Muhamed dhe o umeti i Muhamedit! Sado që të jenë të mëdha përpjekjet që ke dhënë dhe vuajtjet që i ke duruar në rrugën e Zotit, prapë se prapë mos i konsidero si të mëdha. Kauza e fesë nuk është një kauzë e zakonshme. "Anijet janë djegur për ata që kanë dalë në rrugën e Zotit." Sigurisht që do të bëhen sakrifica të mëdha. Çfarëdo që e bën, bëje për hir të Allahut (xh.xh.). Ti nuk mund të kesh ndonjë mik tjetër të dashur si Allahu. Çfarëdo që pret, prite prej Atij. Andaj mos u kushto vëmendje gjërave të porealizueshme. Mos cakto adresa të gabuara për dashurinë tënde. Kjo e cenon tevhidin dhe i hap derën shirkut.

Thirrje për adhurim ndaj Zotit

Doç. dr. Mustafa Karabaxhak

Zoti (xh.xh.), i njofton njerëzit se i ka krijuar që të jenë robër ndaj Tij (ta adhurojnë Atë): **“Xhindet dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të Më adhurojnë.”** (Dharijat, 56) Adhurimi për të cilin bëhet fjalë në ajet së pari është njohja e Allahut Teala, domethënë pranimit të Tij si Zot dhe pastaj ibadeti ndaj Tij. Domethënë se adhurimi përfshin edhe besimin, edhe ibadetin. Thirrja për adhurim është njëra prej detyrave të peygamberëve.

Thirrja, domethënë predikimi është njëra prej veçorive të përbashkëta të peygamberëve. Përdërisa të mos kryhet kjo punë, nuk është kryer detyra e profecisë. **“O i Dërguar! Trego atë që të është shpallur nga Zoti yt! Në qoftë se nuk e bën këtë, atëherë nuk e ke përcjellë Mesazhin e Tij; Allahu të ruan ty prej njerëzve. Natyrisht që Allahu nuk i udhëzon njerëzit që nuk besojnë.”** (Maide, 67)

Detyra e predikimit është prej

detyrave të të gjithë peygamberëve. Ata së pari i kanë thirrur njerëzit për ta njohur Allahun dhe pastaj për ta adhuruar. Këshilla që i ka dhënë i Dërguari i Allahut (a.s.), Muadh ibn Xhebelit (r.a.), kur po e dërgonte si prefekt në Jemen, tregon se cila është ajo gjë që ka përparësi në predikim: **“O Muadh! Gjëja e parë për të cilën do t’i ftosh jemenasit le të jetë dëshmia “La ilahe il-lallah, Muhammedun Rasulull-llah”.**

Nëse i pranojnë këto dy dëshmi, njoftoji se Allahu ua ka bërë farz faljen e pesë vakteve të namazit për çdo natë e ditë. Nëse të binden edhe në këtë çështje, këtë herë njoftoji ata se Allahu ua ka bërë farz zekatin në pasurinë e tyre. Zekati merret nga të pasurit dhe u jepet të varfërve.” (Buhari, Zekat, 1.)

Ndërsa në një hadith tjetër, i Dërguari i Allahut (a.s.), i jep këtë këshillë dikujt që e pyeti për veprën që do ta çonte në xhenet: **“Pranoje Allahun si Zot, mos i bëj ortak Atij asgjë, fali pesë vakteve të namazit, jepe zekatin dhe**



mbaje agjërimin e Ramazanit.” (Buhari, Zekat, 1.)

THIRRJE PËR NË BESIM

315 nga 124.000 prej pejgamberëve që ka dërguar Allahun kanë qenë Rasul. (Ahmed ibn Hanbel, el-Musned, V, 266.) Gjëja e parë që kanë bërë të gjithë është thirrja e njerëzve për ta njohur Allahun, domethënë për t'i besuar Atij.

“Çdo populli Ne i çuam një të dërguar (që u thoshte): *“Adhuroni Allahun dhe shmangni idhujt!”* Disa prej tyre Allahu i shpuri në rrugë të drejtë e disa e merituan të mbeten në humbje. *Andaj, udhëtoni nëpër botë të shihni se si ishte fundi i përgënjeshtresve!”* (Nahl, 36)

THIRRJA PËR ADHURIM

Në Kuranin Fisnik ata që e kanë pranuar këtë thirrje pas besimit në Allahu janë këshilluar që të bëjnë ibadet. Për këtë arsye, në shumë vende besimi dhe vepra e mirë janë përmendur njëra pas tjetrës. Allahu u ka dhënë premtime të mrekullueshme atyre që i bëjnë këto të dyja: *“Kurse ata që besojnë e bëjnë vepra të mira, do të jenë banorë të Xhenetit, ku do të qëndrojnë përgjithmonë.”* (Bekare, 82)

Një rob që vepron duke qenë i vetëdijësuar me besimin dhe adhurimin, veçanërisht duhet të largohet nga mëkatet e mëdha. Në një hadith janë radhitur këto si mëkate të mëdha dhe është shprehur se ato janë shkatërruese: “Shirku ndaj Allahut, bërja e magjisë, vrasja me të padrejtë e njeriut që Allahu e ka ndaluar, ngrënia e pasurisë së jetimit, ngrënia e kamatës, dezertimi nga lufta në momentin e sulmit ndaj armikut dhe shpifja për imorali-



tet ndaj grave besimtare që janë të ndershme.” (Buhari, Vesaja, 23; Muslim, Iman, 144.)

Kur robi të largohet prej këtyre mëkateve, Allahu Teala ka thënë se do t'ia falë mëkatet e vogla: *“Në qoftë se ju u shmangeni gjynaheve të mëdha, që ju janë ndaluar, Ne do t'ju falim gabimet tuaja të vogla dhe do t'ju shpiem në një vend të nderuar.”* (Nisa, 31)

“Për ata që ruhen prej gjynaheve të mëdha dhe veprave imorale, përveç gjynaheve të vogla, me të vërtetë, Zoti yt është i Gjerë në falje...” (Nexhm, 32)

Adhurimi përfshin edhe besimin, edhe ibadetin. Madje përfshin çdo moment në të cilin njeriu merr dhe jep frymë. Për sa i përket kësaj, nuk bëhet fjalë për kohën, vendin dhe formën. *“...Ai është me ju kudo që të gjendeni; Ai sheh gjithçka që bëni.”* (Hadid, 4) *“Ne e kemi krijuar njeriun dhe, Ne e dimë ç'i pëshpërit atij shpirti i vet. Ne jemi më pranë tij se damari i qafës së vet.”* (Kaf, 16)

Ndarja që Allahu Teala u ka bërë pesë vakteve të namazit në segmente të ndryshme kohore të ditës është një urtësi më vete: *“...Namazi është detyrë për besimtarët në kohë të caktuar.”*

(Nisa, 103) Vetëm namazi, i cili është prej kushteve të Islamit, e përfshin të gjithë jetën e robot. Allahu (xh.sh.), kërkon nga robi që e pranon Atë si Zot që të ngrihet herët në mëngjes dhe t'i japë fjalën në këtë mënyrë: *“Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë. Udhëzona në rrugën e drejtë! Në rrugën e atyre që u ke dhuruar mirësi e jo në të atyre që kanë shkaktuar zemërimin Tënd, as në të atyre që janë të humbur!”* (Fatiha, 5-7) Dhënia e kësaj fjale vazhdon edhe në vaktet e tjera përgjatë ditës. Dhe më së fundi, pra në momentin para se njeriu të pushojë, Allahu Teala kërkon nga robi i Tij që t'i përsërisë të njëjtat fjalë. Në këtë mënyrë kjo fjalë që robi ia ka dhënë Zotit duhet të vazhdojë të paktën deri në kohën tjetër të namazit. Kështu ajo duhet ta frenojë njeriun dhe të mos e lërë të bëjë ligësi. *“Lexo (o Muhamed) atë që të është zbritur ty prej Librit (Kuranit) dhe fale namazin! Vërtet që namazi të ruan nga shthurja dhe nga çdo vepër e shëmtuar dhe vërtet që përmendja e Allahut është më e madhe! Allahu di gjithçka që ju bëni.”* (Ankebut, 45)

Të drejtat e Kuranit KUNDREJT NESH

— Xhafer Durmush —

Kurani Fisnik i bën apel të gjithë njerëzimit. Të qenët e tij “mëshirë”, i përfshin të gjithë njerëzit e mençur. Në ajetin fisnik thuhet: **“Këto janë lajme të qarta dhe udhërrëfyese për të devotshmit.”**¹ Ndërsa në një ajet tjetër thuhet: **“Në të vërtetë, ky Kuran udhëzon drejt asaj që është më e mira dhe u jep lajmin e gëzuar besimtarëve, që bëjnë vepra të mira, se ata do të kenë shpërblim të madh.”**² Bazuar në këto ajete të bekuara mund të themi: Kurani Fisnik ka kapacitetin dhe pasurinë për t’u dhënë besimtarëve të tij paqe e rehati në këtë botë dhe shpëtim të përhershëm në botën e përtejme. Shprehjet e ajeteve të Kuranit që i ftojnë njerëzit te Zoti janë shumë të qarta. Ato siç i përgëzojnë besimtarët se për ta janë përgatitur shpërblime të pashoqe, i njoftojnë edhe ata që nuk besojnë në ahiret se do të kenë një ndëshkim të dhembshëm e të ashpër. Krahas këtyre, për besimtarët e devotshëm njoftojnë se do të ketë një mëshirë të veçantë.

Fjalët që do t’i themi në këtë shkrim dëshirojmë t’i ndërtojmë mbi të qenët e Kuranit burim mëshire, frymëzimi dhe begatie veçanërisht për besimtarët. Siç dihet mirësisht mund t’i arrijnë ata që punojnë dhe për-

piqen fort për t’i poseduar. Atëherë, ata që mund të përfitojnë me plot kuptimin e fjalës nga begatia hyjnore janë ata që i respektojnë të drejtat e Kuranit. Të mëdhenjtë tanë të drejtat e Kuranit kundrejt besimtarëve i kanë përmbledhur nën tri pika kryesore të cilat janë “Huruf”, “Hudud” dhe “Huluk”. Ata kanë thënë se zbatimi i këtyre të drejtave është detyrë për të gjithë besimtarët çfarëdo profesioni apo preokupimi që të kenë. Këto mund t’i shpjegojmë si më poshtë:

1) Huruf do të thotë shkronja. Me këtë synohet që myslimani ta lexojë Kuranin Fisnik duke i nxjerrë saktë të gjitha shkronjat dhe duke i shqiptuar fjalët siç duhet. Nisur nga kjo, myslimanët para së gjithash duhet të mësojnë leximin e Kuranit Fisnik dhe ta shtojnë dijen e t’i zhvillojnë aftësitë e tyre në këtë aspekt duke e lexuar atë përgjatë gjithë jetës. Siç ka çdo profesion bazat e tij, edhe baza e Islamit është leximi i saktë i Kuranit Fisnik. I Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Zotit qoftë mbi të, na ka inkurajuar që ta lexojmë Kuranin duke thënë: **“Ai që dëshiron t’i përgjërohet Zotit dhe të flasë me Të, le të lexojë Kuran me një prehje të plotë shpirtërore.”**³ Po ashtu ka dhënë edhe sihariqin se Kurani Fisnik do të jetë ndërmjetësues në ditën e kiametit për ata që e lexojnë.⁴ Atëherë ajo që duhet të bëjmë është krejt e qartë: Nëse nuk dimë ta lexojmë Kuranin, le ta mësojmë leximin e tij. Nëse lexojmë me gabime, le t’i rregullojmë ato. Pasi t’i kryejmë këto, atëherë

duhet të ndajmë kohë në mënyrë të rregullt për leximin e tij. Sot jetojmë në një periudhë në të cilën gjendet mundësia e shtypjes së kopjeve të Kuranit Fisnik specifikisht për të verbrit. A mund të kenë ndonjë justifikim të pranueshëm ata të cilët nuk e kanë një pengesë të tillë, por që nuk dinë ta lexojnë bukur Kuranin?

2) Hudud do të thotë kufij. Pasi të mësohet leximi i saktë i Kuranit Fisnik, duhet të njihet edhe korniza e tij në të cilën gjenden urdhrat

dhe ndalesat. Të lexuarit e Kuranit për myslimanin sigurisht që nuk është i mjaftueshëm, sepse ajetet kërkojnë prej nesh që t'i bëjmë disa gjëra dhe të qëndrojmë larg prej disa gjërave të tjera. Kështu në Kuran janë të vendosur kufijtë kryesorë të Islamit. Ndërsa praktikimin dhe detajet e tyre na i mëson Pejgamberi (a.s.). Nisur nga këto që thamë, hududull-llah, domethënë kufijtë e Allahut që janë shprehur në Kuranin Fisnik e kemi për detyrë t'i mësojmë dhe t'i zbatojmë në jetë. Kjo në të njëjtën kohë është një e drejtë e Librit të Allahut kundrejt nesh pasi të mësohet leximi i tij. A mund të rrijë indiferent (apo i painformuar) një mysliman ndaj Fjalës së Allahut aq sa të mos i njohë urdhrat dhe ndalesat e qarta të ajeteve?

3) Huluk do të thotë moral. Kjo do të thotë që njeriu t'i përvetësojë moralet e larta që lavdërohen në Kuran, të cilin e lexon duke i besuar e duke e ndjerë dhe të largohet nga cilësitë e këqija që përçmohen aty. Ajetet e Allahut nuk përbëhen vetëm nga urdhra dhe ndalesa. Kurani Fisnik para së gjithash ndërton një besim të fortë të bazuar në njësimin e Zotit. Ai e pastron botën mentale të besimtarëve nga problemet e kufrit dhe shirkut. Në këtë mënyrë i pastron zemrat dhe i dëlir. Pas këtyre jep urdhrat dhe ndalesat që e shpjen njeriun te lumturia e kësaj bote dhe e botës së përtejme. Pas vendosjen së këtyre bazave të fuqishme, jep parimet etike si perla që e shpjen besimtarin te virtytet e larta islame. Kurani Fisnik na inkurajon që të përvetësojmë moralin e robërve të devotshëm dhe urdhëron që të qëndrojmë me të sinqertët, në mënyrë që ta mbrojmë atë moral që e kemi përvetësuar.⁵

Sipas mendimit tonë, pika ku mashtrohen njerëzit është kjo: Pandehja se këshillat në lidhje

me moralin e lartë në Fjalën e Allahut (Kuranin Fisnik) janë vetëm sugjerime. Ndërkohë, kornizën e përgjegjësive në të cilën kemi hyrë me leximin e bukur dhe të cilën e kemi ndërtuar me zbatimin e hududull-llahut, e përsos përvetësimi i moralit të Kuranit. Po ashtu është edhe ndjekja e gjurmëve ndërmjet rreshtave duke menduar se mund të ketë edhe shumë urtësi të tjera nëpër shembujt e dhënë në emër të pasimit me përpikëri të mirësive në Fjalën e Allahut. Edhe vetë Zoti na kërkon që ta lexojmë Kuranin me meditim⁶ dhe saktësi.⁷

Përfundimisht, ne posedojmë një thesar të pashoq. Ne posedojmë një udhërrëfyes sublim i cili na i tregon me detaje të gjitha pengesat që bëhen shkak për rrëshqitjen e këmbëve (devijimin) përgjatë udhëtimit të jetës dhe që e paralajmëron në mënyrë të qartë njeriun kundrejt rreziqeve në të ardhmen. Por ne mund të ushqehemi nga ky burim vetëm aq sa e lexojmë me përkushtim, aq sa punojmë me të dhe aq sa e përvetësojmë moralin e tij. Kjo është e lidhur me faktin se sa i perceptojmë përgjegjësitë tërësisht. Po, të lexuarit është i rëndësishëm, por leximi që nuk na bashkon me përgjegjësitë e tjera, nuk është mjaftueshëm përfitues.



KU DUHET TA KËRKOJMË XHENETIN?

Në ajetet e fundit të sures Fexhr thuhet: **“O ti shpirt i qetësuar! Kthehu te Zoti yt, ti i kënaqur me Atë dhe Ai kënaqur me ty! Bashkohu me robërit e Mi dhe hyr në Xhenetin Tim!”**⁸ Zemra e poseduesit të “nfsu'l-mutmainneh” që përkthehet si “shpirt i qetësuar”, është një zemër e pastruar nga çdo lloj dyshimi me begatinë e dhikrit të Allahut dhe që e falënderon Zotin në çdo moment. Cilësitë e këqija dhe të shëmtuara të saj ia kanë lënë vendin moralit të lartë. Nisur nga këto, kjo zemër vazhdimisht përpiqet ta përjetojë me kënaqësi në të gjitha fushat e jetës moralin e lartë të të Dërguarit të Allahut (a.s.). Sjelljet dhe veprimet e saj gjithmonë kurorëzohen me durim, mbështetje dhe nënshtrim ndaj Zotit (xh.xh.). Ja pra, ajetin mund ta komentojmë edhe kështu: “O ti shpirt që e ke arritur prehjen me një besim të plotë dhe vepra të mira!” Ndoshta thirrja: “Bashkohu me robërit e Mi!”, që u drejtohet këtyre njerëzve, përfshin edhe jetën e kësaj bote. Pra, atë ndoshta mund ta komentojmë kështu: “Hyr në zemrat e robërve të Mi dhe kërkoje xhenetin duke i kënaqur ata.” Si thoni? A mund të mendojmë se ka edhe një shenjë të tillë sublime në lidhje me jetën e kësaj bote në këto ajete të bekuara që na njoftojnë për përgëzimin e përhershëm që u jepet atyre të cilëve e përvetësojnë moralin e lartë duke e qetësuar nefsin e tërbuar kundrejt pasioneve të saj për të rënë në mëkate dhe duke e ushtruar atë për të bërë vepra të mira?

Nëse është e vërtetë se secili prej nesh e merr nga këtu (kjo botë) dritën apo errësirën, atëherë a nuk do të ishte më e drejtë që sihariqin: “Bashkohu me robërit e Mi dhe hyr në Xhenetin Tim!”, ta kërkojmë në ndërtimin e zemrave të shkatërruara?



■ REFERENCAT: 1) Al Imran, 138. 2) Isra, 9. 3) Sujuti, I, 13/360. 4) Shik. Muslim, Musafirin, 252. 5) Shik. Teube, 119. 6) Shik. Nisa, 82. 7) Shik. Muzemmil, 4. 8) Shik. Fexhr, 27-30.

DHËNIA PËRPARËSI UMETIT

në mendime, ndjenja dhe veprime

— Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan —

Ngjarjet që i kemi përjetuar dhe që po i përjetojmë në vendin tonë dhe në botë veçanërisht përgjatë këtyre disa muajve të fundit, kanë shkaktuar vuajtje dhe dhimbje të mëdha veçanërisht në vendet myslimane. Por krahas këtyre ngjarjeve negative shihet qartazi se në botën islame veçanërisht në muajin e Ramazanit janë bërë lutje e përgjërime të përbashkëta dhe është folur për bashkëpunimin dhe rizgjimimin e umetit. Këto lëvizje sapo kanë filluar të shpërthejnë filiza të reja.

Myslimanët sikur janë socializuar dhe bashkuar pak më shumë me njëri-tjetrin. Tashmë sapo kanë filluar ta njohin umetin e Muhamedit, të cilit i përkasin. Kështu që kanë ndjerë nevojën për vizionin e umetit në mendimet, ndjenjat dhe veprimet e tyre. Ata kanë vënë re se nuk janë të rëndësishëm kufijtë kombëtarë dhe gjeografikë, por e rëndësishme është korniza e besimit. Andaj e kanë parë të nevojshme që t'i vlerësojnë brenda kësaj kornize gëzimet dhe hidhërimet e tyre.

Ngjarja sociale siç janë zgjedhjet në vend dhe reflektimi i saj në të gjithë botën në një sezon adhurimi të ngjeshur siç është Ramazani, natyrisht ka sjellë me vete edhe xhelozitë kulturore dhe armiqësitë. Sa më shumë që umeti ta bëjë të qartë nevojën për të nxjerrë në pah mendimet, ndjenjat dhe iniciativat e tij, sa më shumë që ta shpallë nevojën dhe të drejtën e tij për ta pajisur vizionin e vet me mendimet dhe opinionet e tij, edhe pasuesit e brendshëm apo të jashtëm të shejtanit nuk rrinë duarkryq, por menjëherë hidhen në sulm.

Sulmi më interesant dhe i rrezikshëm për të cilin po flasim ishte propozimi i një grupi në Francë, pjesëtarët e të cilit kërkuan nxjerrjen e disa ajeteve nga Kurani Fisnik. Kjo iniciativë dhe propozim është një shembull i qartë dhe paralajmërues se deri ku mund ta çojnë çështjen kundërshtarët e Islamit dhe umetit.

Siç dihet Ehli Kitapi (të krishterët dhe hebrenjtë) i kanë manipuluar dhe ndryshuar librat hyjnorë që u janë dërguar. Libri ynë i shenjtë, Kurani Fisnik e shpjegon si më poshtë këtë krim të atyre:



“Në mesin e hebrenjve ka nga ata që i nxjerrin fjalët nga konteksti i tyre...” (Nisa, 46)

“...Disa prej tyre i dëgjonin fjalët e Allahut dhe, pasi i kuptonin, me vetëdije i shtrembëronin ato?!” (Bekare, 75)

“Me të vërtetë, një grup ithtarësh të Librit e shtrembërojnë Librin me gjuhët e tyre (ndërsa e lexojnë atë), që ju të mendoni se ai farë leximi është prej Librit (që ka zbritur Allahu), kurse në të vërtetë, nuk është prej Librit. Ata thonë: “Kjo që lexojmë është nga Allahu”, por ajo nuk është nga Allahu. Ata flasin gënjeshtër për Allahun, duke qenë të vetëdijshëm për këtë.” (Al Imran, 78)

“...Ata i kanë shtrembëruar fjalët e Shkrimeve të shenjta...” (Maide, 13)

Ja pra, njerëzit që e posedojnë edhe në ditët e sotme mentalitetin e atyre që kanë bërë krimin e prishjes dhe ndryshimit të fjalëve të shkrimeve të shenjta, e kanë tepruar duke e kaluar cakun deri në atë masë, pikërisht si qeniet e ulëta që i ndyjnë muret e xhamisë, saqë këtë herë kanë propozuar që të nxirren nga libri ynë i shenjtë, Kurani Fisnik disa prej ajeteve të tij. Kështu që e kanë shqetësuar jashtë mase umetin e Muhamedit (a.s.).

Nuk duhet të harrojmë se propozimi për të nxjerrë një pjesë të ajeteve nga Kurani Fisnik, krahas që është një shenjë e qartë e një armiqësie të madhe kundrejt Islamit dhe umetit të Muhamedit, nga ana tjetër na e tërheq vëmendjen edhe kundrejt qëllimit kryesor dhe rrezikut të tentativave të armiqësisë ndaj sunetit dhe hadithit.

Njerëzit dashakeqës që marrin kënaqësi të jashtëzakonshme nga të shprehurit e mendimeve dhe kundërshtimeve aspak dashamirëse kundrejt hadithit e sunetit dhe njerëzit e shkujdesur që kaplohen nga kjo rrymë me një verbëri të pakuptueshme, sikundër pohimeve, duhet ta shohin se shpresave të kujt u përgatisin terren, apo thënë më saktë, se kujt i shërbejnë. Në të kundërt do të bëhen shkak për të gjitha tentativat negative që do t’u bëhen gjërave të shenjta të të gjithë umetit.

Nga ana tjetër, ithtarët e grupeve fetare që hezitojnë t’u japin qoftë edhe “selam” ithtarëve të strukturave të tjera fetare (islame), klasat e umetit që e vrasin njëra-tjetrën dhe ia marrim pasurinë njëra-tjetrës me armët që i prodhojnë dhe i shesin të huajt, apo “pasuesit e të njëjtës fe që vrasin njëri-tjetrin në emër të luftës së shenjtë” siç shprehet i ndjeri Mehmet Akif Ersoji, vazhdojnë të ekzistojnë edhe në këtë periudhë si panoramat që e dëgjin zemrën dhe si të vërtetat më të dhimbshme në këtë

Njerëzit dashakeqës që marrin kënaqësi të jashtëzakonshme nga të shprehurit e mendimeve dhe kundërshtimeve aspak dashamirëse kundrejt hadithit e sunetit dhe njerëzit e shkujdesur që kaplohen nga kjo rrymë me një verbëri të pakuptueshme, sikundër pohimeve, duhet ta shohin se shpresave të kujt u përgatisin terren, apo thënë më saktë, se kujt i shërbejnë.



umet. Madje në shkallë ndërkombëtare janë vënë re edhe vende myslimane që kanë pranuar të afrohen, të bashkëpunojnë dhe t’u sigurojnë financime këtyre mizorëve jomyslimanë. Kjo gjendje për fat të keq edhe në periudhën e sotme është në procesin e vazhdimësisë.

Nëse shohim këtë situatë është krejt e thjeshtë të gjykojmë se horizonti i umetit është errësuar, madje është errësuar deri në atë masë saqë nuk mund të shihet. Krahas të gjitha këtyre gjendjeve negative, bien në sy edhe lëvizjet, ndjenjat dhe përpëlitjet që i kanë hije horizontit të umetit. Domethënë, umeti i cili duket sikur e ka humbur një pjesë të madhe të vlerave bazë bashkë me kokën (udhëheqjen), shihet se ka filluar ta kërkojë veten duke folur në nivele dhe vende të ndryshme për të njëjtat mendime, ndjenja dhe veprime. Një fjalë e urtë thotë: “Veten e kam humbur vete. Andaj le ta gjejë vetë atë nëse më duhet.” Gjithashtu mund të themi se kemi edhe ngjarje që përbëjnë një përgjigje pozitive për një shpresë të tillë. Kjo situatë mbart kuptimin e një shprese të fuqishme dhe një burim ngushëllimi për të ardhmen.

Zoti na ndihmoftë në dhënien përparësi umetit dhe në mbrojtjen e atij në mendimet, ndjenjat dhe veprimet tona!

ASKUSH NUK ËSHTË I VOGËL

— Nuredin Jëlldëz —

Nëna nuk e ushqen vetëm me gji të voglin e saj, por i mëson edhe gjërat e tjera në lidhje me jetën. I vogli i mëson prej saj ecjen, mbajtjen e lugës, ngritjen e gotës, etj. Edhe letrari më i madh e ka filluar mësimin me fjalët e thjeshta që ka mësuar nga nëna e tij. Pastaj ka formuar fjali më të mëdha e më të rregullta dhe ka bërë letërsi. Fëmijët e mësojnë nga etërit hedhjen e hapit. Të gjithë mësojnë duke parë ngritjen e tonit të zërit, mirësjelljen, ashpërsinë dhe hijeshinë. Të gjithë mësojnë dhe u mësojnë të tjerëve diçka në këtë jetë. Nënata, etërit, shokët, mësuesit... Të gjithë

janë nxënës dhe mësues. Allahu Teala kështu e ka vendosur rregullin e kësaj bote.

Feja jonë është fe e jetës. Islami është në përputhshmëri me natyrën njerëzore. Allahu Teala dëshiron që të bëhemi myslimanë në këtë botë dhe sipas kushteve të kësaj bote. Ne nuk gjendemi në qiell dhe nuk jemi engjëj. Jemi njerëz të cilët hamë, pimë, ecim, flasim, qeshim dhe qajmë. Kur u bashkohemi atyre që qeshin, qeshim edhe vetë. Kur gjendemi ndërmjet atyre që qajnë, mërzitemi edhe vetë. Nëse vrapon ai që është para nesh, vrapojmë për ta arritur. Nëse njerëzit e tjerë nuk i kushtojnë rëndësi ndonjë gjëje, edhe ne detyrohemi të mos i kushtojmë rëndësi. Ky është rezultati i natyrshëm i të qenët njeri. Ne kemi parë nënën tonë dhe kemi kuptuar fazën e parë të jetës. Pastaj e kemi praktikuar atë. Kemi parë shokët dhe kemi gjetur vend e punë për vete. Kemi parë të moshuarit në shtëpinë



tonë dhe kështu kemi filluar të mendojmë për të ardhmen. Për shkak të atyre që kanë vdekur, jemi frikësuar nga vdekja. Kemi zhvilluar pasionin për të mbledhur pasuri duke u influencuar nga të pasurit. Pra, vazhdimisht jemi ndikuar nga diçka. Kështu ka jetuar njeriu dhe sigurisht që kështu do të vazhdojë të jetojë. Gjithmonë do të ketë të mirë që ndjekin gjurmët e të mirëve dhe të këqij që ndjekin gjurmët e të këqijve. Si konvoji i të mirëve, si konvoji i të këqijve arrijnë deri te njeriu i parë, babai ynë, Ademi (a.s.). Gjithashtu do të vazhdojnë deri te njeriu i fundit. Ndërsa shqetësimi se ku ndodhemi në këtë konvoj dhe prapa kujt jemi apo kush do të jetë pas nesh, është urdhri që ta shohim këtë jetë me ndjesinë e të pasurit para sysh jetën e botës së përtejme.

Nëna do të bëhet mësuese dhe mësuesja do të bëhet nënë. Të gjithë do të marrin dhe do të japin. Kështu është shkruar fati i njerëzimit. Vazhdimësia e mirësive dhe ligësive ndodhin me dorën e të mirëve dhe të këqijve. Ata që besojnë do të gjenden në hallkën e atyre që e mbartin deri në kiamet bërthamën e besimit. Pikërisht siç e luajnë rolin e tyre ata që mbartin farën e mohimit të Zotit (xh.xh.). Ata që falin namaz nuk do të thotë që thjeshtë falin namaz, por çdo namaz i tyre në të njëjtën kohë është edhe prezantim i namazit ndaj brezit të mëvonshëm. Nipërit që shohin faljen e dy rekatëve namaz nga gjyshërit e tyre, do t'i japin jetë namazit. Një tryezë në të cilën ulemi me bismil-lah, edhe nëse gjendet në dhomën e ndenjës, ajo është si një medrese. Një baba që hyn më këmbën e djathtë në shtëpi një ditë do të bie në sytë e të tjerëve dhe do ta gjallërojë Sunetin. Dikush që thotë "elhamdulil-lah" me një zë që i vjen nga zemra pasi ngopet, edhe e falënderon Zotin, edhe i edukon të pranishmit. Kështu është edhe tryeza e syfyrit në të cilën ulemi për të ngrënë syfyr e për të agjëruar. Po kështu është edhe tryeza e iftarit. Haxhilerët që qëndrojnë në Arafat, e mbartin haxhin te brezat e ardhshëm. Myezintë nuk thërrasin vetëm në namaz, por në të njëjtën kohë gdhendin nëpër mendjet e njerëzve shpalljen më sublime. Madje një besimtar me mjekër, nëse nuk ka ndonjë problem tjetër, e prezanton Islamit më mirë se një besimtar pa mjekër. Në shoqërinë tonë myslimane selami gjendet si një pikë e mrekullueshme komunikimi. Identiteti u jep mesazh të tjerëve, të bën të komunikosh me ta dhe të jep sevap.



Kur një nënë të ushtrojë detyrën e nënës nuk duhet ta nënçmojë veten, sepse ajo në këtë çështje është mësuesja e besimtarëve. Ajo do të hedhë themelet, pastaj mësuesi mysliman do të ndërtojë mbi to ndërtesën e Islamit. Një besimtar në tryezë nga njëra anë do të na mbajë të lidhur me Sunetin, nga ana tjetër do t'i mësojë brezit të ri emrin e Allahut. Feja jonë është fe e njeriut. Ajo kalon nga njeriu te njeriu. I Dërguari i Allahut (a.s.), ishte njeri. Prej atij e kemi marrë fenë në atë nivel që mund ta zbatojë njeriu. Sahabët e nderuar, Allahu qoftë i kënaqur prej tyre, ia dolën mbanë për ta marrë fenë dhe për ta transmetuar. Kështu që u bënë më të mirët e umetit. Kjo kështu ka qenë dje, kështu është sot dhe kështu do të jetë edhe nesër. Askush nuk mund ta nënvlerësojë identitetin e besimtarit. Secili prej nesh është i vlefshëm në pozicionin e tij. Padyshim se edhe barra e atyre që kanë marrë përsipër udhëheqjen e umetit ka një vlerë krejt të ndryshme. Suksesi i tyre për t'i ndjekur këto gjurmë është për shkak të begatisë së ndjekjes së atyre gjurmëve. Atij që i ka ndjekur mirë gjurmët, i janë ndjekur mirë gjurmët. Ai nuk është harruar apo nuk ka rënë në rrugë të gabuara. Umeti ynë është një umet i madh. Të qenët prej këtij umeti e bën të domosdoshëm të qenët të urtë. Të jesh prej këtij umeti dhe të jesh i vogël, pothuajse është e pamundur. Nënvlërësimi i pozicionit për të cilin na ka krijuar Allahu Teala na detyron të mbetemi të vegjël dhe të zhdukemi. Të gjithë kanë vendin e tyre duke filluar nga nëna e duke përfunduar te dijetari. Kështu që secili prej nesh absolutisht ka hijen e vet.

“...Vërtet, zemrat qetësohen

me përmendjen e Allahut!” (Rad, 28)

Si mund të jemi më të lumtur?

— M. Ali Eshmeli —

U pyet një njeri i papërgjegjshëm:

-Ç'është kjo papërgjegjshmëri?

-Kjo e imja nuk është papërgjegjshmëri.

-Si nuk është? Sigurisht që është papërgjegjshmëria vetë.

-Ashtu duket, por gjendja ime është e ndryshme.

-Nuk të kuptova.

-Nuk mund të më kuptoni, sepse nuk e dini gjendjen time!

-Eee?

-Për këtë arsye, mund të justifikohem.

-Si ka mundësi? Si mund të ketë justifikim neglizhenca dhe moskokëçarja jote kundrejt përgjegjësisë

dhe detyrës?

-Sigurisht që mund të ketë. Në fakt duhet të ketë patjetër.

-Përse?

-Sepse kështu e ndjej veten më rehat dhe më të lumtur.

-Allah, Allah!

-Ashtu...

-Por çfarë do të të bëjnë të ndjesh këto papërgjegjshmëri pas vdekjes dhe në Ditën e Gjykimit?

-Tani nuk mund të mendoj për këto, sepse nuk dua ta prish qejfin.

-Mirë, por çdo të bëhet kur të vijë Azraili dhe të ta prishë qejfin?

-Off, të thashë që kështu jam më rehat dhe më i lumtur. Mbaroi kjo punë.

-Por mosha po të përparon. A nuk ka për të ardhur mbrëmja meqë erdhi iqindia?

-?!.

Një njeriu të zhytur në mëkat iu tha:

-Mëkatet janë si mina që do të shpërthejnë në Ahiret. Përse nuk bën aspak kujdes?

-Bëj kujdes, por vullnetin e kam të dobët.

-Por Allahu i Lartësuar ua ka dhënë të gjithëve vullnetin e mjaftueshëm për të rezistuar kundër mëkateve.

-Mua nuk ma ka dhënë!

-Ky është një fajësim në formë budallallëku! A do të të bënte përgjegjës, nëse nuk do ta kishte dhënë?

-Ashtu është, por s'po heq dot dorë. Ose të them të drejtën, edhe unë pak nuk dua që të heq dorë.

-Përse?

-Sepse kështu jam më rehat dhe më i lumtur.

-More, kush është i lumtur nga të ngrënët e qel-bësirës?

-Ç'është kjo pyetje? A nuk ishte pak e rëndë?

-Po, ishte pak e rëndë, por kjo ishte shprehja më e saktë për zgjedhjen dhe atë që bën ti. Përse prekes?

-Sepse më ikën qefi.

-Nga një fjalë e vërtetë? Në fakt, çfarë do të bësh kur të vijë dita e dhimbshme që do të ta prishë qejfin?

-Off, me të vërtetë e zgjate shumë. Unë kështu jam më rehat dhe më i lumtur, në rregull?

-Mirë, por dielli i jetës po të perëndon. A nuk e shikon?

-?!.

Një njeri neglizhent që nuk mund të punonte në asnjë lloj mënyre u qortua:

-Njeriu do të ketë shpërblim dhe ndëshkim sipas asaj që ka vepruar.

-Edhe unë kam një të vërtetë tjetër.

-Asnjë e vërtetë nuk e mëson njeriun të thotë: "Piqu dardhë dhe bjer në gojën time!"

-Në këtë botë disa jetojnë plotësisht kështu.

-Me cilën ndërgjegje?

-Nuk dua t'ia di për ndërgjegjen. Një gjendje e tillë është më e rehatshme dhe më lumturuese.

-Të jetosh si gjinkalla në gusht është më mirë, apo jo?

-Pse të të gënjej! Ashtu është më mirë!

-Por dimri po vjen. Atëherë çfarë do të ndodhë?

-Off, mjaft tashmë! Unë kështu jam më rehat dhe më i lumtur, në rregull?

-Të flasësh mbi tokë është e lehtë sigurisht, por a nuk e kupton se nëntoka t'i ka kapur të dyja këmbët?

-?!.

Një injorant i ditur dhe me mendime të prishura u paralajmërua:

-A ju ka hije që të zgjidhni të gabuarën në një çështje që e dini të vërtetën?

-Kjo nuk është e gabuar.

-Si nuk është e gabuar?

-Këndvështrimet janë të ndryshme, prandaj ata që nuk e njohin këtë çështje e shikojnë si të gabuar.

-Si ka mundësi? Shumë njerëz kanë pësuar dëm nga kjo. Nëse nuk është e gabuar, atëherë nga vjen gjithë ky dëm?

-Në atë aspekt keni të drejtë...

-Eee?

-A nuk kam të drejtë të jem rehat dhe i lumtur?

-Sigurisht që ke, por jo mbi dëmin dhe fatkeqësinë e të tjerëve.

-Ajo është çështje e të tjerëve. Unë në vetvete jam i qëndrueshëm dhe në të drejtë.

-Çfarë drejtësie dhe qëndrueshmërie është kjo?

-Sepse kështu jam më rehat dhe më i lumtur. Kjo është e rëndësishme.

-Thoni atëherë, kjo lumturi në të vërtetë nuk është gjë tjetër përveçse një egoizëm i pamëshirshëm!

-Unë nuk mendoj ashtu.

-Ti u jep helm njerëzve, por mendon se nuk do t'i vrasësh. Mos vallë helmi sheh se si mendon ti dhe sipas kësaj e jep efektin? Gjithmonë për këtë arsye thua të njëjtat gjëra për mendimet e tua të prishura, apo jo?

-Jo, mendimet e mia janë filozofike, të vlefshme dhe të paprekshme. Prandaj nuk lejoj të flasësh kështu për to.

-Por një ditë zjarri do t'i prekë.

-Off, shumë po flet. Të thashë një herë se kështu jam i lumtur.

-Domethënë se je i lumtur kur e përdor dijen jo për Allahun, por për nefsën dhe shejtanët. Çfarë mund të thonë njerëzit për këtë?

-Le të thonë çfarë të duan. Tash-

më jepi fund këtij muhabeti!

-Sigurisht që nuk ke kohë. Në fakt, edhe caktimi hyjnor në pafillimësi e ka bërë të shkurtër jetën në kohën e fundit. Ja shiko, varri i mbrëmjes i jetës tënde është pikërisht para teje. Shikoje mirë, sepse është shumë afër!

-?!.

Një tip që i fajësonte të gjithë, e kishte vendosur veten në qendër dhe po fliste. Atij i thanë:

-Çfarë halli ke?

-Njerëzit nuk më kuptojnë. Ata më paragjykojnë.

-Përse edhe vetë vepron me paragjykim?

-Ky nuk është paragjykim, por është një e vërtetë.

-Çfarë e vërtete?

-E vërtetë me kuptimin e plotë të fjalës.

-A nuk e kupton se po u bën padrejtësi dhe po sillësh pa respekt kundrejt të tjerëve?

-Përkundrazi, ata nuk e kuptojnë dot se unë këshu jam më rehat dhe më i lumtur.

-A shkelja në kokat e të tjerëve është lumturia jote, apo injorimi i gjërave të shenjta?

-Nëse mendimi im nuk merret parasysh, atëherë po.

-Domethënë se pret respekt për mendimet e tua të gabuara?

-Kush vendos se janë të gabuara? Sipas meje janë të drejta plotësisht.

-A janë të drejta edhe nëse çelësi i përgjigjes së tokës e qiejve thotë se nuk janë të drejta?

-Po, prapë se prapë janë të drejta.

-Ja, kësaj i thonë mani.

-Offf, si mund të jetë mani? Kështu jam më rehat dhe më i lumtur. Kjo është e gjitha.

-Çfarë të të themi? Ngaqë shejtani i mallkuar është shumë i kënaqur me gjendjen tënde, nuk të shqetëson. Sigurisht se për këtë arsye tani për tani e ndjen veten rehat. Domethënë, je i lumtur ngaqë shejtani është i kënaqur me ty. Pa mendo një herë: A është i kënaqur Allahu nga ky veprimi yt? A mund të ketë lumturi dhe rehati pa qenë i kënaqur Ai? Mos vallë dëshiron ta mësosh përgjigjen e drejtë nga kthetrat e vdekjes e cila nuk vonohet asnjë çast dhe po pret e gatshme te koka jote?

-?!.

E pyetën një tip që i pandehte përralla çështjet e besimit dhe që bënte çdo gjë që i dilte përpara:

-A e kupton se çfarë je duke bërë?

-Sigurisht që e kuptoj.

-Siç është mangësia në punë, ashtu është edhe në besim. Ajo e rrokullis njeriun në humnerë.

-Kjo është e drejta ime. Mendoj si të dua dhe besoj si të dua. Përse paskam për të rënë në humnerë!

-A nuk e di? Besimi i drejtë nuk është diçka që mund ta nxjerrë në pah gjithkush siç dëshiron. Ai është një besim i caktuar nga Allahu (xh.sh.).

-Atëherë çfarë kuptimi kanë mendja dhe mendimet e mia? Atëherë unë nuk jam më vetvetja. Ndërkohë unë dua të jem vetvetja. Ja pra, tani jam vetvetja.

-Po tjetër?

-Çfarë të them tjetër? Kështu jam më rehat dhe më i lumtur.

-Mirë atëherë. A mund të tregohesh i ndershëm në këto që thua? Ji i sinqertë dhe mos hezito!

-Çfarë do të më thuash? Nuk të lejoj të flasësh keq për ndershmërinë time.

-Shumë mirë atëherë, nuk ka nevojë të mos më lejosh, por thjeshtë tregojë ndershmërinë tënde.

-Si?

-Shiko kështu:

Nëse refuzon të ushqehesh nga shpallja që ka zbritur Allahu i Lartësuar, atëherë ktheje pas mendjen që ta ka dhënë Ai. Sepse Ai shpalljen e ka caktuar si ushqim të mendjes. Ti së pari ktheje atë pas dhe pastaj krijo një mendje tjetër për vete. Meqë mendon se nuk je vetvetja në çështjen e besimit siç dëshiron Allahu Teala, domethënë, meqë dëshiron të shkëputesh nga Zoti (xh.sh.), atëherë tregohu i ndershëm dhe shkëputu prej Tij në çdo gjë! Pra, mos shko vetëm pas interesit! Shiko, kur të merr uria, han me plot oreks rrëskun që ka krijuar Ai. Tashmë mos ha më prej atij rrësku! Shiko, ti merr frymë nga ajri që ka krijuar Ai. Tashmë hiq dorë edhe nga kjo!

Domethënë, para se të reagosh kundër besimit të drejtë që ka dhënë Ai, reago kundër gjërave që ke marrë prej Tij! Pra, reago kundër shpirtit, trupit, rrëskut dhe çdo lloj mirësie në të cilën jeton dhe prej të cilës përfiton. Pa mendo, përse nuk shqetësohesh prej tyre? Mbi të gjitha, bën edhe luftë të tmerrshme për t'i marrë ato mirësi që ka krijuar Ai. Prandaj kuptoje se nuk je i ndershëm!

Përfundimisht, ji i ndershëm në të dyja anët dhe pastaj vepro si të dëshirosh!

-Offf, do të pëlças. Unë kështu jam më rehat dhe më i lumtur. Kaq kam për të thënë!

-Sa çaste mund të zgjasë sipas teje të qenët i lumtur pa qenë i ndershëm dhe të qenët rehat duke

u larguar nga Krijuesi?

Ja, kjo është sëmundja e çuditshme e kohës:

Çdo gjë është e lejuar për ta ndjerë veten rehat dhe të lumtur për një periudhë të përkohshme. Flijimi i lumturisë dhe rehatisë së përhershme për hir të kësaj sëmundjeje është shumë normal, madje, i nevojshëm. Ndërsa ana më e çuditshme e kësaj sëmundjeje është se injorantët e rrezikshëm e kanë shndërruar këtë fatkeqësi në një lloj metodë shërimi. Mani të dhe mashtrimet që njeriun e kanë zhytur e gjuhëzuar nga aspekti i besimit dhe moralit dhe që i kanë çekuilibruar njerëzit, po përdoren kudo si mënyra mjekimi:

“Nuk ka problem edhe nëse është gabim. Siç ta ndjesh veten rehat dhe të lumtur, ashtu bëhu! Mos hezito ta bësh këtë dhe thuaj i qetë: Unë ky jam! Të tjerat nuk kanë rëndësi.”

Sa bukur (!)

Kjo përjasje që formon një rrugëzgjdhje marramendëse dhe që duket sikur i zgjidh hallet e njeriut nga ky aspekt, e fsheh shumë mirë turbullirën që sjell në pah dhe helmin shkatërrues që ka nga ana tjetër. Pasi ia del mbanë t'i fshehë këto, haptazi sugjeron këtë: “Nëse në vetvete ndjen se të këqijat të janë shtuar, atëherë duhet të bëhesh i keq! Nëse mendon për të bërë padrejtësi, atëherë duhet të bësh padrejtësi! Nëse të pëlqen mosrespekti, atëherë vepro sipas qejfit! Gjithmonë përpiqu të jesh vetvetja! Mos i jep rëndësi askujt, por mendo vetëm për veten, sepse vetja jote ekziston si ti. Pra, nuk mund të jetosh dot si dikush tjetër. Nëse në mendjen tënde gjendet shkatërrimi, atëherë duhet të shkatërrosh! Nëse brenda teje ka zjarr, atëherë duhet të djegësh. Çfarëdo që të ndodhë, ti duhet të jesh vetvetja! Jeto si të dëshirosh! Askush nuk mund të përzihet te ti! Madje, mos lejo që të përzihet! Rezisto kundër atyre që të pengojnë për të qenë vetvetja! Askush nuk ka të drejtë të të thotë se je në gabim. Çfarëdo që të mendosh ti, ajo është e drejtë. Të tjerat nuk kanë rëndësi! Mos harro, e rëndësishme është lumturia dhe rehatia jote!

Shuumë, shumë keq;

Sa breza janë shkatërruar me këtë afion helmues të ambalazhuar me mjekim? Pamje shumë të dhimbshme, shpirtra të copëtuar dhe të rinj të dërmuar nëpër shkolla, rrugë, familje dhe shoqëri, tashmë janë shtuar pa masë. Pikërisht mbi këto masa të shumta, bilbili i edukimit tonë në degën e një peme që quhet largpamësi, po i tregon përsëri të vërtetat në lidhje me këtë çështje duke bërë titur me të madhe. Me thënë të drejtën, jo duke bërë titur me të madhe,

por duke klithur:

O njerëz të mendjes! Kini kujdes ndaj helmeve të ambalazuara me mjekim që u shfaqet mendjes dhe zemrës suaj! Mos u mashtroni nga joshja e përjasjeve që i mbrojnë të këqijtë dhe ligësitë! Të diturit që dinë vetëm të mashtrojnë, nuk ju mësojnë gjë tjetër përveçse mashtrime.

Ç'na qenka?! Njeriu u dashka të bëjë atë gjë prej të cilës ndjehet i lumtur edhe nëse ajo është e gabuar! Të gjithë justifikohen me këtë kur ngelin ngushtë. Të këqijat, të gabuarat, mëkatet, gjërat negative, madje edhe poshtërsitë dhe ligësitë justifikohen me këtë. Edhe gjërat e tmerrshme dhe të trishtueshme justifikohen me këtë. Edhe tradhtarët dhe mosmirënjohësit justifikohen me këtë. Edhe ata që shfaqin sjellje shumë të ulëta, të këqija dhe të pështira, edhe ata që zhyten në mijëra gabime të pakuptimta justifikohen me këtë mburojë të pavërtetë.

Sa e çuditshme!

Pamundësia si zgjidhje për gabimet? Sa e logjishme do të ishte nëse do të strehoheshim për t'u ngrohur në fytin e një ezhderhaje, i cili ha njerëz, në një pus të ftohtë ku mund të kemi rënë? O njerëz të mençur! Zgjidhja e cilit problem është nxjerrja e mendjes jashtë funksionit? A mund të formohet njeriu sipas ndjenjës së rehatisë dhe lumturisë edhe nëse është e gabuar? A mund të ketë mjekim sipas të ndjerit një rehati shkatërruese dhe dërmuese?

A mund ta ndryshojë të vërtetën hyjnore përdorimi i ambalazheve joshëse dhe ndriçimi i përjasjeve të helmuara në këtë çështje? Përgatitja e mjedisit për rehatinë e mikrobeve i shërben shërimit apo përkeqësimit?

Mbi të gjitha, si do të shpëtojnë ata që e ndjejnë veten rehat dhe të lumtur në mëkat? Çfarë do të ndodhë me një njeri nëse ai e ndjen veten rehat dhe të lumtur në gjynah? Njeriu mund të bjerë në mëkat dhe gabim, por çfarë do të thotë që t'i thuash atij: “Po bën atë që është e drejtë!”?

Nëse nefsi i njeriut vendoset në qendër, atëherë njeriu pothuajse qind për qind ndjehet rehat dhe i lumtur me mëkatën. Hidhuni një sy feve të manipuluara! Të gjitha këtë të vërtetë shprehin. Njeriu për këtë arsye e ka tepruar deri aty sa që ka prishur edhe fenë. Ndërsa Allahu Teala atyre që kanë vepëruar kështu nuk u ka thënë: “Meqë kështu jeni të lumtur, atëherë keni të drejtë!” – por e ka anuluar besimin e atyre dhe e ka shfuqizuar. Kështu pra, për ata të cilët nuk e pranojnë udhëzimin e vërtetë, ka premtuar Xhehenemin.

Domethënë se rregulli është orientimi sipas pe-



LUMTURIA DHE REHATIA E VËRTETË U PËRKET ATYRE QË E SHNDËRROJNË VUAJTJEN NË HARE DUKE VRAPUAR PËR TE ALLAHU TEALA PËRGJATË GJITHË JETËS!

shores hyjnore. Në fakt, helmi i njohur është mikrobi i një ateizmi të fshehtë. Ndërkohë, një botë pa haramë dhe hallalle nuk është në përputhje me natyrën e njeriut, sepse logjika që e lë mënjanë haramin e hallallin dhe që thotë vetëm: “Ndjeje veten rehat dhe të lumtur! Të tjerave mos u jep rëndësi!”, është shndërrim i nefsit në idhull dhe shkatërrim i shpirtit. Ndërkohë shpëtimi i njeriut është vetëm orientimi qiellor i shpirtit. Ndërsa orientimi që e shndërron nefsën në idhull nuk ka lënë fatkeqësi dhe ndëshkim pa ia sjellë njerëzimit që nga njeriu i parë e deri më sot.

Sa mashtrim i madh dhe sa mosfunksionim i dhimbshëm i mendjes është lidhja e rehatisë dhe lumturisë me kurthin e fatkeqësisë së mbushur plot me pendim ndërkohë që e vërteta është e tillë! Për shembull, kur një njeri bën një krim, për shkak të kësaj, pothuajse qetësohet. Fjalja: “Ji i lumtur siç të vjen nga brenda!” – e shtyn atë të bëjë çdo gjë. Dikush thotë se e përdor këtë fjali për një zgjidhje të përkohshme. Por a mund të ketë zgjidhje të përkohshme nga një helm që e shkatërron njeriun për shkak të rezultateve të tij të tmerrshme dhe dërmuese? Prandaj, ne duhet të mendojmë:

Kur e ndjen veten rehat dhe të lumtur një hajdut? Kur e ndjen veten rehat dhe të lumtur një mashtrues? Po një i shkujdesur, një injorant, një vrasës, një mëkatar, një alkoolist, një i degjeneruar, një gjynahqar, një tradhtar, një vesveseli, një mikrob, një gjarpër, një akrep, një gomar, etj.? Kur e ndjejnë veten rehat dhe të lumtur këta?

Përfundimisht, o njerëz të mençur! Të ndjerët e nefsit rehat dhe të lumtur duke vendosur në qendër dëshirat vetjake nuk është një parullë e saktë për ta bërë të lejuar çdo gjë. Viza për Xhehenem që e jep shejtani i mallkuar nga dora e cilitdo njeriu qoftë, kurrë nuk mund ta fusë njeriun në Xhenet.

Po ashtu edhe ju o njerëzit e përshpirtjes! A janë më të rëndësishme rehatia dhe lumturia e nefsit, apo e zemrës dhe e shpirtit? A janë më të rëndësishme

rehatia dhe lumturia e përkohshme e kësaj bote, apo rehatia dhe lumturia e përhershme e botës tjetër?

Sigurisht se animi më i natyrshëm i njeriut është drejt lumturisë, e cila është nevoja e tij. Ndërkohë, nëse të dyja botët shqyrtohen duke i vlerësuar siç e meritojnë, pikërisht atëherë arrihet rehatia dhe lumturia më e drejtë dhe më e vërtetë. Përndryshe njeriu mbytet ndërmjet mashtrimeve dhe devijimeve të përkohshme përgjatë gjithë jetës. Për shkak të kësaj, ndërkohë që është duke u mbytur, përsëri bie në humbje duke pandehur se ajo është rrugëzgjdhja.

O njeri! Mendo! Kush të ka krijuar ty? Kush të mban në jetë? Kush t’i plotëson nevojat? Ndërkohë që shpesh herë nuk mund ta mbrosh veten, kush është fuqia që të mbron nga çdo gjë? Ja pra, rehatinë dhe lumturinë e vërtetë kërkoje te dera e atij, sepse te dyert e tjera nuk ka kush të të japë frymë, nuk ka kush të ta krijojë rrëskun, nuk ka kush të t’i administrojë qelizat e panumërta të tuat, nuk ka kush të të falë mendje dhe zemër, nuk ka kush të të japë shpirt dhe nuk ka kush të t’i nënshtrojë ty tokën dhe qiejt!

Atëherë kuptoje mirë se, **“zemrat qetësohen / gjejnë prehje vetëm me përmendjen e Allahut!”** (Ra’d, 28) Domethënë se rehatia dhe lumturia janë të arritshme vetëm me Allahun, në formën që thotë dhe dëshiron Allahu, me nënshttrim ndaj Atij dhe duke e njohur, duke iu bindur dhe duke vrapuar për te Ai!

Të dyja botët janë të mbushura plot me përgëzime vetëm për ata që mund ta kuptojnë dhe zbatojnë këtë të vërtetë! Por përgëzimet në këtë botë të sprova arrihen prej vështirësive, vuajtjeve, problemeve dhe halleve. Domethënë, lumturia dhe rehatia e vërtetë u përket atyre që e shndërrojnë vuajtjen në hare duke vrapuar për te Allahu Teala përgjatë gjithë jetës! Ja, për këta është edhe lumturia e përhershme! Lum këta njerëz në të dyja botët!



Pjekuria në predikim

— Sami Byjkkajnak —

Në kuptimin leksikor, fjala “Tebliğ/predikim” do të thotë “Të dërgosh”. Ndërsa në kuptimin terminologjik do të thotë përpjekje për t’i takuar njerëzit me fenë islame. Po përpjekje... Ndërsa për të dhënë përpjekje serioze, patjetër duhet pjekuri. Domethënë, vetëm fjala nuk është aspak e mjaftueshme për predikimin.

Qenia, e cila quhet njeri, ngaqë është e krijuar me shpirt, nuk mjaftohet duke dëgjuar disa fjalë influencuese. Njeriu dëshiron të shikojë një pjekuri te ai që i thotë ato fjalë dhe një gjendje që të ndikojë në shpirtin e tij. Domethënë, kërkon një

bashkëbisedues që ta ketë ndërtuar veten dhe ta ketë mundësinë për ta ndërtuar edhe atë.

Një njeri që nuk ndërton veten, është e pamundur që të ndërtojë të tjerët që ka përballë tij. Për këtë arsye, lind pyetja: “A nuk ndërpritet predikimi nëse presim ndërtimin e një njeriu?” Abdullah ibn Mes’udi (r.a.), ka thënë: “Ne merrnim dhjetë ajete nga i Dërguari i Allahut (s.a.s) dhe e ndërtonim veten dhe të tjerët me to. Pastaj merrnim edhe dhjetë ajete të tjera.” Domethënë se ndërtimi i vetes duhet të jetë i njëkohshëm me ndërtimin e të tjerëve. Në të vërtetë, është e pamundur të

flasësh për një njeri që e ka pajisur veten me të gjitha gjërat që i duhen. Prandaj është shumë e vështirë që të themi: “Ja, ky është një njeri i edukuar plotësisht.” Nisur nga kjo, mund të tregojmë edhe një histori në lidhje me Mevlanën. Mevlana thotë:

“Një natë dola nga shtëpia. Po shëtisja diku rreth e rrotull. Papritur pashë edhe një burrë të shkretë që po shëtiste andej. E pyeta:

“Çfarë po kërkon në errësirën e natës?” Burri m’u përgjigj:

“Po kërkoj një njeri.” Atij i thashë:

“Për fat të keq, po lodhesh kot. Unë e kam lënë vendin tim, por prapë se prapë nuk kam gjetur njeri. Shko në shtëpi, shtrihu dhe qetësohu. Mos kërko kot, sepse është shumë e vështirë ta gjesh atë.”

Burri i shkretë më pa me plot dhimbjeje dhe më tha:

“Edhe unë e di se është shumë e vështirë, por ja që ndjej kënaqësi edhe nga të kërkuarit e tij. Andaj më lër të qetë!”

Domethënë se mungesa e burrave gjithmonë ka qenë problem i madh. Vallë, a e ka vuajtur këtë vështirësi edhe i Dërguari i Allahut (a.s.)? Domethënë, a i ka gjetur lehtë njerëzit që do ta përfaqësonin dhe do ta predikonin Islamin?

Ne vëmë re se të gjithë ata që kanë marrë mësim nga i Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, dhe ata që kanë kaluar nga shkolla e Islamit, janë edukuar deri në atë pjekuri sa ta përfaqësonin Islamin dhe ta predikonin atë.

Në të vërtetë, ata u bënë njerëz që e përfaqësonin Islamin me qëndrimet dhe mënyrën e jetesës së tyre. Për këtë arsye, i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“*Sahabët e mi janë si yjet në qiell. Këdo që të pasoni, do të udhëzoheni.*” (Mubarekfuri, Tuhfetu’l-Ahvezi, Kajro, pa datë, X, 226, nr: 3807.) Domethënë, të gjithë ata kanë nga një çelës që i çon njerëzit te Islami. Për shembull, Mus’ab ibn Umejri (r.a.), është mësuesi i parë i Islamit që e shndërroi Jethribin në Medine. Edhe pse ishte shumë i ri në

moshë, ai arriti një pjekuri të atillë në përfaqësimin e Islamit, sa që ndikoi te jethribasit me shëmbëlltyrën e tij dhe ata filluan të bëheshin myslimanë një nga një. Kur shkoi në Jethrib si mësuesi i parë, numri i myslimanëve ishte dymbëdhjetë. Vitin e ardhshëm numri i myslimanëve u bë shtatëdhjetë e dy. Ndërsa më vonë u shtuan shumëfish dhe u përgatit vendi për hixhretin e të Dërguarit të Allahut (a.s.).

Ky organizim i madh nuk u bë si në kohët e sotme në formën: “Merr libër, lexoje dhe shpjegoje!”, por përkundrazi, përparoi nga predikimi me dije dhe nga reflektimi i gjendjes shpirtërore. Ai nuk kishte në dorë ndonjë gjë të botuar, por kishte një transferim gjendjeje madhështore për t’ua mësuar të tjerëve ato që kishte mësuar nga i Dërguari i Allahut (a.s.), duke i zbatuar edhe vetë.

Në të njëjtën mënyrë, edhe Muadh ibn Xhebeli (r.a.), dha një përkje madhështore për islamizimin e Jemenit. Si rezultat, me qindra jemenas u bënë myslimanë nga dora e tij. Medinasi Muadh ibn Xhebeli (r.a.), i cili u bë mysliman në moshën tetëmbëdhjetëvjeçare në Besatimin e Dytë të Akabesë, e zbatoi Islamin dhe e predikoi atë duke kryer detyrën e kadiut, nëpunësit të zekatit dhe të mësuesit në Jemen me Kuranin Fisnik, me Sunetin e të Dërguarit të Allahut, alejhi’s-selam dhe me ixhtihadin e tij.

Një specifikë tjetër është edhe vullnetarizmi në detyrën e predikimit. Domethënë, të posedosh guximin për të thënë: “Unë mund të predikoj.” Për shembull,

i Dërguari i Allahut (a.s.), shpalli se do të dërgonte dikë për të predikuar Islamin në Jemen. Sapo dëgjuan këtë, Ebu Bekri (r.a.) dhe Umeri (r.a.), menjëherë u hodhën në këmbë duke thënë: “Të shkoj unë!” Në të njëjtën mënyrë, kur i Dërguari i Allahut (a.s.), dëshironte t’u dërgonte letrat e thirrjes për në Islam shteteve dhe fiseve përreth Arabisë në vitin e gjashtë të hixhretit, me qindra sahabë e kërkuan këtë detyrë duke u shprehur: “Ta çoj unë, o i Dërguari i Allahut!” Nëse këtë ngjarje e mendojmë nga këndvështrimi i kushteve të asaj kohe, kjo nuk ishte një detyrë që mund të kryhej

**MUS’AB
IBN UMEJRI (R.A.),
ËSHTË MËSUESI I
PARË I ISLAMIT QË E
SHNDËRROI JETHRIBIN
NË MEDINE. EDHE PSE
ISHTË SHUMË I RI NË
MOSHË, AI ARRITI NJË
PJEKURI TË ATILLË
NË PËRFAQËSIMIN E
ISLAMIT, SAQË NDIKOI
TE JETHRIBASIT ME
SHËMBËLLTYRËN E TIJ
DHE ATA FILLUAN TË
BËHESHIN MYSLIMANË
NJË NGA NJË.**


lehtësisht kështu siç shkruhet. Atëherë nuk ishin kushtet si kushtet në ditët e sotme që mund t'i hipësh avionit apo autobusit dhe të shkosh për të predikuar Islamin. Jo, jo, nuk ishin aspak këshu. Ai ishte një udhëtim që ndoshta mund të zgjaste me ditë të tëra mbi shpinën e kalit. Përveç të tjerash, përgjatë rrugës kishte shumë rreziqe. Vendi ku do të shkoni është një shtet apo fis i huaj. Ndërsa ju do t'ia lexoni kryetarit të shtetit apo fisit, i cili ishte i rrethuar nga dhjetëra roje, letrën e thirrjes për në Islam të Pejgamberit të fundit që sapo është dërguar. Rreziku për jetën është mjaft i lartë. Kërkimi i kësaj detyre të vështirë zgjoi një emocion të madh te sahabët e nderuar, të cilët e kishin bërë veti dalluese të tyre qëllimin madhështor si “dërgimin e ftesës së islamit në të gjithë botën”. Si rezultat, ata hynë në garë për ta marrë këtë detyrë duke thënë: “Unë e bëj!”

Qëllimi kryesor i predikimit të Islamit ishte përpjekja për të bërë Islamin dominues në vendin që shkohej dhe për t'u bërë shkak që Islami të arrinte te zemrat e njerëzve. Kjo në histori realizohej me ekspedita ushtarake. Historia islame shkruan përpjekjet e ushtarëve të Islamit që bënë rrugë prej shumë kilometrave me dashuri, mallëngjim dhe pasion për ta predikuar Islamin. Në ditët e sotme predikimi i Islamit bëhet me laps dhe me kanalet e rrjeteve sociale, por predikimi më i bukur është ai i ushtarëve vullnetarë që e kryejnë këtë detyrë me një pjekuri të përkryer përfaqësimi në tokat që nuk ka arritur Islami. Në këtë çështje përballë na del edhe një problem i tillë:

Cilin Islam do të predikojmë?

Sahabët e nderuar ishin me fat në këtë çështje, sepse atëherë kishte vetëm një Islam. Ata e predikuan atë Islam. Ndërsa sot kanë dalë në pah shumë komentime dhe shumë pasues të këtyre mendimeve. Dikush e predikon Islamin me pjekurinë e Ihsanit. Ndërkohë del dikush tjetër dhe thotë: “Çfarë ihsani? Mjafton Kurani dhe Suneti!” Pastaj del dikush tjetër dhe thotë: “Le ta kesh zemrën e pastër. Ti qëndro me mua dhe më bëj udhërrëfyesin tënd këtu. Kjo të mjafton!..”

Kur myslimanët shkojnë në ndonjë vend për të predikuar Islamin, hyjnë edhe në gara të padobishme me njëri-tjetrin, në mënyrë që të lartësohen duke shkelur me këmbë njëri-tjetrin. Për shkak të kësaj, edhe njerëzit nuk dinë se kujt t'i besojnë. Ndërkohë, faza e parë është shfaqja e përpjekjeve serioze për ta bërë Islamin të dashur te njerëzit. Nëse ju ia jepni virdin si parim kryesor dikujt që



nuk ka dëgjuar për Islamin dhe tentoni t'i ngarkoni menjëherë të gjitha dispozitat e Kuranit dhe Sunetit, atëherë do të nxirrni në pah gjysmë myslimanë që nuk e përvetësojnë Islamin, madje, që nuk mund ta pranojnë plotësisht të gjithë Islamin. Për këtë arsye, është shumë e dobishme që në fazën e parë të përdorim metodën profetike, sepse Islami vetëm në këtë mënyrë mund të gdhendet në zemrat e njerëzve.

Në metodën e të Dërguarit të Allahut (a.s.), baza është gradualiteti. Me personat që sapo kanë hyrë në Islam së pari duhet të përdorim metodën që është përdorur në Mekë. Atyre së pari duhet t'u jepet feja dhe besimi në ahiret duke biseduar sa më shumë rreth ajeteve të Kuranit Fisnik që kanë zbritur në Mekë. Më vonë, fazë pas faze, duhet t'u mësohet namazi, agjërimi, ndalesa e alkoolit, mbulesa, ndalesa e kamatës dhe ndalesa e bixhozit. Pastaj duhet t'u shpjegohen mirësitë e zbatimit të këtyre me pjekurinë që ihsani i jep njeriut. Predikimi është një proces i gjatë. Prandaj, nëse thoni: “Ta bëj këtë për një kohë të shkurtër dhe të kryej punë!” – atëherë nuk mund të edukoni një personalitet Islam në kuptim të përsosur.

Praktikuesi më i shkëlqyer i kësaj është ndërtesuesi i epokës së lumturisë, i Dërguari i Allahut (a.s.). Me këtë metodë të tij, Islami u përhap deri në largësi të mëdha për një kohë të shkurtër dhe fitoi zemra që e pranonin atë grupe-grupe. Kjo metodë nuk është e vështirë, por nuk është as e lehtë. Në fillim ka nevojë për njerëz të vendosur, të pajisur me besim dhe që ia kanë dhënë zemrën Islamit. Në fund të kësaj ka edhe këtë sihariq të mrekullueshëm:

“Nëse Allahu e takon një njeri me Islamin nëpërmjet dorës tënde, kjo është më e mirë për ty se sa të kesh deve të kuqe.” (Buhari, Fedailu'l-As'hab, 9.) Lum për ata që e meritojnë këtë sihariq!..

"Popullit të Medjenit Ne i dërguam vëllain e tyre, Shuajbin. Ai tha: 'O populli im, adhuroni Allahun! Ju s'keni tjetër zot përveç Tij. Mos bëni hile as gjatë matjes, as në kandar. Unë po shoh se ju gjendeni në begati dhe kam frikë se do t'ju godasë dënimi i një dite, që ju përfshin të gjithëve!"

(Araf, 85)

Kurani si shkak të shkatërrimit dhe dënimit të popullit të Lutit (a.s.), tregon degjenerimin moral, kurse si shkak të shkatërrimit të popullit të Shuajbit (a.s.), tregon degjenerimin e ndershmërisë dhe etikës në tregti. Shuajbi (a.s.), i ftoi ata të jenë të drejtë në marrëdhëniet e tyre tregtare. Kur ata nuk i vunë vesh thirrjes së Shuajbit (a.s.), Allahu i dënoi me një tërmet dhe një zhurmë të frikshme. Në ajetin e mësipërm tërheqja e vëmendjes për të qenë të kujdesshëm në matje dhe peshë vjen menjëherë pas urdhrit për të adhuruar vetëm Allahun. Thënë ndryshe, detyrimi ndaj individit është përmendur paralel me detyrimin ndaj Allahut. Kjo tregon që në sistemin e vlerave fetare detyrimet ndaj individëve zënë një vend shumë të rëndësishëm. Në ajetin e lartpërmendur Allahu tërheq vërejtje për dy padrejtësi, e para bërja shok Allahut dhe e dyta dhunimi i pasurisë së të tjerëve. Të dyja këto konsiderohen padrejtësi dhe mëkate të mëdha. Feja nuk na kërkon të zbatojmë vetëm detyrat ndaj Krijuesit, por në të njëjtën kohë na kërkon të jemi të drejtë dhe të sinqertë në marrëdhëniet me të tjerët. Ata që janë të drejtë me Allahun, janë të drejtë edhe në marrëdhëniet tregtare. Ata që bëjnë dredhi në marrëdhëniet tregtare, nuk mund të jenë të sinqertë në marrëdhëniet me Allahun.

Në kohën tonë, abuzimi në procesin e prodhimit të produkteve dhe veprimet

tregtare është bërë shumë shqetësues. Ajeti kuranor përfshin shumë aspekte të abuzimit në botën e biznesit, si cilësia e dobët, lënia mangut në sasi, përdorimi i substancave të dëmshme për organizmin, reklamimi i produkteve jocilësore, keqpërdorimi i punëtorëve etj. Sot fatkeqësisht, në shoqërinë tonë pasuria publike dhe shtetërore po keqpërdoret dhe shpërdorohet në masivitet. Njerëzit sillen përballë pasurisë publike në mënyre krejt të papërgjegjshme.

Shitblerja është një dukuri e pandashme e shoqërisë. Prandaj përhapja në të e dredhive, mashtrimeve dhe matrapazllëkut çon në degjenerimin shoqëror, sepse mashtrimi sjell me vete tronditjen e besimit midis njerëzve. Nga ana tjetër, fitimi i pasurisë përmes rrugëve të ndaluara çon në mëkate dhe humbjen e freskisë shpirtërore. Fitimi i pasurisë haram nuk sjell dëme vetëm mbi individin, por edhe mbi gjithë shoqërinë. Ai sjell humbjen e drejtësisë, e cila nga ana e saj çon në anarshi sociale. Anarshia sociale sjell humbjen e sigurisë dhe përhapjen e grupeve të jashtëligjshme, të cilat shkelin dhe nuk marrin parasysh respektimin e asnjë norme ligjore dhe morale. Pasojat e kësaj anarshie janë të detyruar t'i vuajnë të gjithë njerëzit pa përjashtim.

Transmetohet nga Aishja (r.a.),
se Pejgamberi -(a.s.)-, ka thënë:

"Allahu është i kënaqur me atë që, kur kryen një punë, e kryen në formën më të mirë të mundshme."

(Buhari)

Besimtarët janë urdhëruar t'i kryejnë detyrat shpirtërore apo materiale në mënyrë cilësore. Ai që e kryen punën e ngarkuar në mënyrën më cilësore dhe të mirë, ka sjellë në vend përgjegjësinë që ka para Allahut dhe para shoqërisë. Kush e kryen punën si duhet, në çfarëdo lloj fushe qoftë, është i fituar si në këtë botë, ashtu edhe në botën tjetër. Kurse një person që anashkalon punën dhe nuk e bën siç duhet, së pari ka gënjyer veten.

Zhvillimi dhe përparimi në çdo fushë, vjen duke bërë çdokush siç duhet punën që i takon. Përparimin dhe zhvillimin e meritojnë vetëm ata që e kryejnë detyrën e dhënë në mënyrën më cilësore dhe të mirë. Allahu nuk e jep suksesin sipas përkatësisë fetare, por sipas punës që bëjnë pa dallim, myslimanë apo jomyslimanë, besimtarë apo jobesimtarë. Suksesi u takon atyre që, pas përpjekjeve dhe marrjes së masava që duhen për të pasur sukses në fushën përkatëse, i mbështeten Allahut (xh.sh.). Allahu nuk i jep sukses një populli vetëm pse është besimtar, pa bërë përpjekjet e duhura. Gjendja e botës islame sot është një shembull tipik i kësaj të vërtete. Në të shkuarën, kur gjyshërit tanë, me të cilët mburremi sot, krijuan një qytetërim shembull për gjithë historinë e njerëzimit, e arritën këtë sukses duke punuar me seriozitet, me bindje dhe sinqeritet. Suksesi i arkitekt Sinanit, i cili me kryeveprat e tij sfidon kohën, ka ardhur si pasojë jo vetëm e gjenialitetit të tij, por edhe e dëshirës dhe përpjekjes titanike për të krijuar vepra cilësore. Nëse suksesi sot ndodhet në duart e qytetërimit perëndimor, është tregues i dembelizmit dhe i cilësisë së dobët të punëve që bëjmë prej shumë shekujsh. Niveli

i zhvillimit të një shoqërie është i ngjashëm me një grup provëzash që komunikojnë me njëra-tjetrën nëpërmjet gypave. Kur hidhet ujë në një provëz, niveli i ujit ngrihet në të gjitha provëzat; e njëjta dukuri shfaqet edhe te niveli i zhvillimit të një shoqërie. Kështu, mosfunksionimi siç duhet i institucioneve arsimore në një shoqëri, ndikon negativisht edhe tek individët e veçantë, por edhe tek institucionet e tjera. Dhe funksionimi i institucioneve është i lidhur drejtpërdrejt me nivelin e shoqërisë, sepse ata që punojnë në këto institucione janë individët e kësaj shoqërie dhe niveli i këtyre institucioneve nuk mund të jetë më lart se sa niveli i shoqërisë. Në një shoqëri të tillë është e shpeshtë dukuria ku individët apo institucionet akuzojnë njëri-tjetrin për mosmbarëvajtjen e punëve. Kjo ndodh, sepse askush nuk e bën punën e vet siç duhet. Ngritja e nivelit të një shoqërie bëhet me përfshirjen e gjithë shoqërisë, duke filluar nga kryetari deri tek individë më i thjeshtë; kur çdonjëri prej tyre të kryejë detyrën e vet siç duhet, atëherë përparon dhe zhvillohet shoqëria.

Një person që nuk e kryen punën e ngarkuar siç duhet, nuk është i mirëpritur as nga Krijuesi, as nga shoqëria.

MËSIMET QË NXJERRIM NGA HADITHI:

1. Besimtari duhet ta kryejë në formën më të mirë punën e dhënë.
2. Prej një pune pa cilësi nuk mund të merret një frut i mrekullueshëm.
3. Allahu kënaqet kur njeriu e kryen detyrën e dhënë siç duhet.

Një Hadith



LUMTURIA FAMILJARE

NJË PLAGË QË LËNGON: TRASHËGIMIA

Shpesh shtrohet pyetja: “Përse Kurani i ka dhënë gruas gjysmën e të drejtës së trashëgimisë në raport me burrin?” Kur thellohemi rreth urtësisë së kësaj dispozite themi se:

Islami nuk i ka ngarkuar gruas barrën e sigurimit të të ardhurave për jetesë, as për veten e saj e as për anëtarët e familjes. Kjo detyrë i përket gjithmonë burrave.

Kur është fëmijë, femra fillimisht është nën përkujdesjen e babait, nëse mbetet jetime është nën përkujdesjen e vëllait, xhaxhait, apo gjyshit. Kur martohet është nën përkujdesjen e bashkëshortit, nëse mbetet e ve është nën përkujdesjen e fëmijëve apo nipërve.

Kjo dispozitë vlen për të siguruar një ambient të qetë dhe të paqtë familjar në mënyrë që grua-ja të përmbushë detyrën e saj themelore, atë të edukimit të fëmijëve. Për më tepër, gratë si në të kaluarën ashtu edhe sot, kanë dhënë kontributin e tyre vullnetar në mirëqenien e familjes duke punuar si brenda ashtu edhe jashtë ambientit familjar.

Këto detyra janë më të përshtatshme për gra-

të, nisur nga natyra e krijimit më të brishtë dhe të butë në raport me burrat.

Në thelb puna e gruas është më e rëndë se ajo e burrit. A mund të ketë detyrë më të vështirë sesa edukimi i fëmijëve? Me cilin profesion mund të krahasohet misioni i edukimit të një nëne që rri zgjuar natë e ditë në shërbim të edukimit të fëmijës?

Ndërsa burri ka përgjegjësi si për familjen dhe

të afërmit e tij, ashtu edhe për atdheun, kombin e fenë. Natyra më e fortë dhe e qëndrueshme e burrit në raport me gruan është në përputhje me detyrimet e tij. Për rrjedhojë, hisja shtesë që i jepet burrit në mënyrë të tërthortë është në shërbim të përmbushjes së

nevojave të jetesës për bashkëshorten, vajzat, madje edhe nënën dhe motrat e tij.

Përkundër kësaj, grua nuk ka asnjë detyrim të harxhojë pasurinë e saj për askënd, me përjashtim të rasteve kur ajo dëshiron të shprehë bujarinë e saj.

Në shumë kultura djali është ai i cili siguron të ardhurat e familjes, ndërsa vajza shkon nuse në një familje tjetër.





Nisur nga kjo, shumë kultura e kanë përjash-tuar vajzën nga e drejta e trashëgimisë, veprim të cilin Islami e ka konsideruar padrejtësi dhe e ka refuzuar duke i dhënë si gruas ashtu edhe burrit të drejtat përkatëse.

Kështu Islami e ka lartësuar femrën duke i dhënë pjesën që meriton dhe duke e mbajtur atë larg çdo terreni akuzash për marrje të një trashëgimie të pamerituar.

Nëse bëjmë një përmbledhje, mund të themi se:

Në ligjin e trashëgimisë isla-me është vendo-sur ekuilibri i duhur midis detyrimeve dhe hiseve. Parimisht burri i cili ka shpenzime më të mëdha përfiton pjesë më shumë se gruaja. Sepse burri përveç detyrimit të mehrit dhe shpenzimeve të dasmës, është përgjegjës edhe për sigurimin e të ardhurave për familjen.

Pra, dallimi midis burrit dhe gruas në çështjen e hiseve të trashëgimisë është i lidhur me dallimin e detyrimeve të ndryshme të njëjës palë dhe tjetrës. Midis tyre është vendosur një ekuilibër i drejtë. Gruaja nuk konsiderohet përgjegjëse për sigurimin e të ardhurave familjare për shkak të detyrës së saj të vështirë të edukimit të brezit dhe sigurimit të mbarëvajtjes së punëve familjare. Për këtë arsye e drejta e saj për trashëgimi është përgjysmuar. Kjo pjesë e trashëgimisë është dhënë duke marrë parasysh rastin e grave që nuk kanë mundësi të martohen, që shkurorëzohen, apo për të përmbushur

disa nevoja të tyre personale.

Ata që kundërshtojnë ligjin kuranor të ndarjes së trashëgimisë me pretendimin se nuk është koherent nuk duhet të harrojnë këtë ajet në vazhdë të legjislacionit të trashëgimisë:

“Ndërsa atë që nuk i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe shkel kufijtë e vënë prej Tij, Allahu e shpie në zjarr, ku do të qëndrojë përherë dhe për të ka ndëshkim poshtërues.”

(Nisa, 14)

Grave u janë dhuruar virtyte të tilla, si: delikatesa, dhembshuria, mëshira, turpi, sakrificca, ndjesia e përkujdesjes ndaj fëmijëve dhe ruajtjes së brezit. Përgjithësisht ato nuk janë të fuqishme fizikisht, por zotërojnë një botë ndjesore shumë të thellë dhe ndjenja e mëshirës është shumë e lartë. Për rrjedhojë ato bien në dobësi fizike dhe shpirtërore në rast përballjeje me shumë të papritura të jetës. Kjo është arsyeja pse dëshmia e gruas në Islam ka vlerë të përgjysmuar.

DËSHMIA DHE GRUAJA

Rregulli dhe ekuilibri i përsosur që ka vendosur Islami bazuar në natyrshmërinë e krijimit të njeriut anashkalohe si rezultat i armiqësisë apo injorancës së atyre që e sulmojnë Islamin duke keqinterpretuar çështjen e dëshmisë së femrës.

E vërteta është se:

Allahu i Lartësuar krijoi çdo qenie për një qëllim të caktuar dhe i dhuroi atyre aftësitë fizike

*I Dërguari
i Allahut ka thënë:*

*“Më janë bërë të dashura
(nga Allahu) tri gjëra:
Namazi, drita e syve të mi,
Misku (era e mirë),
Gruaja e devotshme.”*

(Nesâi, Ishretu'n-Nisâ, 10)

(biologjike) dhe shpirtërore (psikologjike) për të qenë të aftë të përmbushin këtë qëllim. Krijuesi Fuqiplotë e krijoi mashkullin më të fortë fizikisht dhe më të qëndrueshëm shpirtërisht që të jetë i aftë të përmbushë ashtu siç duhet detyrën e tij për t'i bërë ballë jetës dhe për të siguruar jetesën e familjes.

Ndërsa gruaja mbart misionin e vyer të rritjes dhe edukimit të brezit të ri, duke e mbështetur dhe mbrojtur atë në kohët më delikate dhe të vështira. Për këtë arsye fuqia shpirtërore e saj është mbizotëruese ndaj asaj fizike, gjë që bën të mundur rritjen e fëmijës me mëshirë dhe dashuri atëherë kur ai është më i dobët dhe në fazat më të vështira të jetës.

Nëse gruaja ngarkohet me një detyrë tjetër përveç asaj që është në përputhje me natyrshmërinë e saj të krijimit kjo do të ishte humbje. Si rrjedhojë e mëshirës së saj, mundësia e devijimit nga drejtësia të një gruaje ndaj një fajtori është shumë e lartë. Kjo është një nga urtësitë hyjnore sepse dëshmia e gruas vlen sa gjysma e burrit.

Nga ana tjetër, Islami përcakton shkallën e dëshmisë në përputhje me strukturën psikologjike të njeriut. Në raste të caktuara dëshmia e burrit nuk merret për bazë, ashtu sikurse në raste të caktuara dëshmia e gruas pranohet në mënyrë të plotë. Për shembull, dëshmia e gruas konsiderohet e mjaftueshme aty ku prezenca e burrit është e pamundur.

Ata që pretendojnë se gruaja është e mangët duke marrë shkas nga dëshmia e përgjysmuar e saj nuk e kuptojnë apo nuk duan ta kuptojnë se Islami është larg këtyre akuzave përmes vendosjes së një ekuilibri të drejtë midis të drejtave dhe detyrimeve në përputhje me natyrshmërinë e krijimit pa harruar asnjë qelizë të shoqërisë.

NATYRA E KRIJIMIT E GRUAS DHE E BURRIT

Natyra e brishtë, e mëshirshme dhe e ndjeshme e gruas është më e përshtatshme në shërbim të edukimit të brezit.

Nëna mund ta kalojë natën zgjuar për fëmijën

e saj, por babai nuk mund ta përballojë këtë për një kohë të gjatë.

Fuqia fizike e meshkujve, aftësia e tyre për të gjykuar dhe arsyetuar me gjakftohtësi janë tipare të përshtatshme për të përmbushur detyrat e tyre të mbrojtjes së familjes dhe atdheut.

Prishja e natyrës së pastër të krijimit është bërë shkas i shfaqjes së grave të cilat nuk duan ta pranojnë mëmësinë.

Ndërsa nga ana tjetër janë shfaqur meshkuj që nuk janë orvatur të pranojnë detyrimet e tyre familjare.

Në fakt, nëse mendojmë më thellë shohim se kjo përpjekje për të barazuar meshkujt me femrat është në dëm të palës më të brishtë. I Dërguari i Allahut e ka krahasuar femrën me një kristal dhe ka bërë me dije se përkujdesja ndaj saj duhet të jetë e ndryshme nga ajo e meshkujve:

Në kohën kur udhëtimet bëheshin me deve, ato nxiteshin të ecnin me ritmin e shkretëtirës.

Në një udhëtim të tillë, një shërbëtor me emrin Enxheshe i nxiti devetë të ecnin më shpejt duke recituar ode (kaside). Por ky nxitim ishte i papërshtatshëm për gratë që gjendeshin brenda dhomëzave mbi deve.

I Dërguari i Allahut tha:

“O Enxheshe! Ki kujdes, mos të thyhen xhamat!” (Buhârî, Edeb, 95; Ahmed, III, 117)

Pra kuptimi i kësaj ishte lëvizja e karvanit me shpejtësi të përshtatshme për gratë. E vërteta është se ata që ndjekin teorinë e barazisë gjinore e detyrojnë gruan t'u përshtatet kushteve të burrit duke e shtrënguar atë të punojë në orare dhe kushte të njëjta. Kjo sjell zhdukjen me ngadalësi të delikatesës së femrës deri në ashpërsimin dhe tjetërsimin e natyrës së saj femërore.

FATKEQËSIA MË E HIDHUR E DITËVE TONA

Në epokën tonë ka nisur tashmë një garë artificiale dhe e padrejtë a barazisë midis burrave dhe grave. Kjo garë që bie në kundërshtim me tiparet e natyrshme të krijimit të gruas, ka sjellë

me vete dobësimin e rolit të gruas në familje dhe misionit të saj të mëmësisë duke rezultuar në dëmtimin e jetës familjare. Për këtë arsye rastet gjithnjë e në rritje të aborteve në ditët e sotme, nuk janë gjë tjetër vetëm se një formë e modernizuar e groposjes gjallë të vajzave të periudhës së inyorancës, pra një formë vrasjeje e këtij shekulli.

Dallimi midis femrës së sflitur dhe të lodhur të këtij shekulli me femrën e periudhës së inyorancës është tashmë vetëm një çështje gardarobe, thënë ndryshe ato i ndan vetëm mënyra e të veshurit. Kjo s'është gjë tjetër veçse fundi i një shoqërie të ndërtuar mbi parimet e një edukimi të pashpirt materialist.

TË DREJTAT E VËRTETA TË GRUAS

Islami ka hedhur hapat më të drejtë dhe më të qytetëruar në rrugën e mbrojtjes së të drejtave të gruas.

I Dërguari i Allahut e ka refuzuar konceptin e inyorancës ku burri është superior ndaj gruas.

Një ditë kur Pejgamberi ﷺ ishte në shtëpinë e vajzës së tij, Fatmës, nipërit Hasani dhe Husejni i kërkuan të pinin ujë. I Dërguari i Allahut fillimisht i dha Hasanit.

Fatma mendoi se i Dërguari i Allahut donte më shumë Hasanin. Ndërsa Pejgamberi ﷺ tha:

“Jo, por Hasani kërkoi i pari (ujë).” (shih: Ahmed, I, 101)

Pastaj tha:

“Trajtoni në mënyrë të barabartë fëmijët tuaj kur i shpërbleni. Nëse do të mbaja dikënd më lart, do të mbaja vajzat.” (Hejthemi, IV, 153; Ibn-i Haxher, el-Metâlibu'l-Âlije, IV, 69)

Në shumë hadithe vihet re një nxitje e veçantë për t'i edukuar vajzat në formën më të bukur.

“Kush ka tri vajza dhe është i butë ndaj tyre, i furnizon ato, i edukon ato dhe i marton ato, do t'i bëhet atij obligim hyrja në Xhenet.” (Ebû Dâvûd, Edeb, 120-121/5147; Tirmizî, Birr, 13/1912)

“Kush kujdeset dhe edukon dy vajza derisa ato të rriten, në Ditën e Gjykimit do të jemi unë dhe ai kështu dhe bashkoi gishtat e tij (pra së bashku).” (Muslim, Birr, 149)

I Dërguari i Allahut vlerën e gruas së devotshme e ka shprehur përmes këtyre haditheve:

“Më e mira e asaj që është në pronësi të njeriut është gjuha që nuk ndalet së adhuruari, zemra që nuk pushon së falënderuari dhe gruaja e mirë që e ndihmon bashkëshortin e saj të mbajë gjallë imanin.” (Tirmîdhî, Tefsîr, 9/9)

“Kjo botë (jetë) është një përfitim i përkohshëm. Krijesa më e çmuar që sjell përfitim në këtë botë është gruaja e devotshme.” (Muslim, Radâ, 64; Nesâî, Nikâh, 15; Ibn-i Mâxhe, Nikâh, 5)

“Më janë bërë të dashura (nga Allahu) tri gjëra:

Namazi, drita e syve të mi, Misku (era e mirë),

Gruaja e devotshme.”

(Nesâî, Ishretu'n-Nisâ, 10)

Zgjidhja e vetme, është kthimi nga rruga e sheriatit (fesë) dhe natyrshmëria e krijimit. Është mbrojtja e familjes sipas kritereve kuranore dhe profetike. Është respektimi i plotë i parimeve të mbulesës dhe kufirit midis hallallit dhe haramit. Është ndërtimi i familjes me mirësi, mëshirë dhe dhembshuri.

Allahu i begatofte fëmijët tanë, djemtë dhe vajzat tona! Qofshin dritë e syrit dhe kënaqësi e shpirtit. I shndërroftë brezat e rinj në vatër devotshmërie!

Amin!

*“Kjo botë (jetë)
është një përfitim i
përkohshëm.
Përfitimi më i çmuar
në këtë botë
është gruaja
e devotshme.”*

(Muslim, Radâ, 64)

Në këtë botë

kemi ardhur për të shkuar në ahiret

— Rabia Brodbeck —

Muaji i Ramazanit është një mundësi e paçmueshme për t'i bërë besimtarët t'i kthejnë zemrat e tyre nga kjo botë drejt ahiretit. Përgjatë muajit të Ramazanit njeriu mëson t'i thotë “jo” kësaj bote dhe “po” botës së përtejme duke mbajtur agjërim për tridhjetë ditë me radhë. Njeriu me ndihmën e agjërimin bëhet modest në këtë botë dhe i pasur në audiencën hyjnore. Agjërimi e tregon si të pavlefshme çdo gjë që i përket kësaj bote dhe si shumë të vlefshme çdo gjë që i përket ahiretit. I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: *“Kur të vijë muaji i Ramazanit hapen dyert e mëshirës, mbyllen dyert e xehenemit dhe lidhen shejtanët.”*

Përkushtimi në muajin e Ramazanit do të thotë përkushtim ndaj botës tjetër. Përkushtimi ndaj botës tjetër arrihet vetëm duke u kapur pas litarit (fesë) së Allahut. Allahu Teala thotë në ajetin e 103-të të sures Al Imran: *“Të gjithë mbahuni fort për litarin e Allahut (Kuranin) dhe mos u përçani! Kujtoni dhuntinë e Allahut për ju, sepse, kur ishit në armiqësi, Ai i pajtoi zemrat tuaja e, në saje të dhuntisë së Tij, u bëtë vëllezër. Dhe ju ishit buzë greminës së zjarrit, ndërsa Ai ju shpëtoi prej saj. Kështu, Allahu jua shpjegon shpalljet e Veta, që ju të drejtoheni në udhën e drejtë.”*

Nifferi thotë: “Litari për të cilin Allahu të ka sugjeruar ta kapësh është një mundësi dhe kjo mundësi është sheriati. Sheriati është mundësia më e fortë dhe e vërtetë. Drita që mund t'ia tregojë rrugën njeriut në errësirat e tokës dhe të detit është në dorën e Atij. Për atë që e vlerëson këtë mundësi dhe punon me të, do të ketë shpërblime. Tashmë mos i kërko ato që nuk duhet të kërkohen. Kthehu (hiq dorë) nga gjërat e padëshirueshme dhe përgjëroju Allahut, në mënyrë që të marrësh edhe ti nga ajo dritë.”

Për shkak se umeti i Muhamedit i përkushtohet ahiretit përgjatë muajit të Ramazanit, në tokë shfaqet ndikimi i ajetit të 103-të të sures Al Imran. Nëse



dëshirojmë t'i kthehemi natyrës sonë të pastër dhe t'i mbrojmë cilësitë e bukura që i kemi arritur, atëherë:

-Duhet të rendim pas së vërtetës në vend që të rendim pas interesave, famës apo pozitës.

-Duhet të përpiqemi për t'ju bërë rob Allahut dhe të largohemi nga të qenët rob i shejtanit e i nefsit

-Duhet të bëhemi shërbëtorët e një sulltani të vërtetë duke e lënë të qenët mbret i një bote imagjinare që e formojmë në imagjinatën tonë.

-Duhet të largohemi nga dashuria ndaj kësaj bote e cila na drogon e na helmon dhe të fillojmë të marrim serumin e dashurisë që na jep shërim.

-Duhet t'i dorëzohemi fuqisë së tërheqjes hyjnore e cila na shpie te shpëtimi para se të kaplohemi nga joshja e kësaj bote e cila na shpie në falimentim.

-Duhet të ndjekim mallin që shpirti ndjen ndaj poseduesit të tij në vend që të ndjekim mallin që nefs ynë ndjen ndaj kënaqësive të përkohshme.

-Duhet të përpiqemi për t'u përfshirë nga përgëzimi: “Për ata nuk do të ketë as frikë, as pikëllim.”, në vend që të preokupohemi me telashet e kësaj bote.

-Duhet të bëhemi si Ibrahim (a.s.), i cili tha: “Nuk i dua ata që perëndojnë.”, në vend se të jepemi pas asaj që është e përkohshme dhe të preferojmë stilin e një jete jo të vërtetë.

-Duhet të posedojmë moralin e dhënies për hir të Allahut si umeti i një Pejgamberi që ka thënë: “O Aishe! Ato që mbeten për ne janë ato që kemi dhënë.”, duke e lënë mënjanë egoizmin.

Lidhja ndaj kësaj bote gjendet në rrënjët e të gjitha sëmundjeve. Ndërsa shërimi për të gjitha sëmundjet



gjendet te lidhja me botën e përtejme. Lidhja me dynjanë bëhet shkak që një besimtar të preferojë këtë botë në vend të ahiretit. Lidhja me dynjanë është shkaktarja e problemeve të pafundme. Nga Pejgamberi ynë i nderuar është transmetuar kjo thënie: *“Ai që e zgjedh dynjanë kundrejt ahiretit preket nga tri fatkeqësi: Vështirësi që nuk lehtësohen asnjëherë, varfëri që asnjëherë nuk shndërrohet në pasuri dhe uri që asnjëherë nuk ka ngopje prej saj.”*

Në Kuranin Fisnik thuhet: ***“Këta janë ata që jetën e kësaj bote e kanë blerë me jetën e ardhshme. Atyre nuk do t’u lehtësohet dënimi dhe askush nuk do t’u vijë në ndihmë.”*** (Bekare, 86)

“Por ju, përkundrazi, më shumë po e parapëlqeni jetën e kësaj bote, ndonëse jeta tjetër është më e mirë dhe e amshuar.” (A’la, 16-17)

“Atij që dëshiron shpërblim në jetën tjetër, Ne do t’ia shtojmë atë. Ndërsa atij që dëshiron shpërblim në këtë jetë, Ne do t’i japim pjesë prej saj, por ai nuk do të ketë pjesë në jetën tjetër.” (Shura, 20)

“Jeta e kësaj bote, nuk është gjë tjetër, veçse argëtim dhe lojë. Ndërsa jeta e botës tjetër, pikërisht ajo është jeta e vërtetë. Veç sikur ta dinin!” (Ankebut, 64)

Kjo botë nuk përbëhet vetëm nga forma që ne shikojmë. Por kjo botë mbart edhe kuptimin që të jesh i shkujdesur nga audienca e Zotit, nga mirësia e Tij, nga e vërteta e mëshirës hyjnore, nga përhershmeria, nga pavdekshmëria, nga ahireti, nga pafundësia, shkurtimisht nga Allahu (xh.xh.). Kjo botë përveç të tjerash mbart edhe kuptimin e mospasjes nevojë për Allahun, e mosmallëngjimit për Të dhe e privimit nga drita e bukurisë së Tij. Shprehur me një thënie tjetër, nuk mund të ndjejmë

dashuri për Zotin e botëve aq sa mund të ndjejmë dashuri për këtë botë.

Kjo botë është vendi i mbledhjes së frutave të ahiretit. Frutat e përhershmerisë dhe mirësia hyjnore fitohen në skenën e kësaj bote. Pra, ato arrihen nëpërmjet përpjekjeve që shfaqim në jetën e përditshme. Muhjiddin Ibnu’l-Arabiu (k.s.), ka thënë: *“Ndërsa natyra shpirtërore e njeriut ringjallet në formën e dijes, trupi ringjallet në veprat që ka bërë.”*

Qëllimi i atyre që i kanë besuar njësimi hyjnor dhe janë bërë prej umetit të Muhamedit është që të arrijnë vetëdijen me të cilën do t’u tregojnë njerëzve se duhet të gjejnë ujë në shkretëtirën e kësaj bote. Synimi i këtyre besimtarëve është arritja e vetëdijes se njerëzit kanë ardhur në këtë botë për t’u kthyer në botën tjetër. Vetëm me dashurinë ndaj Allahut që arrihet në këtë botë mund ta duam Atë deri në pafundësi. Qëllimi i të gjitha punëve dhe i ekzistencës sonë në këtë botë është që të mësojmë se si duhet t’i drejtohem Zotit (xh.xh.), shpirtërisht dhe fizikisht. Vetëm përgjërimi ndaj Allahut Teala mund t’i afrojë krijesat tek Krijuesi.

Shpirtin e fesë islame mund ta përjetojmë duke iu kthyer Allahut, duke u strehuar te Ai, duke iu drejtuar Atij, duke u zhytur në detin e përhershmerisë, duke e falur namazin dhe duke u kapur fort pas Fatihasë, sexhdes dhe Kuranit Fisnik. Ato që na bëjnë ta përjetojmë esencën e Islamit janë dashuria dhe meditimi. Ajo që na bën ta përjetojmë thelbin e Islamit është dashuria për bindje, besim, nënshtrim, xhihad, infak dhe ibadet ndaj Zotit (xh. xh.). Ajo që na bën ta përjetojmë esencën e Islamit është përpjekja e vazhdueshme plot dashuri që bëjnë përgjatë jetës sonë (për t’i zbatuar urdhrat e Allahut). Gjithashtu është edhe të shpëtuarit nga egoizmi, shërimi nga sëmundjet shpirtërore, kujdesi kundrejt fatkeqësive dhe largimi nga injoranca, mungesa e vetëdijësimi dhe lidhjet me interesat e kësaj bote. Çështja themelore dhe qëllimi kryesor i jetës sonë është arritja e një zgjimi shpirtëror. Mevlana thotë: *“Nëse Allahu i ka krijuar qiejt, i ka krijuar për të plotësuar nevojat (e të tjerëve). Kudo që ka ndonjë sëmundje, aty është edhe shërimi. Kudo që ka varfëri, aty shkon mirësia. Kërko nga Allahu që të ta mundësojë të marrësh mësim dhe të të zgjojë. Mos i kërko këto nga librat, fjalët dhe shkronjat.”*

Njerëzit vetëm me fitoren e dashurisë mund ta gjejnë prehjen, drejtësinë, të vërtetën dhe të qenët të barabartë me njëri-tjetrin, sepse, njeriu mund t’i nënshtrohet Zotit dhe ta adhurojë Atë vetëm nëse shërohet nga sëmundjet e kësaj bote. Frutat mund të mblidhen vetëm në këtë gjendje. Një njeri i tillë bëhet hero për të gjithë njerëzit e tjerë dhe bashkëjeton me ta.



Një lutje dhe një mallkim

— Irfan Ežturk —

Një sahab i tha të Dërguarit të Allahut (a.s.): “Të jap besën për hixhret dhe xhihad. Sevapin e këtyre e shpresoj nga Allahu.” Ndërsa i Dërguari i Allahut, alejhi’s-selam, e pyeti: “A e ke ndonjërin prej prindërve gjallë?” Sahabi i tha: “Po, që të dy janë gjallë.” I Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, e pyeti: “Ti dëshiron të fitosh sevape nga Allahu, apo jo?” Sahabi iu përgjigj: “Po.” Pastaj, i Dërguari i Allahut (a.s.), i tha: “(Atëherë) kthehu te prindërit e tu dhe përkujdesu për ta!” (Buhari, Xhihad, 138, Edeb, 3; Muslim, Birr, 6.)

Haku i prindërve është aq shumë i rëndësishëm, saqë Allahu i Lartësuar kënaqësinë e Tij e ka lidhur me kënaqësinë e atyre. I Dërguari i Allahut (a.s.), na njofton kështu për këtë të vërtetë: “Kënaqësia e Allahut Teala fitohet duke kënaqur prindërit. Ndërsa zemërimi i Allahut Teala tërhiqet duke zemëruar prindërit.” (Tirmidhi, Bir, 3/1899.)

Ata që i kënaqin prindërit, e kënaqin edhe të Dërguarin e Allahut (a.s.). Gjithashtu meritojnë edhe këtë lutje të Pejgamberit (a.s.): “Lum për atë që u bën mirësi prindërve! Allahu Teala ia shtoftë jetën!” (Hejsemi, VIII, 137.) Ndërsa ata që nuk i kënaqin dot prindërit dhe që i mërzhisin, meritojnë këtë mallkim të të Dërguarit të Allahut (a.s.): “U shkatërroftë, u shkatërroftë, u shkatërroftë ai që i arrin ditët e pleqërisë së prindërve apo të ndonjërit prej tyre dhe që nuk hyn dot në Xhenet!” (Muslim, Birr, 9, 10.)

O vëlla dhe motër! Nëse e keni nënën gjallë, vraponi dhe shkoni drejt e në shtëpi! Ja puthni këmbët! Nëse ka ndërruar jetë, lexo Kuran apo bëj ndonjë mirësi tjetër për të, në mënyrë që të fitosh kënaqësinë e saj!

Mosbindja ndaj prindërve dhe mosrespektimi i tyre mund të bëhen shkak që njeriu të japë shpirt pa besim në frymën e fundit. Në literaturën islame transmetohet se një fëmijë që nuk u bindet prindërve, edhe nëse vdes me besim, do të ndëshkohet në varr dhe kur të japë llogari para Allahut Teala në mahsher, do ta gjejë Allahun të zemëruar më të dhe do të hidhet në zjarr...

Haku i prindërve nuk mund të paguhet me asnjë lloj shërbimi që

fëmija mund t' u bëjë atyre. Në hadithin fisnik kjo e vërtetë theksohet me këtë përngjasim: *“Asnjë fëmijë nuk mund ta paguajë hakun e babait të tij. Por nëse e gjen atë rob, e blen dhe e liron, (vetëm atëherë) e ka paguar hakun e babait.”* (Muslim, Itk, 25; Ebu Davud, Edeb, 119-120; Tirmidhi, Birr, 8/1906.)

Sa bukur që e shpjegon këtë të vërtetë kjo histori:

Hasan el-Basriu një ditë po bënte tavaf Qaben. Ai rastisi me një djalosh që kishte një kosh në kurriz. Hasan el-Basriu (r.a.), e pyeti se çfarë kishte në kosh. Djaloshi i tha: “O imam! Në kosh kam nënën.” – dhe vazhdoi: “Ne jemi të varfër. Nëna ime u bënë shumë vite që dëshiron të vizitojë Qaben, por ne nuk kishim mundësi ekonomike për t'ia plotësuar dëshirën. Kaluan vitet e ajo u moshua. Nuk kishte asnjë lloj mundësie për të ardhur. Ajo fliste gjithmonë me përmallim për Qaben. Kur i kujtohej Qabja, nuk i mbante dot lotët. Unë nuk munda ta duroja më këtë gjendje të nënës. Prandaj e futa nënën në këtë kosh, e vura në kurriz dhe e solla nga vendlindja jonë, Shami deri në Qabe. Ja, tani po i bëj tavafin rreth Qabes. Thonë se haku i prindërve është i madh. O imam! A ia kam paguar nënës hakun me këtë që kam bërë?”

Hasan el-Basriu (r.a.), iu përgjigj: “Edhe nëse nëna jote do të ishte si Kabili dhe ta sillje shtatëdhjetë herë në kurriz nga Shami në Qabe dhe t'ia bëje tavafin në këtë mënyrë, prapë se prapë nuk do t'ia paguajë dot as hakun e një shkelmi që ke gjuajtur kur ke qenë në barkun e saj!”

Nëse te një njeri gjenden këto katër cilësi, Allahu (xh.xh.), e lëshon mëshirën e Tij mbi atë rob dhe e fut atë në grupin e njerëzve që i do:

1. Ai njeri që e nderon të varfrin si mysafir në shtëpinë e tij ose shkon për mysafir te i varfri.

2. Ai njeri që i mëshiron të sëmurët, të verbrit, të paralizuarit, sakatët e të tjerë të ngjashëm me këta.

3. Ai që nuk i ofendon, nuk i lëndon, por që i ndihmon robërit, punëtorët dhe ndihmësit e tij.

4. Ai që silltet me butësi kundrejt prindërve të tij, që ua bën të gjitha shërbimet në këtë botë dhe që i lutet Allahut për faljen e tyre.

O vëlla dhe motër! Le t' i përkujtojmë prindërit tanë me mirësi. Le të mos i kthejmë duarbosh nga dera jonë. Të mos i mërzisim dhe të mos i pikëllojmë. Le t' i gëzojmë dhe t' i lumturojmë me mirësitë që i bëjmë dhe që do t' i bëjmë. Respekti për të vdekurin është një cilësi që u përket vetëm njerëzve. Kafshët nuk e kanë këtë cilësi. Le të mendojmë dhe asnjëherë të mos e nxjerrim nga mendja se edhe

ne, në një të ardhme shumë të afërt, do ta shijojmë vdekjen. Edhe ne do të shpërngulemi nga kjo botë ashtu siç janë shpërngulur prindërit tanë. Nëse ne i përkujtojmë ata me mirësi, edhe fëmijët tanë do të na kujtojnë me mirësi. Njeriu korr atë që mbjell. Nëse i përkujtojmë shpirtrat e prindërve tanë me mirësi, edhe shpirtrat tanë do të përkujtohen me mirësi. Këtë duhet ta dimë në mënyrë absolute. E ardhmja është vdekja. Këtë të vërtetë duhet ta mendojmë që tani, në mënyrë që të përgatitemi dhe t' i marrim masat për atë ditë. Për këtë të vërtetë duhet t' i përgatisim edhe fëmijët tanë. Nëse ne do t' i përkujtojmë me nderim dhe mirësi prindërit tanë, mirësitë që i bëjmë dhe që do t' i bëjmë do të jenë një mësim për fëmijët tanë. Ndërsa ata do të na imitojnë ne duke u përpjekur t' i praktikojnë ato që kanë parë prej nesh.

Pakësimi i bindjes, mirësisë, respektit dhe dashurisë ndaj prindërve, sipas disa transmetimeve, është një argument i qartë se Kiameti do të ndodhë së afërmi. Qartazi dihet se mosbindja ndaj prindërve është prej shenjave më të rëndësishme të Kiametit. Nuk e di, prandaj desha të pyes: A ka bindje dhe mirësi tani kundrejt prindërve? A u dihet vlera prindërve?

Sipas një transmetimi, Xhebraili (a.s.), ishte pyetur nëse do të zbriste apo jo edhe një herë tjetër në këtë botë pasi e kishte përfunduar detyrën e sjelljes së shpalljes hyjnore te i Dërguari i Allahut (a.s.). Ai kishte dhënë këtë përgjigje: “Kur zbrita për herë të parë, e hoqa begatinë nga dynjaja. Kur zbrita për herë të dytë, e hoqa mëshirën nga zemrat. Kur zbrita për herë të tretë, e hoqa dashurinë dhe bindjen e mirësinë ndaj prindërve nga krijesat. Kur zbrita për herë të katërt, hoqa turpin. Kur zbrita për herë të pestë, hoqa frikën ndaj Allahut prej zemrave. Kur zbrita për herë të gjashtë, hoqa durimin nga i varfri. Kur zbrita për herë të shtatë, hoqa bujarinë nga të pasurit. Kur zbrita për herë të tetë, hoqa drejtësinë nga prijësit dhe udhëheqësit. Kur zbrita për herë të nëntë, hoqa Kuranin Fisnik dhe dispozitat e tij. Kur zbrita për herë të dhjetë dhe të fundit, hoqa besimin nga zemrat.”

Sigurisht se këto heqje janë bërë për shkak të mëkateve të njerëzve dhe lënies së cilësive të mira të mësipërme. Kur të Dërguarit të Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, iu pyetën shenjat e Kiametit në hadithin e Xhebrailit, ai u përgjigj:

“Kur robërit të lindin zotërinjtë e tyre.” Në këtë mënyrë është dhënë lajmi se në kohën afër Kiametit nuk do të ketë respekt aspak për prindërit. Madje, fëmijët do të sillen si zotërinj, ndërsa prindërit do të sillen si robër.

VIGJILENCA DHE NXITIMI

— Ahmet Zijlan —

Nëse njeriu i hedh një sy të kaluarës së tij, së pari në mendje i vinë momentet për të cilat është bërë pishman. Pishmanllëku nuk ka ndonjë dobi dhe nuk e sjell pas atë që ka ikur, por të jep përvojë. Nëse mendojmë edhe një herë për veprat ndaj të cilave jemi bërë pishman dhe gjendjet për të cilat ndjehemi të penduar, në shumicën e rasteve do të shohim se shkakua ka qenë nxitimi. Pastaj themi: “Si nuk e paskam menduar!” Por ja që nxitimi nuk na e ka dhënë mundësinë për të menduar. Po ashtu themi: “Si qenkam mashtruar?” Por ja që tamahu nuk na ka lejuar t’i shihnim edhe shenjat më të qarta. Ndër të tjera themi edhe kështu: “Si ka mundësi që paskam reaguar në atë mënyrë?” Por ja që zemërimi na i verbon sytë.

Me të vërtetë, shumë tragjedi dhe ngjarje të tmerrshme janë shkaktuar për çështje të vogla, për çështje aspak të rëndësishme dhe për detaje të pavlefshme. Sidoqoftë ato kanë kaluar tashmë, por ne duhet t’i shtjellojmë, t’i shqyrtojmë, t’i vlerësojmë dhe të ulemi e të mendojmë rreth tyre. Nxitimi, zemërimi, lakmia, ndërhyrja e menjëhershme... Këto nuk na e japin mundësinë që të bëjmë vlerësimin e domosdoshëm. Babai më ka pas treguar një histori që jepte këtë mesazh: “Mos i beso çdo gjëje! Mos i beso menjëherë çdo gjëje që të thuhet!”

Në një fshat jetonte një familje. Një

burrë dhe një grua... Një ditë burri ishte nxehur dhe i kishte thënë gruas së tij: “Grua, çfarë është kjo që bën ti? A nuk kemi ne grurë të mirë? Mos vallë nuk kemi mulli? Cili është shkakua i kësaj? Goja ka filluar të na dhembë tashmë.” Gruaja e tij e vari surratin, i zgurdulloi sytë dhe filloi të fliste:

-Ah ajo motra jote!..

-Çfarë ka motra ime?

-Ajo i fryn miellit.

-Si ka mundësi?

-Kur unë e bluaj miellin, ajo i fryn nga shtëpia e saj. Për këtë arsye, fryma e saj e merr të gjithë miellin dhe ngelin vetëm krundet. Si rezultat, edhe buka del e tillë.

Burri i tha: “Ja tregoj unë asaj.” Pastaj u ngrit dhe shkoi në fshatin ku banonte motra e tij.

Po, kunata që akuzonte gruaa e tij banonte në një fshat të largët. Por ngaqë burri e kishte mendjen mashkull, u besoi fjalëve të gruas së tij. Prandaj edhe shkoi për t’i kërkuar llogari motrës së vet. Ai shkoi te ajo dhe i tha: “Motër, a aspak nuk ke ndërgjegje? Përse i fryn miellit kur gruaa ime e bluan atë? Shiko, për shkakun tënde, ngelin vetëm krundet. Prandaj s’po



e ha dot bukën e shtëpisë. Goja pothuajse do të më bëhet me plagë. Përse e bën këtë?”

Motra e kuptoi gjendjen e mjerë të vëllait të saj, prandaj nuk i tha: “Për çfarë fryrje e ke fjalën?” – por u soll me qetësi dhe iu përgjigj: “Ah sa keq po më vjen! Ah sa keq po më vjen për ty vëlla! Unë nuk e paskam kuptuar këtë. Nuk e paskam kuptuar se mund të ngelnin vetëm krundet. Kam bërë gabim, prandaj të kërkoj ndjesë për këtë. Eja, hyr brenda, sepse dua të të bëj një ëmbëlsirë. Të paktën ta kompensoj kështu gabimin tim. Meqë ke ardhur deri këtu, dua të të bëj një ëmbëlsirë.”

Vëllai hyri brenda, u ul dhe filloi të priste. Ai priti shumë gjatë, por ëmbëlsira nuk erdhi. Më së fundi u mërzit dhe shkoi në kuzhinë:

-Motër, ti sikur do të më bëje një ëmbëlsirë?

-Po vëlla. Ajo po bëhet.

-Ku është?

-Ja, këtu është.

Vëllai pa një tenxhere të varur në tavan... Nën tenxhere ishte një qiri i ndezur... Ai i tha motrës së tij:

-Motër, kjo ëmbëlsirë nuk bëhet as për një javë në këtë mënyrë. Ky qiri nuk paska nxehur dot as veten e tij.

-Mirë, vëllai im i mençur. Ti e kupton se ëmbëlsira nuk mund të bëhet me një qiri nën tenxhere, por përse nuk e kupton së fryma ime nuk mund ta marrë miellin që bashkëshortja jote e bluan në fshatin tënd edhe nëse i fryj nga këtu?

Kjo është thjeshtë një histori që është ekzagjeruar shumë, në mënyrë që çështjet e tilla të kup-tohen sa më mirë. Nisur nga kjo, po të mendojmë pak, a nuk shohim shpesh herë se shumë paragjykime të njerëzve janë budallallëqe të paktën sa shembulli që dhamë më sipër?..

Zonja e shtëpisë e kishte ndarë mendjen për t'i bërë keq kumatës. Ajo kishte vendosur t'ia hidhte kumatës edhe fajet e saj. Ja pra, truri i njeriut mund të prodhojë mendime të tilla dhe njerëzit

mund të mashtrohen ndaj këtyre gjërave. Në këtë histori burri përfaqëson të vepruarit pa menduar, ndërsa motra e tij përfaqëson gjetjen e zgjidhjes duke menduar.

Një ngjarje të ngjashme me këtë e kam dëshmuar edhe vetë. Ishte koha kur patëm marrë një frezë dhe e patëm sjellë në Gaziantep... Para nesh, edhe dikush tjetër që e njihnim, pati marrë një frezë, e pati sjellë në Gaziantep dhe punonte me të. Ne u bëmë rivalë, por jo armiq. Flisnim, bisedonim dhe shkonim e vinim me njëri-tjetrin. Edhe vendet tona të punës pothuajse ishin afër.

Në muajt e parë sollëm një mjeshtër nga Stambolli me mendimin për të mësuar prej tij, ngaqë nuk dinim të punonim mirë me frezën. Ky mjeshtër ishte edhe koleg, edhe patriot i pronarit tjetër të frezës. Që të dy ishin nga Malatja... Madje, edhe njiheshin me njëri-tjetrin.

Mjeshtri do të punonte, do të na mësonte punën dhe ne do të përparonim. Deri diku dinim, por ne donim ta mësonim edhe më mirë punën. Mjeshtri ishte një djalë i ri. Ai ia filloi punës. Një ditë unë po kthehesha te vendi i punës nga diku. Befasisht vura re se para vendit të punës së rivalit tonë ishin mbledhur disa njerëz. Me vete thashë: “Qoftë e hajrit inshallah!” – dhe shkova për të parë. Kur arrita te njerëzit, nuk u besova dot syve të mi: “Mjeshtri ynë po zihej me grushte me rivalin tonë.” Hyra brenda dhe u thashë:

“Çfarë po ndodh këtu? Ndaloni një herë që të dy! Ti je mjeshtri ynë. Përse vjen këtu dhe zihesh me rivalin tonë?”

Mjeshtri filloi të mbronte veten: “Si të mos zihem? Këta po lozin me bukën e gojës sime. Po ashtu, po luajnë edhe me bukën e gojës suaj.” Unë e pyeta:

“Çfarë ka ndodhur? Hajër Inshallah!” Mjeshtri m'u përgjigj:

“Unë e ndala makinerinë për t'i ndërruar thikat. Ndërkohë që po merresha me të, brenda hyri një

SHUMË TRAGJEDI
DHE NGJARJE
TË TMERRSHME JANË
SHKAKTUAR PËR ÇËSHTJE
TË VOGLA, PËR ÇËSHTJE
ASPAK TË RËNDËSISHME
DHE PËR DETAJE
TË PAVLEFSHME.
SIDOQOFTË ATO KANË
KALUAR TASHMË, POR
NE DUHET T'I SHTJELLOJMË,
T'I SHQYRTOJMË, T'I VLERËSOJMË
DHE TË ULEMI E TË
MENDOJMË RRETH
TYRE...

fëmijë që e kishin dërguar këta. Unë nuk e pashë fëmijën kur hyri. Ai menjëherë e ndezi makinerinë. Për shkak të kësaj, të gjitha thikat u bënë copë-copë. Ja, kjo është loja e atyre!”

Menjëherë e pyeta: “Nga e kuptove se e kanë dërguar ata fëmijën?” Ai m’u përgjigj: “I bërtita fëmijës dhe e pyeta: A ata nga Malatja të dërguan? Fëmija e pranoi se e kishin dërguar ata.”

Ndërsa rivali ynë betohej në Zotin (xh.sh.), se nuk kishte aspak lidhje me këtë ngjarje. Në të vërtetë, rivali ynë kishte të drejtë... Nëse i bërtet një fëmijë 8-9 vjeçar, ai pranon çdo gjë për shkak të frikës. Kjo ishte e gjitha ajo që kishte ndodhur. Në fakt, fajin e kishte mjeshtri ynë. Nëse makineria hapet siç e kishte hapur ai për të kryer punë sa më shpejt, mund të shkaktojë aksident. Edhe fakti që kishte kthyer kurrizin dhe nuk e kishte parë fëmijën, ishte një gabim tjetër i tij. Por ja që edhe aksidenti kishte ndodhur. Menjëherë pasi kishte ndodhur aksidenti, mjeshtrit tanë i kishite shkuar mendja te rivali dhe kishte menduar: “Ata duhet ta kenë dërguar fëmijën?” Paragjykim shumë problematik.

Diçka e papranueshme, por ja që mjeshtri e kishte besuar këtë dhe e kishte detyruar edhe fëmijën që ta pranonte. Pastaj e kishte kapur fëmijën për dore, e kishte çuar te vendi i punës së rivalit dhe kishte filluar të zihej me të. E gjitha kjo nga një paragjykim...

Vendi i punës sonë me vendin e punës së rivalit, të paktën ishte 150 m larg. Pra, si çështja e kунatës që i frynte miellit nga fshati tjetër... Rivali nuk kishte mundësi nga ta dinte se mjeshtri e kishte hapur makinerinë në atë mënyrë pa marrë asnjë masë mbrojtëse. Atëkohë nuk kishte as telefona inteligjentë dhe as kamera...

Pasi e pashë gjendjen, qëndrova jo në krah të mjeshtrit, por në krah të rivalit tim. Domethënë, mbajta anën e atij që nuk kishte faj. Mjeshtrit i thashë: “Vërja gishtin kokës! Ti i paske besuar një gjëje që s’ka lidhje aspak me të vërtetën. Ndërsa tani po përpiqesh të na bësh edhe ne të të besojmë.”

Po sikur edhe unë të isha zhytur në grindje dhe të kisha thënë: “Nëse e thotë mjeshtri këtë, ai ka të drejtë.” Sigurisht se do të isha bërë ortak në padrejtësi. Për këtë arsye, i kërkova ndjesë rivalit. Pastaj e rregulluam makinerinë dhe vazhduam punën tonë.

Në jetë mund të ndodhin gjëra të tilla. Prandaj duhet të jemi të kujdesshëm, largpamës dhe të mos i paragjykojmë të tjerët. Gjithashtu nuk duhet t’u besojmë atyre që sjellin fjalë që janë krejt budallallëqe. Edhe ajeti fisnik na paralajmëron në lidhje me këtë temë. Allahu Teala thotë në Kuranin Fisnik: **“O ju që keni besuar! Nëse ndonjë njeri i pandershëm ju sjell ndonjë lajm, sigurohuni mirë (në është i vërtetë), për të mos i bërë dëm ndokujt pa dashje, e të pendoheni pastaj për atë që keni bërë.”** (Huxhurat, 6) Shkak për zbritjen e këtij ajeti fisnik ishte bërë një ngjarje e tillë:

I Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, e kishte çuar një burrë për të mbledhur zekatin e një vendi, por ja që burri i dërguar kishte pasur probleme me fisin ku ishte dërguar. Ai kishte pasur një grindje me ata para Islamit. Për këtë arsye, ishte frikësuar prej tyre. Kur ishte afruar te vendi, i kishte parë ata që kishin dalë për ta pritur. Për shkak të frikës, kishte menduar disa gjëra të pavërteta në lidhje me ata në atë çast dhe ishte kthyer në Medine... Kur shkoi te i Dërguari i Allahut (s.a.s.), i tha:

“Ata deshën të më vrisnin! Zekatin nuk ma dhënë!...” Kjo në atë kohë kishte kuptimin e kryengritjes ndaj autoritetit, sulmim i të dërguarit të shtetit dhe mospagim i taksës... Pra, pothuajse ishte një shkak që mund të nxirrte luftë, por ja që i Dërguari i Allahut, alejhi’s-salam, e verifikoi këtë ngjarje dhe e mësoi të vërtetën. Ajeti fisnik i mësipërm ishte shpjeguesi i kësaj ngjarjeje. Prandaj nuk duhet të bëhemi lojë e thashethemeve dhe nuk duhet të veprojmë sipas atyre që dëgjojmë apo që thuhën... Si rezultat, duhet ta verifikojmë, të sigurohemi se është e vërtetë dhe pastaj të vendosim.

Sot interneti është i mbushur me thashetheme, fjalët mbarten shpejt në të katër anët. Për këtë arsye, të gjithë fillojnë të paragjykojnë. Më vonë dalin lajme të tjera që vërtetojnë se nuk ishte ashtu. Vendi është mbushur me lajme të pavërteta, propagandë të zezë dhe ngjarje të tmerrshme... Dikush përfiton prej këtyre. Prandaj edhe i bëjnë me mendimin: “Hidh baltë, sepse sidoqoftë do të ngelë njolla e saj.” Këto janë gjëra që njerëzit i kanë bërë në çdo periudhë. Nisur nga kjo, besimtarët duhet të jenë të mençur dhe gjakftohtë.

Çfarë ndodh nëse nuk jemi të mençur dhe gjakftohtë?... Ndodh zemërim, grindje, probleme...

Zemërimi, ashpërsia dhe agresiviteti janë gjëra

që i shëmtojnë sjelljet e njerëzve. Ndërsa butësia dhe lehtësimi gjithmonë nxjerrin në pah bukurinë. I Dërguari i Allahut (s.a.s.), thotë në një hadith fisnik: *“Kudo që ka lehtësi, ka bukuri. Çdo gjë që nuk ka lehtësim është e shëmtuar.”* (Muslim, Birr, 78.)

Kjo ngjarje tjetër është shembull për të dyja gjendjet:

Pesë shokë të mi rreth të tridhjetave, kishin shkuar për piknik në njërin prej fshatrave të Gaziantepit. Pasi kishin ngrënë, pirë, argëtuar dhe pushuar, kishte ardhur koha për t’u kthyer. Ata kishin një makinë, por ishin shoferë të rinj. Rruga e fshatit ishte e ngushtë. Njëra anë e rrugës ishte pyll dhe ana tjetër ishte vresht.

Në anën e vreshtit 8-10 veta kishin qenë duke mbledhur rrush. Ndërkohë që shoku im kishte dashur të kthehej mbrapsht, makina kishte rrëshqitur dhe kishte shkelur një rrënjë rrushi. Pesë-gjashtë veshë rrushi ishin prishur.

Një i moshuar rreth të 50-60-tave, i cili ishte në krye të atyre që po mblidhnin rrushin, kishte marrë hov dhe kishte shkuar te shokët e mi duke bërtitur:

“Si mund të ma shkëlmi vreshtin ju mua? Si mund të ma prishni rrushin? Ju prej Antepi nuk të lini të shisni as një shportë me rrush përpara dyqanit tuaj. Ndërsa këtu vini dhe më prishni rrushin!..”

Njëri prej shokëve të mi i kishte thënë i qetë dhe me gjakftohtësi: “Xhaxha, ishte aksident. Nuk e bëmë me dashje. Çfarëdo dëmi që të kemi bërë, mund t’ju paguajmë. Vetëm mos na e thyej zemrën neve të pestëve këtu.”

Kjo përgjigje e butë e kishte zbutur edhe xhaxhain e moshuar. Për këtë arsye, u kishte thënë: “Atëherë nuk ka problem. Mund të ikni.”

Në fakt, ai ishte një i moshuar rreth të 60-tave. Si mund të zihej me pesë djem të rinj? Por ja kështu e bën zemërimi njeriun... Shokët e mi kishin vazhduar t’i silleshin me butësi: “Xhaxha, na thuj sa bën rrushi që ta prishëm! Ne nuk dua

të të shkaktojmë ndonjë dëm.”

“Nuk bën asgjë. Meqë paskeni këtë gjuhë të butë, nuk është e rëndësishme edhe sikur t’i kishit prishur të gjithë.”

Një tjetër prej shokëve i kishte thënë: “Meqë nuk po i merr paratë e rrushit që e prishëm, a mund të blejmë prej atij rrushit që keni në shportë. Po më pëlqen aq shumë saqë më ngelën sytë në të.” Xhaxhai i moshuar ua kishte kthyer:

“Ndaloni një minutë!” Xhaxhai kishte shkuar te shporta e mbushur me rrush, e kishte marrë, ua kishte sjellë dhe u kishte thënë: “Hapeni bagazhin!” Pastaj e kishte futur në bagazh duke u thënë: “Merren dhe ndajeni me njëri-tjetrin!” Shokët e mi e kishin pyetur:

“Po paratë?”

“Nuk dua para për të.”

Të urtët thonë se gjuha e ëmbël e nxjerr gjarprin prej vrime. Gjuha e ëmbël e shndërron në një njeri bujar atë që shkon për t’u ngatërruar. Çfarë është zemërimi? Zemërimi është të nxehurit kur të preket ndonjë interes, ashpërsia që shfaqet kundrejt një dëmi apo padrejtësie dhe sjellje e prerë.

Nëse zemërimi bëhet për Zotin dhe për hir të Zotit, është i nevojshëm. Besimtarët e kanë të nevojshme që të shfaqin një seriozitet dhe ashpërsi të caktuar kundrejt zullumqarit, të padrejtisë, uzurpatorit dhe shfrytëzuesit.

Zemërimi e kalon mendjen në funksion rezervë. Përgjatë gjaknxehtësisë së momentit të zemërimit, bëhemi edhe gjykatës, edhe prokuror, edhe xhelat. Apo siç e shprehim në ditët e sotme, zemërimi shkakton ekzekutim pa gjykim. Për këtë arsye, besimtarët duhet të kenë dosje për të cilat të thonë:

“Sa mirë që paskam vepruar ashtu! Falënderimi qoftë për Allahun që paskam duruar! Shyqyr që nuk paskam nxituar.”

Zoti (xh.xh.), na bëftë të gjithëve prej të suksesshmëve!.. Amin!..

NËSE ZEMËRIMI BËHET
PËR ZOTIN DHE PËR
HIR TË ZOTIT, ËSHTË I
NEVOJSHËM. BESIMTARËT
E KANË TË NEVOJSHME
QË TË SHFAQIN NJË
SERIOZITET DHE ASHPËRSI
TË CAKTUAR KUNDREJT
ZULLUMQARIT, TË
PADREJTIT, UZURPATORIT
DHE SHFRYTËZUESIT.



Rënia dëshmor

POZITA MË SUBLIME PAS PROFECISË

— Doç. dr. Mustafa Karabaxhak —

Kuptimi leksikor i fjalës shehadet është: të dëshmosh, të gjendesh në audiencë, të perceptosh, të njoftosh, të marrësh lajm dhe të mësosh. Ndërsa kuptimi terminologjik fetar i kësaj fjale është përkufizuar kështu: Pozita që arrihet si rezultat i përpjekjes në rrugë të Allahut Teala për ta lartësuar fenë e Tij.

Atyre që e arrijnë gradën e shehadetit / rënies dëshmor, u thuhet shehidë / dëshmorë. Allahu i Lartësuar nuk dëshiron që të themi se ata janë të vdekur. Kjo shprehet qartë në ajetin fisnik të mëposhtëm:

“Dhe mos thoni për ata që vriten në rrugën e Allahut se janë të vdekur! Jo! Ata janë të gjallë, ndonëse ju nuk e ndjeni!” (Bakara, 154) Kur sahabët e pyetën të Dërguarin e Allahut, (a.s.), në lidhje me këtë ajet, ai u përgjigj:

“Shpirtrat e atyre (dëshmorëve) janë brenda te zogjtë e gjelbër. Këta zogj kanë kandila të varur në Arsh. Ata fluturojnë dhe shëtisin nëpër xhenet si të dëshirojnë, pastaj kthehen dhe futen në kandilët e tyre. Zoti i shikon ata dhe u thotë:

“A dëshironi ndonjë gjë?

Shehidët i thonë:

“Çfarë mund të duam më shumë! Në xhenet po hamë dhe po shëtisim si të dëshirojmë dhe po bëjmë një jetë shumë të bukur.” (Muslim, Imaret, 121.)

Çdo njeri që do të hyjë në xhenet, do të bëjë një jetë të kënaqshme. Ndërsa dëshmorët do të duan të kthehen përsëri në këtë botë dhe të bien dëshmorë. Kjo tregohet qartë në këtë hadith fisnik:

“Çdo njeri që do të hyjë në xhenet, nuk dëshiron të kthehet më në këtë botë. Çdo gjë që gjendet në tokë, gjendet edhe atje. Ndërsa dëshmori, kur të shikojë shkallën e lartë të rënies dëshmor, do të dëshirojë të kthehet dhjetë herë në këtë botë dhe të vritet e të bjerë dëshmorë në secilën herë.” (Buhari, Xhihad,

21; Muslim, Imaret, 108, 109.)

Grada e dëshmorëve është grada më e lartë pas gradës së profetëve. I Dërguari i Allahut (s.a.s.), thotë në hadithin fisnik:

“Dëshmorët ndryshojnë nga pejgamberët vetëm prej gradës së profecisë.” (Darimi, Xhihad, 20.)

Një njeri që kërkon të bjerë dëshmor me gjithë shpirt, do të jetë dëshmor edhe nëse ndërron jetë në shtratin e tij:

“Atë, që i kërkon Allahut me nijet të pastër që të bjerë dëshmor, Allahu do ta lartësojë në gradën e dëshmorëve edhe nëse do të vdesë në shtratin e tij.” (Darimi, Xhihad, 16.)

Kush janë dëshmorë

1. Ata që konsiderohen dëshmorë të vërtetë, domethënë, që konsiderohen dëshmorë nga dispozitat e kësaj bote dhe ahiretit:

Këta janë myslimanët që vdesin për lartësimin e fesë së Allahut Teala dhe për mbrojtjen e atdheut. Të tillët nuk lahen, nuk qefinosen, u falet namazi i xhenazes dhe varrosen me rrobat e tyre.

2. Ata që konsiderohen dëshmorë nga dispozitat e kësaj bote:

Të tillët janë hipokritët, që vdesin duke luftuar ndërmjet rreshtave të myslimanëve. Edhe këta nuk lahen, nuk qefinosen dhe varrosen me rrobat e tyre duke iu falur namazi i xhenazes si dëshmorët e vërtetë. Ngaqë këta nuk janë myslimanë, nuk mund ta marrin sevapin e të rënit dëshmor në ahiret, sepse grada e të rënit dëshmor u përket vetëm myslimanëve.

3. Ata që konsiderohen dëshmorë nga dispozitat e ahiretit:

Të tillët janë dëshmorët që lahen dhe qefinosen për shkak se nuk e mbartin njërin prej kushteve të dëshmorëve të vërtetë. Këta janë ata të cilët vdesin në mbrojtje të fesë, jetës, pasurisë dhe nderit të

tyre. (Ebu Davud, Sunne, 29; Tirmidhi, Dijat, 21.); ata të cilët vdesin nga sëmundje epidemike, nga dhimbja e barkut, nga mbytja dhe nga shembja e dheut. (Buhari, Xhihad, 30, Tib, 30; Muslim, Imare, 164-165.); ata që vdesin nga djegia, nga shtatzënia, nga lehonja dhe ata që vriten padrejtësisht. (Nesai, Xhenaiz, 14, 112, Tahrimu'd-Dem, 25.)

A ka vepra të tjera të barabarta me sevapin e rënies dëshmor?

Ka disa prej adhurimeve që kanë sevap sa sevapi i atyre që vdesin në rrugë të Allahut Teala. Nëse dikush vdes duke i kryer ato, merr sevapin e dëshmorit. Në hadithin fisnik thuhet:

“Ai që vjen në xhaminë time duke mos pasur asnjë qëllim tjetër përveçse për të mësuar diçka apo për t’u dhënë mësim të tjerëve, është në gradën e luftëtarit që lufton në rrugë të Allahut. Ndërsa ai që vjen në xhaminë time me ndonjë qëllim tjetër përveç këtij, është në gradën e atij që ruan ndonjë gjë të dikujt.” (Ibn Maxhe, Mukaddime, 17.) Vlerësimi i sevapit të atij që mëson dije dhe që ua mëson të tjerëve si i sevapit të muxhahidit që lufton, ka lidhje me inkurajimin dhe qëllimin e mirë, sepse në një hadith tjetër thuhet:

“Qëllimi i besimtarit është më i mirë se vepra e tij.” (Bejhaki, Shuabu'l-Iman, IX, 176.)

Përsëri në lidhje me qëllimin, ai që dëshiron të bjerë dëshmor me gjithë zemër, është dëshmor edhe nëse vdes në shtratin e tij:

“Atij që i kërkon Allahut sinqerisht që të bjerë dëshmor, Allahu ia jep gradën e dëshmorit edhe nëse vdes në shtratin e tij.” (Muslim, Imare, 157.)

Veçanërisht:

“Atij që kapet pas sunetit tim në kohën e trazirave të umetit, do t’i jepet sevapi i njëqind dëshmorëve.” (Ebu Nuajm el-Isfahani, Hiljetu'l-Evljia, VIII, 200.)

Allahu i Lartësuar, përveç mobilizimit të përgjithshëm, nuk e sheh të përshtatshme që të gjithë myslimanët të dalin në luftë:

“Nuk është mirë që besimtarët të shkojnë në luftë të gjithë njëherësh, por prej çdo bashkësie, një grup të mbetet mbrapa, që të thellohet në mësimin e fesë dhe kështu të këshillojë popullin e vet, mbasi të kthehet nga lufta, që t’i frikësohet Allahut.” (Teube, 122)

Kur besimtarët të kenë një ushtri që do të luftojë, ata të cilët nuk janë në ushtri duhet të ushtrojnë profesionet e tyre. Nëse është doktor, duhet të ushtrojë detyrën e mjekut, nëse është mësues, duhet të ushtrojë detyrën e mësuesit, nëse është student, duhet të studiojë mësimet, nëse është tregtar, duhet të vazhdojë tregtinë dhe nëse është bujk, duhet të merret me bujqësinë. Nëse të gjithë e ushtrojnë

profesionin e tyre në formën më të mirë dhe e kanë qëllimin për të arritur kënaqësinë e Allahut Teala duke u shërbyer myslimanëve, do të kenë dobi të mëdha si në këtë botë dhe në botën tjetër për ato që kanë bërë. Individët e një shoqërie të tillë, gjithmonë janë të lumtur. Për këtë arsye, nuk ka asnjë shkak që kjo shoqëri të mos përparojë. Madje, në lidhje me këtë që thamë më lart, nuk do të ishte gabim nëse shprehem kështu: Nëse një student, i cili studion në çfarëdo shkolle, ka si qëllim të sigurojë të ardhurat e familjes së tij dhe t’i shërbejë atdheut, popullit e fesë së tij, ky student merr sevap adhurimi për sa kohë që të studiojë, ngaqë ka nijetin e mirë. Gjithashtu, nëse vdes në këtë rrugë, merr sevapin e dëshmorit, Inshallah.

Gjërat që u premtohen dëshmorëve

Allahu Teala ka përgatitur mirësitë më të bukura për robërit që luftojnë dhe përpiqen në rrugën për të fituar kënaqësinë e Tij. Gradat e atyre të Allahut i Lartësuar do të jenë bashkë me pejgamberët dhe të sinqertët.

“Kushdo që i bindet Allahut dhe të Dërguarit, do të jetë me ata të cilëve Allahu u ka dhënë shumë dhunti: me profetët, me të sinqertët, me dëshmorët dhe me të drejtët! Eh sa shokë të mrekullueshëm janë këta!” (Nisa, 69)

“Kur të përballeni në luftë me mohuesit, goditini në qafë, derisa t’i rrskapitni e t’i shkatërroni ata dhe pastaj lidhini fort. Mandej ose i lironi me zemërgjerësi, ose me shpërblim, derisa të bëhet armëpushimi. Kështu bëni! Sikur të donte Allahu, do t’i shkatërronte ata, por Ai dëshiron t’ju sprovtojë juve me njëri-tjetrit. Ai nuk ua humb veprat atyre që vdesin në rrugën e Allahut. Ai do t’i udhëzojë ata, do t’ua përmirësojë gjendjen dhe do t’i shpjerë në Xhenet, të cilin ua ka bërë të njohur më parë.” (Muhammed, 4-6)

“Kurrresi mos i quani të vdekur ata që janë vrarë në rrugën e Allahut. Jo, janë të gjallë, duke u ushqyer te Zoti i tyre.” (Al Imran, 169)

“...Unë nuk do t’ia humb mundin askujt nga ju që ka bërë vepra, qoftë mashkull apo femër. Ju jeni njëllor (në shpërblim). Atyre që u shpërngulën, u dëbuan nga vatrata e tyre, u munduan në rrugën Time, luftuan dhe u vranë, Unë do t’ua mbuloj veprat e këqija dhe do t’i shpie në kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj, si shpërblim nga Allahu. Shpërblimi më i mirë është tek Allahu.” (Al Imran, 195)

Ajo që kemi për detyrë të bëjmë është përpjekja për të bashkëpunuar me njëri-tjetrit dhe ta shndërronim veten tonë në një njeri ideal, brezin tonë në një brez ideal dhe shoqërinë tonë në një shoqëri ideale. Kjo realizohet vetëm nëse përpiqemi ashtu siç duhet.



Si të shpëtojmë nga kurthi i hedonizmit?

GJËJA QË E SHKATËRRON NJERIUN DHE SHOQËRINË!

Ajnur Tutkun

Përse njeriu ta ndalojë veten nga ushqimi, pirja, shëtitja, veshja, argëtimi, etj., domethënë, nga të jetuarit me gjërat që i japin kënaqësi? Patatinat, biskotat, pijet, etj., të cilave u është shtuar shija me gjëra të ndryshme... Rrobat që u është shtuar joshja nëpër vitrina dhe markat që e bëjnë njeriun të ndjehet mirë... Qendra tregtare madhështore dhe qendra argëtimi... Lojëra emocionuese që luhen duke harxhuar para dhe pushime që bëhen në hotele luksoze... Nëse njeriu ka para dhe nëse është i shëndetshëm, atëherë, përse të mos argëtohet pa masë?!

Hedonizmi është një rrymë filozofike e zhvilluar nga ana e mendimtarëve të lashtë grekë, Aristiposi dhe Epikuri. Kjo rrymë filozofike mbron mendimin se vlera më e lartë në jetë është kënaqësia dhe se jeta ideale mund të arrihet me anë të saj. Ndërkohë që Aristiposi mbron mendimin se kënaqësia fizike e bën njeriun të ndjehet mirë, Epikuri thekson se kënaqësia shpirtërore është më e rëndësishme dhe ideale.

Në ditët e sotme njerëzit nuk thonë haptazi: “Unë rend pas hedonizmit!” Por ata që i japin lirisë kuptimit: “Bëj çfarëdo që dëshiroj.”, ata që sillen sikur nuk kanë ndonjë hall tjetër përveçse të hanë e të pinë, të shëtisin, të dëfrehen, të argëtohen dhe të shpenzojnë, ata që nuk i kuptojnë përgjegjësitë e tyre, ata që nuk kanë asnjë qëllim dhe synim abstrakt dhe ata që bëjnë gjithmonë çfarëdo që u do qejfi, nuk janë gjë tjetër përveçse hedonistë tipikë. Ndërsa gjendja e atyre që tashmë nuk kënaqen dot me asnjë lloj argëtimi dhe kënaqësie, është patologjike dhe që ka nevojë për t’u mjekuar.

Ka shumë prej atyre që blejnë rroba menjëherë sapo t’i shohin, edhe pse nuk kanë nevojë. Ka prej atyre që formojnë grumbuj frutash e perimesh të kalbura nëpër frigoriferë duke marrë më shumë se ç’kanë nevojë dhe prej atyre që nuk arrijnë të bëhen të lumtur, edhe pse i ndryshojnë mobilet sa herë

që dëshirojnë. Te këta lloj njerëzish, konceptet, si të mjaftuarit me atë që kanë, falënderimi i Zotit për mirësitë, kujdesi që shfaqet kundër shpenzimit të tepruar etj., nuk gjejnë dot kuptim në asnjë lloj mënyre. Tashmë ka ardhur koha dhe po kalon madje, që ne njerëzit, si të rinjtë që nuk mund t’i përballojnë dot shpenzimet e pritshmërive të tyre në kuptimin e argëtimit dhe dëfrimit, gratë që nuk mund t’i plotësojnë dot gjërat që mendojnë se u mungojnë dhe burrat që nuk u mbarojnë gjërat e nevojshme për punë, ta kuptojmë se po e çojmë individin, familjen, shoqërinë, vendin dhe të gjithë botën në prag të falimentimit!

Fëmijët që rriten duke iu plotësuar çdo lloj nevojë në moment dhe më shumë se kanë dashur, fëmijët që rriten nga prindërit e tyre duke përvetësuar një jetë me në qendër fëmijën dhe fëmijët e pangopshëm që rriten duke i ndarë kënaqësitë, por jo edhe përgjegjësitë, sigurisht që do të bëhen egoistë, hedonistë dhe komfortistë.

Prindërit që posedojnë këndvështrimin: “Unë nuk kam pasur dot, ai le të ketë! Unë nuk kam bërë rehati, ai le të bëjë! Unë jam shtypur shumë, ai le të mos shtypet!..” tashmë duhet ta kuptojnë që fëmijëve të tyre nuk po u bëjnë mirë, por po u bëjnë keq. Mbi të gjitha, edhe të rriturit duhet ta kuptojnë se po jetojnë si hedonistë në kurthin e kapitalizmit duke u kapluar nga joshja e këtij shekulli.

Në këtë kontekst, nëpër shkolla duhet të bëhet modelimi i vlerave dhe jo edukimi i këtyre të fundit! Nëse pandehim se mund t’ua mësojmë vlerat fëmijëve tanë me lojëra, poezi apo tri-katër afishe të përgatitura në lidhje me çfarëdo lloj vlere, për shembull, në lidhje me vlerën e posedimit të një qëllimi dhe ideali, gabohemi rëndë. Gjithashtu, nuk mund të besojmë dot që fëmijëve tanë t’ua mësojnë vlerat arsimtarët që lozin në lojërat e internetit përgjatë pushimit apo momenteve të lira të orëve të mësimi në klasë, që planifikojnë të takohen nëpër qendra

tregtare pasi të dalin nga shkolla, që vijnë në shkollë çdo ditë me rroba të markave të ndryshme dhe që flasin vetëm për argëtim, shëtitje e dëfrim kurdo që u jepet mundësia qoftë edhe përgjatë mësimi.

Ne nuk mund ta dimë se sa e mundur është që e gjithë njerëzia të shpëtojë nga kapitalizmi, i cili është një sistem i formuar mbi konsumin, por vendet evropiane, ekonomitë e të cilave kanë filluar të zhyten në batak për shkak të krizave, janë argumenti se ky sistem nuk është i shëndoshë. Shpresa që shtetet të bëhen kaq largpamëse sa që ta shohin apo të dëshirojnë ta shohin këtë ecuri, na duket si një imagjinatë. Luftërat që bëhen për një farë fasuleje siç ndodhin nëpër filmat fantastiko-shkencorë, është shumë e tmerrshme që të jenë fundi i njerëzimit që po e konsumon këtë botë dhe burimet e saj duke ngrënë e duke pirë.

Njerëzit e ndërgjegjshëm që mendojnë për veten, familjen, vendin dhe botën, duhet t'i thonë: "Ndal!", kësaj ecurie pa u shkatërruar dhe pa u kapluar edhe më shumë nga kjo çmenduri e konsumit dhe argëtimit. Në lidhje me këtë ecuri ka edhe statistika që tregojnë se nuk është një ecuri e mirë. Për shembull, amerikanët që nuk martohen, në mënyrë që të shëtisin dhe të jenë të lirë sa më shumë, janë ballë për ballë me probleme serioze shëndetësore dhe me rrezikun e vdekjes më të hershme. Sipas një studimi të bërë në Amerikë, është arritur në përfundimin se rreziku i vdekjes të meshkujt beqarë është 32% më i lartë se të meshkujt e martuar. Edhe sipas një studimi të botuar në revistën "American Journal of Epidemiology", është vënë re se ky rezultat te gratë është 23%. Madje, rreziku i vdekjes së beqarëve në moshën 30-39-vjeçare ka dalë 128% më i lartë se të martuarit në të njëjtën moshë. Ndërsa rreziku i vdekjes së beqarëve mbi moshën 70 vjeçare është vërejtur se rezultoi 16% më i lartë se të ata të martuarit.

Shkencëtarët në "Universitetin Louisville", kanë studiuar edhe 90 punimet e bëra përgjatë këtyre 60 viteve të fundit në lidhje me këtë çështje. Ata kanë marrë në studim 500 milion njerëz. (Në këto punime, njerëzit e divorcuar nuk janë konsideruar si beqarë.)

Edhe shifrat e obezitetit janë në një shkallë alarmuese edhe në vendin tonë ashtu siç janë edhe në Amerikë dhe Evropë. Në një studim të botuar në revistën angleze "The Lancet", tregohet se obeziteti në të gjithë botën ka ndikuar të rreth 500 milion njerëz të rritur. Gjithashtu thuhet se obeziteti është shtuar dy herë më shumë në 28 vitet e fundit. Në këtë studim thuhet se kjo sëmundje ka ndikuar të 205 milion burra dhe 297 milion gra.

Lufta me sëmundjet e shekullit si zemra, damarët, tensioni, sheqeri, kolesteroli etj., në shoqërinë ku

"njerëzit jetojnë për të ngrënë dhe nuk hanë për të jetuar", po i konsumon tepër buxhetet e njerëzve dhe të shteteve. Kjo është pjesa që reflekton në shifra e rezultateve me të cilat përballesh njerëzit e filozofisë së jetës me në qendër kënaqësinë (hedonizmi i Aristiposit).

Një filozofi epikuriane që mbron kënaqësinë shpirtërore sigurisht që mund të konsiderohet si një rrugëzgjdhje për vështirësitë e njeriut në këtë botë. Nëse nuk bëjmë israf, nëse nuk e çojmë dem kohën, nëse prodhojmë ndonjë gjë, nëse bëjmë ndonjë gjë për njerëzit e tjerë, nëse bëhemi të drejtë, të ndershëm, ndihmues dhe të ndërgjegjshëm, atëherë ka një lloj kënaqësie që mund ta ndiejmë në thellësitë e shpirtit tonë. Kjo kënaqësi mund të jetë edhe një faktor i fuqishëm që e bën njeriun të zgjedhë të mirën dhe të bukurën.

Ndërsa për ne myslimanët, asnjë kënaqësi fizike apo shpirtërore nuk mund të jetë dhe nuk duhet të jetë një gjë më e rëndësishme se fitimi i kënaqësisë dhe dashurisë së Allahut Teala. Madje ne, argëtimin dhe dëfrimin që na e ka lejuar Ai, e kërkojmë brenda kufijve që ka vendosur Ai. Ne e dimë se, ngaqë jemi njerëz, kemi nevojë edhe për argëtim e kënaqësi. Hamë, pimë, argëtohemi dhe martohemi, por të gjitha këto e kanë një kufi. Kur ne e përjetojmë këtë kënaqësi fizike brenda këtij kufiri, në të njëjtën kohë përjetojmë edhe kënaqësinë shpirtërore që na e jep ky kufi.

Sipas mendimit të Prof. Nevzat Tarhanit, nëse njeriu e kalon me argëtim më shumë se 20% të kohës, përveç gjumit", atëherë kjo është në kundërshtim me natyrën psikologjike të njeriut. Zbavitja e njeriut deri në 20% të ditës është e mjaftueshme për sa i përket kënaqësisë që jep argëtimi. Perceptimi i këtij argëtimi ndryshon nga njeriu te njeriu. Për dikë mund të jetë argëtim ndjekja e një filmi apo organizimi i ndonjë loje, për dikë tjetër mund të jetë ndonjë gjë e zakonshme. Të lexuarit e një libri për një student që po përgatitet për provime, kryerja e pazarit për kuzhinën nga gruaja që është mërzhitur me punët e shtëpisë, shëtitja e familjes me makinë duke e çuar në ndonjë vend nga ana e burrit që është mërzhitur në punë, mund të perceptohen si argëtim. Madje, ka edhe njerëz që e konsiderojnë si argëtim preokupimin me ibadet, dhikër dhe lexim të Kuranit Fisnik.

E vërteta se liritë tona janë të kufizuara me përgjegjësitë që kemi ndaj vetes, njerëzit që na rrethojnë dhe Krijuesit dhe vlerat e qëllimet që i caktojnë këto përgjegjësi, janë faktorët më të fuqishëm që mund t'i mbrojnë fëmijët, të rinjtë dhe të rriturit nga rënia në kurthin e hedonizmit. Shikimi i të drejtës sonë për t'u argëtuar, mbart një rëndësi të veçantë për sa i përket lumturisë së individit, familjes dhe shoqërisë.



ZJARRI i zemrës

— Fatih Garxhan —

Ishte një mëngjes të diele me diell. Zoti Ollxhaj bashkë me bashkëshorten e tij përgatitën një tryezë mëngjesi të mrekullueshme. Djathëra, byrekë dhe ushqime të ndryshme...

Zoti Ollxhaj shkoi me mirësjellje pranë birit të tij. Ai po flinte si qengj. Për pak kohë e pa i mahnitur dhe pastaj tha duke pëshpëritur:

“Sa i bukur që je!..”

Këmbët që i kishin dalë jashtë jorganit, sikur thoshin: “Eja dhe na gudulis!” Edhe zoti Ollxhaj nuk i fali sigurisht...

-Babi! Ndalo babi! Të lutem mos më gudulis!

-A do të ngrihesh? Apo nuk do të ngrihesh?

-U ngrita! U ngrita! Të lutem ndalo!

-Eja pra, ngrihu shpejt!

-Babi, po ia gudulis këmbët edhe motrës.

-Në rregull, eja! Shshshsh!..

-Së pari unë!

-Në rregull!

.....

Të gjithë pjesëtarët e familjes gjendeshin në tryezën e ngrënies. Zoti Ollxhaj ishte shumë i lumtur. Çfarë mund të ketë ndonjë gjë më të vlefshme për një baba se një familje e lumtur?

Dëshira më e madhe e tij ishte që t’u ndante kohë fëmijëve, të lozte me ta dhe të hynte në çdo moment të botës së tyre të vogël. Ai vetë nuk e kishte parë këtë nga familja e tij në fëmijëri, por sidoqoftë, ai dëshironte të sillej shumë më ndryshe ndaj fëmijëve të vet. Dhe ashtu ndodhi.

Në muajt e verës shkonte nëpër shëtitje, kam-

pe dhe pushime bashkë me fëmijët e tij, ndërsa në muajt e dimrit shkonte në kinema, teatro dhe aktivitete të ndryshme...

Vitet kaluan...

Zoti Ollxhaj, i cili i edukoi fëmijët e tij të informuar mirë nga çdo lloj kulture popullore, me krenarinë që e merrte nga edukimi që u kishte dhënë fëmijëve si një baba, i martoi vajzën dhe djalin e tij duke pasur thjesht disa muaj ndërmjet. Fëmijët e zotit Ollxhaj i zgjodhën vetë partnerët e tyre. Ndërsa ai ndjente shumë respekt për zgjedhjet që bënë ata. Përgjatë gjithë procesit çdo vendim ua la atyre dhe çdo gjë që do të merrej, u mor pa asnjë mangësi. Tashmë, dëshira e vetme e tij ishte që të dilte në pension dhe ta kalonte kohën me nipërit dhe mbesat si një gjysh i dashur.

Kaluan rreth shtatë-tetë muaj. Në një kohë mbrëmjeje vajza e tij erdhi me një valixhe në dorë. Sytë i kishte të mbushur plot me lot dhe menjëherë u hodh në krahët e babait të saj, i cili i hapi derën:

“Nuk mundem më, baba. Tashmë e kanë kaluar cakun ato që bën ai. Edhe unë nuk e lejova që të më poshtëronte. Andaj dola dhe erdha këtu.

“Ëëë, sigurisht bijë. Mirë ke bërë. Eja brenda! Mos qaj tashmë!..”

Zoti Ollxhaj nuk dinte çfarë të bënte. Gjëja e vetme që dinte ishte se ai duhej të sillej me qetësi:

“Bijë, urdhëro, ulu! Qetësohu pak po deshe! Flasim më vonë, mirë?”

“Baba...”

Vajzën e zotit Ollxhaj e kishin mbuluar lotët dhe po qante me dënësë. Zotit Ollxhaj ia copë-

tonte zemrën fakti që nuk mund të bënte diçka për bijën e tij.

Pasi vajza e zotit Ollxhaj u qetësua pak, filloi t'i tregonte ato që i kishin ndodhur.

Zoti Ollxhaj u habit pa masë. Gjërat që ia dëgjuan veshët, nuk ishin aspak të rëndësishme. Çfarë të thoshte?.. Andaj vendosi të duronte dhe i tha të bijës:

-Bijë! A ke ndonjë gjë tjetër për të na treguar?

-Çfarë të kem më shumë baba? Çfarë të kem më shumë?

Zoti Ollxhaj i gëlltiti ato që deshi të thoshte. Por sidoqoftë u shpreh:

-Ah bija ime e shtrenjtë. Koha është ilaçi i çdo gjëje. Andaj shko në dhomën tënde dhe çlodhu! Pastaj do të shohim se ç'mund të bëjmë...

Pasi bija e tij kaloi në dhomën e saj, zoti Ollxhaj bashkë me bashkëshorten e tij shkuan në dhomën e ndenjës. Ata qëndruan aty për orë të tëra pa i thënë asnjë fjalë njëri-tjetrit. Drita zbardhi. Zoti Ollxhaj i telefonoi pronarit të tij, i tregoi për gjendjen dhe i kërkoi leje.

Të dy bashkë përgatitën një mëngjes të mirë, në mënyrë që vajzës së tyre t'i rregullohej morali. Ata pritën me minuta të tëra në krye të tryezës. Vajza e tyre erdhi, u ul në tryezë, hëngri dy-tri kafshata dhe u ngrit menjëherë. Ata nuk i pyeti për asgjë. Thjesht tha:

-Hëmmm... Qenka bërë super mami! Të lumshin duart!

-Të bëftë mirë, bijë! Unë të kam mësuar që të përgatisësh një mëngjes të tillë. A i ke përgatitur ndonjëherë burrit tënd mëngjes si ky?

-Çfarë t'i përgatis atij moj? Përveç të tjerash, ai dilte shumë herët në punë. Mos do të zgjohesha në atë orë dhe t'i përgatisja mëngjes atij?

Zoti Ollxhaj dhe bashkëshortja e tij e panë njëri-tjetrin në sy. Bashkëshortja e zotit Ollxhaj ishte pak më e guximshme në ato momente:

-Bijë! Babai juaj ka shkuar për vite të tëra në punë me ezanin e mëngjesit. Unë jam ngritur çdo ditë dhe i kam përgatitur mëngjesin. Asnjëherë nuk e ke parë këtë?

-Nuk e di! Babai asnjëherë nuk gjendej në shtëpi kur zgjoheshim ne. Vetëm ditëve të diela gjendej në shtëpi. Edhe ato ditë gjithmonë të ndihmonte ty. Ndërsa ky i imi asnjëherë nuk më ka ndihmuar.

-Bijë, mos më keqkupto, por gjashtë ditët e javës unë ia përgatisja atij ushqimin e mëngjesit, i vishja xhaketen dhe e shikoja nga dritarja derisa të largohej nga sokaku ynë. Edhe ai gjithmonë më ka ndihmuar mua. Po ti? A i ke përgatitur mëngjes

qoftë edhe një herë burrit tënd?

-Çfarë do të thuash me këtë? Mos jam unë fajtore tani?

-Jo bijë. Unë nuk desha të thosha këtë.

-Atëherë nuk po ha! Desha të ha dy kafshata, edhe ato...

Zoti Ollxhaj, ndoshta për herë të parë, i tha me një ton zëri shumë të vendosur:

"Bijë, ulu në tryezë dhe mbaroje ushqimin tënd! Nëna jote nuk të tha ndonjë gjë të keqe."

Vajza e tij u habit shumë, sepse kjo ishte një sjellje që nuk e kishte parë asnjëherë nga babai i saj. Ajo u kthye nga babai i saj dhe e pyeti:

-Në vend që të më mbështesësh, po më nxelesh, ashtu baba?

-Kurrë nuk është ashtu. Për shkak të gjendjes në të cilën je, akoma nuk të kam thënë asgjë. Ama dhimbja që ke, nuk të jep të drejtë që të mos e respektosh nënën tënde.

-E di që s'doni t'ia dini për mua. Ja pra, s'do të ha.

Vajza e zotit Ollxhaj shkoi në dhomën e saj dhe e kyçi derën.

Bashkëshortja e tij i tha:

-Çfarë i thamë tani ne asaj?

-Ndalo pak dhe ta lëmë në hallin e vet! Ajo nuk e di se çfarë po bën!

* * *

A bie ndonjëherë zilja e derës kaq me shumë dhimbje? Ja që ra! Ishte mesi i natës. Zoti Ollxhaj menjëherë shkoi për të hapur derën:

-Kush është?

-Jam unë, baba.

-Bir! Mirë se erdhe!

-Për fat të keq, baba, nuk kam ardhur aq mirë.

-Eja një herë dhe hyr brenda.

Zoti Ollxhaj nuk e dinte nëse zemra e tij mund ta përballonte edhe një lajm tjetër të keq.

-Urdhëro bir! Qetësohu dhe merr frymë njëherë!

Edhe bashkëshortja dhe vajza e tij u zgjuan kur e dëgjuan zërin e ziles. Ata u mblodhën në dhomën e ndenjës. Askush nuk po fliste. Për pak kohë të gjithë po rrinin të heshtur. Zonja e shtëpisë tentoi e para për ta prishur këtë heshtje:

-Unë po bëj një kafe.

-Bëje grua, bëje! Do të na bënte shumë mirë.

Zoti Ollxhaj ishte shumë i shqetësuar:

-Bir, a dëshiron të na tregosh se çfarë ka ndodhur?

-Me thënë të drejtën, nuk dua të flas fare, por mendoj se do ishte mirë të dinit çdo gjë në kohën e saj. Kur u ktheva nga puna, desha t'i bëja një surprizë gruas sime. I mora një dhuratë. Kur arrita në shtëpi, hyra brenda ashtu siç duhet hyrë. Ajo po fliste në telefon dhe nuk më dëgjoi kur hyra brenda. Atë e dëgjova për pak kohë. Pasi e dëgjova me vëmendje, vura re se po fliste me një mashkull tjetër. Edhe ajo e pranoi këtë. Pastaj filloi të më godiste me fjalë duke më thënë se nuk interesohesha mjaftueshëm për të... Ç'na qenka:

"Unë gjithmonë paskam dalë me shokun tim etj., etj..." Me thënë të drejtën, do t'i bëja shumë gjëra, por sidoqoftë rezultati nuk do të ndryshonte. Për këtë arsye, i thashë të përgatitej dhe e çova te shtëpia e babait të saj. Po të rrija vetëm, do të çmendesha. Prandaj edhe unë erdha te ju. Me sa duket, kjo është më e drejtë...

Zoti Ollxhaj dhe bashkëshortja e tij e panë njëritjetritin në sy plot dhimbje. Zoti Ollxhaj i tha:

-Sigurisht që ke vepruar shumë mirë, bir. Po familjes së saj, a i the gjë?

-Jo.

-A dëshiron që të flas unë me ta?

-Ti e di më mirë, baba. Edhe sipas meje, do të ishte mirë po t'u telefonoje ti. Sepse unë mund të nxehem dhe mund të shprehem keq!..

-Në rregull, bir.

Zoti Ollxhaj tashmë mezi po duronte që të mos i kalonte kufijtë e qetësisë. Në fund, vendosi t'i telefononte mikut të tij dhe i tregoi për ato që kishin ndodhur. Edhe pala tjetër i tha se gjendja në të vërtetë është pak ndryshe, se vajza e tyre kishte dashur t'i jepte një mësim dhe se edhe ata dëshironin të takoheshin.

Zoti Ollxhaj e çoi të birin dhe vajzën e tij në dhomat e tyre. Pastaj i puthi në faqe siç pati vepruar në fëmijërinë e tyre. Për herë të parë zemrës së tij i erdhi kaq e rëndë një puthje.

Bashkë me bashkëshorten e tij, përsëri pritën dritën e mëngjesit. Kur filloi të thirrej ezani, bashkëshortes së tij i tha:

"Unë do të shkoj në namaz. Ndërsa ti përgatit një mëngjes të mirë. Ne duhet të jemi të fortë sa të kemi mundësi. I vetmi ku mund të mbështetemi është Allahu i Lartësuar! Sigurisht se Ai do të na japë edhe durim."

Zoti Ollxhaj doli nga shtëpia e tij sikur po arratisesh. Ai nuk pati marrë edhe abdest. Shkoi te shatërvani i xhamisë dhe mori abdest i qetë. Çdo gjymtyrë e tij që prekej nga uji i abdestit qetësohej

dhe trupi i gjente rehati. Sikur diçka po e ndihmonte. Kur po vishte çorapet, aty erdhi shoku i fëmijërisë së tij:

-Çfarë të ka ndodhur Ollxhaj? Asnjëherë nuk të kemi parë në këto anë në këtë kohë. Ose gjendeshe në shtëpi, ose gjendeshe në punë. Mos vallë ke dalë në pension?

-Jo, jo, akoma nuk kam dalë në pension. Jam me leje.

-Ti je me leje!? Ti rri në shtëpi!?

-Jo, jo, këtë herë nuk është ashtu!

Shoku i tij, zoti Muxhahiti e kuptoj se kishte diçka që nuk shkonte:

-Pa më shiko pak? A je mirë?

-Mos më pyet Muxhahit! Këto dy ditë ma hëngëren jetën.

Gjendja e zotit Ollxhaj sikur thoshte:

"Ah sikur të më pyes dikush, në mënyrë që t'i tregoj gjithçka dhe të qetësohem." Atij i erdhi shumë mirë që u takua me shokun e tij të vjetër.

-Atëherë më trego, i nderuar! Kujt do t'i tregosh tjetër, nëse nuk më tregon mua?

Zoti Ollxhaj i tregoi për të gjitha që kishin ndodhur. Zoti Muxhahit, i cili e dinte shumë mirë se si kishte edukuar zoti Ollxhaj fëmijët e tij, i tha:

-Me të vërtetë, ti i ke edukuar me shumë sinqeritet ata, por një mangësi shumë e madhe që t'i ke pasur në jetën tënde, ka gjetur vend të plotë edhe në jetën e atyre. Miku të flet fjalë të hidhura vëlla. Po deshe edhe mund të prekesh! A ke falur ndonjëherë dy rekat namaz me fëmijët e tu?

-Jo...

-A të kanë parë ndonjëherë fëmijët të lexosh dy rreshta nga Kurani Fisnik?

-Ti sikur ishe një baba social!.. Shumë herë të kam folur për këtë. Mos më keqkupto! Nuk dua të zbrazem, sepse edhe mua më erdhi shumë keq. Fëmijët e tu i dua si fëmijët e mi, por ju ndiqnit telenovelat familjarisht duke pohuar se është aktivitet social. Atëherë, çfarë të bëjnë fëmijët e tu? Çfarëdo që kanë mësuar, i kanë parë nëpër telenovela. Damarët e zemrave të tyre gjithmonë u ushqyen me rregullat e asaj bote të ndyrë. Edhe ti gjithmonë përpëliteshe duke thënë: "Akoma nuk kam bërë më të mirën për fëmijët e mi." Asnjëherë nuk të erdhi në mendje që t'i mësoje ata të mjaftohen me atë që kanë. Tani çfarë faji kanë ata? Çfarëdo që kanë parë, kanë tentuar të bëjnë. Ti dhe bashkëshortja jote, me të vërtetë keni flijuar shumë për ata. Çdo gjë ju e keni bërë. Atyre nuk u latë asnjë gjë për të bërë. Edhe ata u mësuan duke menduar se çdo punë mund të bëhet nga dikush

tjetër. Fëmijëve të tu nuk u dhe asnjë përgjegjësi! Përse? Sepse të dhimbseshin dhe mendoje se do t'i lëndoje! Po tani kush i lëndoi?

-Ke të drejtë vëlla! Gjithmonë më ke thënë, por ja që s'të kuptova dot. Tani po më vijnë para sysh ato kohëra... Çfarë të të them? Ja që njeriu qenka shumë i dhënë pas fëmijëve. Çdo njeriu fëmijët e tij i duken të magjishëm... Edhe unë vepra ashtu, në mënyrë që të më donin sa më shumë fëmijët e mi...

-Birit tënd nuk i dhe qoftë edhe një faturë për ta paguar. Atij nuk i dhe qoftë edhe qesen e mbe-turinave për ta hedhur në kosh. Vajza jote nuk ka hekurosur qoftë edhe një këmishë. Kështu që asnjëherë nuk e mësoi dot se çfarë janë punët e shtëpisë. Këmbët e atyre asnjëherë nuk prekën në tokë. Ata gjithmonë kanë jetuar në shpatullat e tua. Ja, tani të duhet të bësh diçka.

-Më ndihmo vëlla! Zemra po më digjet flakë. Fëmijët janë në shtëpinë time dhe mua nuk po më vjen aspak për të shkuar në shtëpi!

-Eja! Së pari le të falim namazin. Pothuajse do të fillojë falja e farzit, sepse koha ka ardhur.

* * *

Pas namazit, të dy shokët e vjetër u ulën në një stol që gjendej në bahçen e xhamisë. Zoti Muxhamit i tha:

-Tani, i nderuar! Së pari qetësohu! Çdo gjë e ka një zgjidhje. Andaj më trego me detaje!..

Zoti Ollxhaj ia tregoi çdo gjë që dinte me të gjitha detajet.

-Shiko vëlla! Tani merri fëmijët e tu përballë teje, bëj atë që nuk e ke bërë deri më sot dhe vendosua këmbët në tokë. Elhamdulillah që jemi të lirë në vendin tonë për ta zbatuar fenë. Feja jonë islame ka dhënë zgjidhje për çdo aspekt të jetës. Nëse ne i zbatojmë siç duhet ato rregulla, me lejen e Allahut, lumturia nuk është e largët që në të dy botët. Nëse është e nevojshme, mund të shkojmë bashkë për t'u takuar me mikun tënd. Le ta dëgjojmë një herë edhe atë. Ndoshta tabloja nuk është aq keq sa pandeh. Fëmijët, me dashje apo pa dashje, mund të kenë treguar mangët apo tepër. Tani duhet të jesh më i fortë se kurrë, sepse momenti në të cilin fëmijët kanë nevojë të vërtetë për ty, është ky moment...

-A thua se mund t'i rregullojmë?

-Përse jo? Së pari le të shkojmë dhe të takohemi me mikun tënd. Nëse nijeti është i pastër, Allahu na ndihmon. Fëmijët e tu janë fëmijë të mirë. Do të shikosh vëlla, këtë problem do ta kalosh më lehtë seç e mendon. Hajt Allahu na ndihmoftë!

-Inshallah, vëlla! Allahu qoftë i kënaqur me ty! Më qetësove...

-Ky është bereqeti i namazit... Andaj, ti dhe fëmijët e tu kapuni pas këtij litari, sepse pasi ta shijoni, në të vërtetë, nuk do ta lini më. Mirë mbetsh vëlla!..

-Allahu qoftë i kënaqur me ty vëlla! Këtë mirësi nuk do të ta harroj asnjëherë.

-Akoma nuk kemi bërë asgjë. E rëndësishme është që t'i rregullojmë këto probleme. Mirupafshim...





PËRSE NUK EDUKOHEN NJERËZ CILËSORË?



— Ajdën Tallaj —

Kjo është një çështje për të cilën flitet shpesh në të gjitha klasat e shoqërisë:

Përse nuk edukojmë dot njerëz që i posedojnë vlerat kryesore, punëtorë dhe të pajisur mirë? Si do të jetë gjendja jonë? Përse nuk nxjerrim dot njerëz produktivë dhe të aftë edhe pse kemi shumë mirësi e mundësi? Mos vallë duart e pamëshirshme të dikujt na kanë hedhur në këtë mjerim dhe poshtërim? Këtë ecuri të keqe të vjetrit e kanë pas quajtur “kahti rixha / mungesa e burrave”. Ne nuk jemi të pashpresë, por shpesh herë të rinjtë nuk po e mbushin dot vendin e të vjetërve që po shpërngulen në botën tjetër. Përderisa të mos ketë përpjekje në shkallë të gjerë për sa i përket çështjes së kriterëve të njeriut cilësor dhe të mos investohet për këtë, mjedisin tonë e presin vetëm vështirësi.


Në ditët e sotme, për fat të keq, edhe pse flasim mjaft për plan e program, nuk mund të themi se ia dimë vlerën kohës që është një thesar i madh për punime produktive. Në shumë shtëpi ka vend për mobilie të çdo lloji, por nuk ka vend për një bibliotekë. Për këtë arsye, bota artificiale na ka rrethuar nga të katra anët.

Menjëherë le ta pohojmë se, që nga koha kur jemi bërë si të dehur pas perëndimit dhe pas push-

timeve, humbjeve e copëtimeve kemi filluar të bëhemi të huaj për kulturën themelore dhe civilizim tonë. Të mos harrojmë se modernë nuk mund të bëhemi duke mohuar historinë dhe vlerat kryesore. Po ashtu, modernë nuk mund të bëhemi duke kopjuar dhe me racizëm.

Njeriu, i cili është krijesa më e nderuar, tashmë është sjellë në një gjendje konsumatori që i mbyll sytë ndaj nevojave të tij të domosdoshme. Ndërsa arsimit është kthyer në një makinë që i vë njerëzit në gjumë. Emri i gënjeshtres është bërë politikë. Premtimet për shpëtim janë shndërruar në një pjesë teatri. Tashmë nuk është ndyrë vetëm mjedisi, por janë ndyrë edhe të gjitha vlerat tona kulturore.

Në ditët e sotme kërkohet një mund dhe përpjekje shumë e madhe për t’ua dhënë të rinjve tanë një ideal dhe qëllim, sepse me sistemin që zbatojmë qoftë individualisht apo qoftë si shoqëri kemi sjellë në jetë një brez që ndjehet aq rehat saqë shumica e atyre që e përbëjnë këtë brez nuk e kuptojnë dot se çdo gjë e ka një çmim dhe përgjegjësi. Bota e kufrit është bashkuar dhe po bën padrejtësi që të ngrin gjakun, në mënyrë që bota islame të copëtohet dhe të shndërrohet në kafshata të vogla. Në këtë situatë, pa humbur aspak kohë, patjetër duhet t’u japin të rinjve tanë idealin për t’u



Si mund të jemi të sigurt për të ardhmen tonë përderisa krahas të dhënave të dobishme e të sakta të mos japim edhe edukimin e fortë që e mban njeriun me personalitet dhe me gjallëri nga çdo aspekt?

bërë robër të devotshëm ndaj Allahut të Lartësuar dhe për t'u bërë një mysliman i sinqertë që punon natë e ditë në rrugën e mirësisë.

Aftësitë e mira janë thjeshtë një imagjinatë nëse nuk ka besim dhe vepër. Shikoni cilësitë e njeriut që kërkohen dhe duhen në profesionin, punën dhe fushën e tij: Të jetë besimtar, i mençur, të ketë vizion, të jetë i zgjuar, i sjellshëm dhe i butë.

Ky njeri di të mësojë dhe t'i mësojë të tjerët. Ai nuk është xheloz dhe lajkatar ngaqë qëllimi i tij është që ta kalojë me lehtësi urën e kësaj bote. Gjithashtu vepron duke marrë masa dhe me kujdes. Ai, me çdo gjendje të tij, është burim mirësia e begatie për çdo lloj njeriu. Ai kërkon dijen më të saktë dhe e bën punën në formën më të përsosur.

Si mund të jemi të sigurt për të ardhmen tonë përderisa krahas të dhënave të dobishme e të sakta të mos japim edhe edukimin e fortë që e mban njeriun me personalitet dhe me gjallëri nga çdo aspekt? Realiteti po kërkon njerëz të ndershëm, të kulturuar, me kapacitet dhe që i besojnë vetes. Dhjetë vetë gjysmë të edukuar nuk mund ta mbushin dot vendin e as një personi cilësor. Mbi të gjitha, vendi i mësimin nuk është vetëm shkolla. Prandaj ne duhet të mbartim emocionin për ta shndërruar çdo vend dhe mjet në mundësi edukimi.

Të mos harrojmë se gjyshërit tanë edukonin njerëz të zgjedhur, durimtarë, të qëndrueshëm dhe të devotshëm në kuvendet shpirtërore që realizoheshin me mësim dhe ligjërata fetare. Në ato mësim gjendej edhe padishahu dhe i kontrollonte dijetarët. Nisur nga ky këndvështrim,

nëse ia hapni rrugët njeriut cilësor, ai do të arrijë të gjejë rrugët dhe metodat e rinovimit të vetes në çdo moment, të ripërtëritjes së dijes dhe të nënshtrimit të nefsit.

Njeriu i pjekur që i do njerëzit si vëllezër dhe që duhet nga ana e tyre është si ushqimi. Përparimi material dhe shpirtëror është i pamundur pa atë. Çështjet që i urren më së shumti njeriu cilësor janë punët boshe, budallallëku i shtirjes, mburrja dhe përpjekja për pozitë. Njeriu cilësor është si xhevahiri ndërmjet gurëve. Ai merr frymëzim nga sistemi dhe madhështia e pafundme e gjithësisë. Ai asnjëherë nuk preokupohet me aventura të padobishme dhe të panevojshme. Ndërsa shërbimi fetar është simboli i tij. Ai i mban premtimet dhe nuk shkon me vonesë në takime. Gjëja që e bën më me shumë dëshirë është ndihma ndaj të tjerëve. Ai i njej shumë mirë detyrat që ka kundrejt familjes së tij në fillim dhe pastaj kundrejt të gjithëve. Marrëdhëniet që ka me njerëzit gjithmonë janë të matura. Njeriu me kapacitet i orienton njerëzit që e rrethojnë drejt kënaqësisë së Allahut Teala dhe rrugës për shërbim ndaj shoqërisë.

Detyra kryesore që i takon jo vetëm vendit tonë, por të gjithë botës islame është që të edukojë breza besimtarë dhe të fuqishëm që do të hapin një epokë të re dhe që do të jenë të aftë e të suksesshëm në të gjitha fushat që ka nevojë koha e sotme pa i humbur themelet e kulturës dhe civilizimit të tyre. E gjithë çështja është që të edukohen breza që u përgjigjen të gjitha nevojave të kohës pa hequr dorë nga dispozitat e Islamit.¹

1. Problemet e elitës besimtare, Botimet Majash, fq. 44.

XHAMIA AKSA

AMANETI I MUSLIMANËVE

— Naim Drijaj —

Ne nuk duhet të harrojmë se xhamia Aksa zë një vend të rëndësishëm në Islam. Ajo është xhami e dashur për vetë Allahun dhe të dërguarin e Tij. Ajo është xhamia nga drejtoreshin muslimanët për t'u falur në fillimet e fesë. Ajo është xhamia e tretë e shenjtë për muslimanët, pas Qabes dhe xhamisë së profetit (a.s.). Ajo është xhamia drejt së cilës udhëtoi Muhamed (a.s.) natën e Israsë. Nga aty ai u ngjit në udhëtimin e Miraxhit. Ajo është xhami, emri i së cilës ceket në Kuran dhe shoqërohet me epitelin "e bekuar".

Toka e Palestinës është djepi i shumë profetëve, është dëshmitare e shpalljeve hyjnore të zbritura nga Allahu gjatë historisë. Në dheun e kësaj toke kanë shkelur pejgamberët e Allahut: Hazreti Ibrahim, Luti, Ismaili, Is'haku, Ja'kubi, Musai, Davudi, Sulejmani, Iljasi, Jahjai, Zekerija, Isai e shumë të tjerë (paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi ta). Gjithashtu, në këtë tokë të shejtë jetuan dhe u varrosën shumë nga shokët e Profetit Muhamed (a.s.).

Kudsi, Jeruzalemi, është matësi i besimit dhe i sigurisë në tokë. Nëse Kudsi është i stabilizuar dhe i qetë, e gjithë bota është e tillë. Nëse është i trazuar, e gjithë bota përfshihet nga trazirat.

Në Kur'anin Famëlartë, teksa lexojmë fillimin e sures El-Isra, kuptojmë edhe më shumë për madhësinë dhe shenjtërinë që i ka dhënë Allahu Fuqiptotë, Xhamisë Aksa dhe Kudsi Sherifit në përgjithësi.

Zoti (xh.sh) thotë: "I lavdëruar qoftë Ai që e mbaroi robin e Tij (Muhamedin) natën nga Xhamia e Shenjtë (në Mekë) në Xhaminë e Largët (të Jeruzalemit), rrethinën e së cilës e kemi bekuar, për t'i treguar atij disa nga mrekullitë Tona." ¹

Duke komentuar ajetin e ndodhisë së Israsë, Imam Kurtubiu, thekson gjithashtu, se: "Aksa (arabisht: më e largëta), është quajtur kështu për distancën nga Mesxhidi Harami. Ishte xhamia më e largët në

1. El-Isra, 1

tokë për banorët e Mekës.”² (Afërsisht, distanca ndërmjet këtyre dy vendeve është 1400-1700 km).

1- Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Mos udhëtoni (me qëllim adhurimi) përveçse në tri xhami: për në Qabe, për tek xhamia ime, për tek xhamia el-Aksa.”³

Të gjithë dijetarët islam janë të mendimit se është e pëlqyeshme vizita e xhamisë El-Aksa për të kryer adhurimet islame si: namaz, i'tikaf etj.

Sipas statistikave në vitin 2015 Kudsi Sherifin e kanë vizituar 600.000 Amerikan, 400.000 Rus, 300.000 Francez. Dhe ndër vendet muslimane ata që e kanë vizituar më shumë Kudsën janë Turqit. Numri i vizitorve Turq është 26.000.⁴

2- Xhamia Aksa është faltarja e dytë, e ndërtuar mbi sipërfaqen e tokës.

Ebu Dherri (r.a) e ka pyetur Profetin Muhamed (a.s) se cila është xhamia e parë e ndërtuar në tokë? Profeti (a.s) i është përgjigjur: “Mesxhidul-Haram (Xhamia e Shenjtë e Qabes).” “Po pastaj cila xhami? Ka pyetur Ebu Dherri. “Xhamia El-Aksa (Xhamia e Largët)” tha Profeti (a.s) “Sa vite më pas është ndërtuar Xhamia El-Aksa?” pyeti përsëri Ebu Dherri. “40 vite” u përgjigj ai zotëri (a.s).⁵

3- Xhamia Aksa është Kibla e pare, pikëdrejtimi gjatë faljes i të gjithë muslimanëve.

Berra ibn Azib (r.a) ka thënë: ”Jemi falur me të dërguarin e Zotit drejt xhamisë Aksa për 16-17 muaj. Pastaj e kthyem drejtimin nga Qabja”.⁶ Pejgamberi Muhamed (a.s) edhe pas emigrimit të tij në Medine, ka falur namazin në drejtim të Jeruzalemit për 16-17 muaj (Afërsisht një vit e gjysëm).

4- Xhamia Aksa është toka, ku profeti Muhamed (a.s) realizoi udhëtimin e Israsë dhe prej andej u ngjiti në qiell, gjatë udhëtimit të Miraxhit. Gjatë Israsë, Profeti (a.s) udhëtoi i shoqëruar nga meleku Xhebrail (a.s) prej Mekës në Misxhidul-Aksa dhe që andej në sferat e larta qiellore.

Udhëtimi për në qiell mund të bëhej direkt nga Meka, por jo pa qëllim kalimi u bë pikërisht nëpër këtë stacion të shenjtë. Ky udhëtim i dha misionit të Profetit Muhamed (a.s) një përmasë tjetër dhe e lidhi atë me vargun e gjatë të profetëve. Në xhaminë El-Aksa, atë natë, janë tubuar të gjithë të dërguarit e Allahut dhe kanë falur namaz nën udhëheqjen e Profetit (a.s).

2. Imam Kurtubiu në Tefsirin e tij: “El-xhamiu li ahkamil-Kur'an.”

3. Buhariu, 2/60

4. https://www.youtube.com/watch?v=1BrLhvm7_K0&t=1289s

5. Buhariu, 4/162

6. Buhariu, 41 Muslimi, 525

Qëllimi kryesor i këtij tubimi, si asnjëherë më parë, ishte shenjë e vazhdimësisë së teuhidit, i cili ka qenë mesazhi i të gjithë profetëve dhe njëherazi, dorëzimi i udhëheqjes fetare në duart e Profetit të fundit, pasardhësit të Ismailit, për të dëshmuar se ai që do të ishte përgjegjës për xhaminë El-Aksa, tashmë ishte Muhamedi (a.s).

5- Profeti Muhamed (a.s) tregon se profeti Sulejman (a.s) kur e përfundoi rindërtimin dhe zgjerimin e xhamisë El-Aksa, i është lutur Allahut: (O Allah) Kush vjen në këtë xhami, jo me qëllim tjetër përveç namazit, pastroje prej gjynaheve si ditën që ka lindur nga nëna e vet!”.⁷ Pasi e tregoi këtë lutje të Sulejmanit (a.s) Profeti ynë, (a.s) tha: “Shpresoj që Allahu t’i jetë përgjigjur lutjes së tij (Hz. Sulejmanit).”⁸

6- Në një rast, një nga sahabet e pyeti Profetin (a.s): “O i Dërguari i Allahut, na trego për Bejtul-Makdis!” Profeti (a.s) mes tjerash, tha: “Udhëtoni drejt saj dhe faluni në të, sepse një namaz atje është sa një mijë namaze në xhamitë e tjera!” “E nëse nuk mundem të udhëtoj drejt saj?” tha sahabja e nderuar. “Atëherë dhuro vaj për të ndricuar kandilat e saj, sepse do të kesh shpërblim sikur të shkosh drejt saj.”⁹

Pejgamberi (a.s) na tregon se vlera e një namazi në këtë xhami ka vlerën e 250 namazeve në xhamitë e tjera. “Një namaz në xhaminë time është më i mirë se katër namaze në të (Bejtul-Makdis).”¹⁰

Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Një namaz në Mesxhidi Haram ka vlerën e njëqind mijë namazeve, ndërsa një namaz në xhaminë time ka vlerën e një-mijë namazeve, ndërsa një namaz në Bejti Makdis ka vlerën e pesëqind namazeve”¹¹

Kur e hodhën Ibrahimin (a.s) në zjarr, shikuan një milingonë që mudohej të mbante ujë dhe t’ia hidhte zjarrit. I thanë: Oj e mjerë, po ç’dobi mund të sjellë ky pak uji yt?! Këtë zjarr e fik veç një det i madh. Tha: Të paktën dua t’i tregoj Zotit se unë isha kundër, se u radhita me të mirët aq sa pata mundësi.

Sot, Kudsi Sherifë thërret me madhështinë e tij mbarë umetin islam, për t’u solidarizuar me të, për t’u lutur bashkarisht, për paqen, për harmoninë, për drejtësinë, për besimin, për lirinë, për të ardhmen!

7. Nesaiu, 2/34

8. Ibn Maxhe, 1/452

9. Ibn Maxhe, 1/451

10. Hakimi, 4/554

11. Tabarani

Vetitë shëruese të Boronicave të Veriut

PSE ËSHTË SUPERFRUTI SHQIPTAR MË I KËRKUAR

Boronicat janë të ëmbla, ushqyese dhe shumë të shëndetshme. Këto fruta kaq të vogla i bëjnë kaq mirë trupit dhe mendjes sonë.

Antioksidantët që gjenden te boronicat janë aq të forta sa janë të afta për të neutralizuar radikalet e lira që lidhen me zhvillimin e disa sëmundjeve kardiovaskolare apo tumorale.

Pa yndyrna dhe me vetëm 84 kalori për një kupë, boronicat janë të pasura me fibra që të mbajnë të ngopur për një kohë të gjatë.

Në Shqipëri boronicat kultivohen gjerësisht në trevat veriore të vendit.

Por, boronicat e Tropojës, Kukësit dhe Pukës e kanë më të lehtë të tregëtohen në Kosovë dhe Mal të Zi dhe që nga aty më pas shpërndahen në tregjet evropiane, sesa të zbresin poshtë në Tiranë apo dhe në çdo qytet tjetër në vend.

Arsyeja se pse boronicat nuk mbërrijnë dot në kryqytet dhe në çdo qytet të vendit është mungesa e dhomave frigoriferike për t'i mbajtur boronicat e freskëta.

Udhëtimi prej disa orësh në automjete të zakonshme do të ishte fundi i freskisë së boronicave veriore shqiptare.

10 VLERAT MË TË MIRA TË BORONICAVE

KANË PAK KALORI, POR SHUMË VLERA USHQYESE

Boronica është një frut i vogël me ngjyrë blu të purpurt. Boronica janë të vogla, rreth 5-16 milimetra në diametër, dhe një kurorë të vogël në majë.

Ato janë ndër manaferrat më vlerat më të mëdha ushqyese. Një kupë (148 gramë) boronica përmban; Fibër 4 gramë, 24% të nevojave ditore për Vitaminë C, 36% të nevojave për Vitaminë K, 25% të nevojave ditore për manganez. Ato kanë 85% ujë në përbërje.

JANË MBRETI I USHQIMEVE ANTIOKSIDANTE

Ato kanë kapacitetin më të lartë antioksidant ndër të gjitha frutat dhe perimet që konsumojmë zakonisht.

Flavonoidët e gjendur tek boronicat janë përbërësi më i mirë antioksidant. Është vërtetuar se këta përbërës rrisin nivelin antioksidues brenda trupit.





ULIN DËMTIMIN E ADN-SË, DUKE NDIHMUAR NË MBROJTJEN KUNDËR PLAKJES DHE NDAJ TUMOREVE

Dëmtimi i ADN-së është pjesë e jetës së përditshme. Thuhet se kjo ndodh dhjetra mijëra herë në ditë, në çdo qelizë të trupit.

Dëmtimi i ADN-së është pjesë e arsyes që ne plakemi dhe ky dëmtim luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e sëmundjeve tumorale.

Për shkak se boronicat kanë sasi të mëdha antioksidantësh, ato ndihmojnë të neutralizohen disa nga radikalet e lira që shkaktojnë dëmtimin e ADN-së tonë.

Në një studim që zgjati 4 javë, 168 pjesëmarrës pinë 1 litër përzierje të boronicës me lëng molle, çdo ditë. Në fund të studimit, dëmtimi oksidativ i ADN-së, për shkak të radikaleve të lira, u reduktua me 20%.

MBROJNË KOLESTEROLIN NË GJAK

Dëmtimi oksidativ nuk ndodh vetëm në qelizat tona dhe në ADN. Ky dëmtim është gjithashtu problematik kur lipoproteina (kolesteroli "i keq") oksidohet.

Në fakt, oksidimi i kolesterolit të keq ndikon shumë në zhvillimin e sëmundjeve të zemrës.

50 gramë boronica në ditë shërbyen për të ulur oksidimin e kolesterolit me 27% në disa pjesëmarrës të shëndoshë, pas një periudhe prej tetë javësh.

ULIN TENSIONIN E GJAKUT

Në një studim, individë me rrezik të lartë për sëmundje të zemrës vërejtën një ulje 4-6% të presionit të gjakut (tensionit të lartë), pas konsumimit të 50 gramë boronica në ditë, për tetë javë.

NDIHMJOJNË NË PARANDALIMIN E SËMUNDJEVE TË ZEMRËS

Është e rëndësishme të kuptohet se kur flasim për ulje të rrezikut përmes konsumit të boronicave, flasim për faktorët e rrezikut, jo për sëmundjet aktuale.

Në një studim të vitit 2013, 93,600 infermierë konsumuan shumë antocinisis (antioksidantë kryesorë që gjenden te

boronica) duke ulur me 32% rrezikun për atak të zemrës.

NDIHMJOJNË NË FUNKSIONIMIN E TRURIT DHE NË PËRMIRËSIMIN E KUJTESËS

Antioksidantët përbërës të boronicave duket se kanë ndikime pozitive në funksionimin e trurit duke vonuar edhe rënien e funksioneve të tij të lidhura me moshën.

Një studim që zgjati gjashtë vjet, ku morën pjesë 16,010 të moshuar vërtetoi se boronicat dhe luleshtrydhet vonuan plakjen me deri 2.5 vjet.

KANË EFEKT ANTI-DIABETIK

Boronicat kanë shumë më pak sheqer krahasuar me frutat e tjera.

Një kupë përmban vetëm 15 gramë sheqer natyral, aq sa një mollë e vogël apo një portokall.

PËRBËRËSIT E BORONICAVE NDIHMJOJNË NË LUFTËN KUNDËR INFEKSIONEVE URINARE

Boronicat përmbajnë substanca që mund të parandalojnë veshjen e mureve të fshikëzës nga baktere të ndryshme. Këto përbërës janë të dobishëm në parandalimin e infeksioneve të traktit urinar.

NDIHMJOJNË NË ULJEN E DËMTIMIT TË MUSKUJVE PAS STËRVIJTJES

Stërvitja e fortë për trupin mund të çojë në dhimbje të muskujve dhe lodhje. Kjo nxitet pjesërisht nga inflamacioni dhe stresi oksidativ në indet e muskujve. Është e qartë se boronicat janë tepër të shëndetshme.

Konsumi i boronicave mund të zvogëlojë dëmin që ndodh në nivel molekular, duke minimizuar dhimbjet dhe reduktuar uljen në performancën e muskujve.

Fakti që ato janë të shijshme, me ngjyrë të bukur dhe mund të shijohen si të freskëta edhe të ngrira, i bën ato edhe më të mira.



ZBULOHEN TRE PLANETE TË NGJASHME ME TOKËN ATO SILLEN RRETH NJË ORBITE 11 VJET DRITË LARG

Deri në tre planete – potencialisht shkëmborë si Toka – janë vërejtur rreth një ylli të vendosur relativisht afër sistemit tonë diellor – një sistem planetar që u ofron astronomëve mundësi intriguese në kërkimin e shenjave të jetës së jashtme.

Sipas mediave të huaja, përcjell Telegrafi, orbita e planetëve Gliese 887, i ashtuquajtur “yll xhuxh” i kuq sa gjysma e diellit, u identifikua 11 vjet dritë larg nga Toka – pikërisht në “oborrin” tonë, vetëm se më parë u potencua në terma kozmik, thanë studiuesit të premtën.

Vetëm 12 yje të tjerë janë më afër sistemit tonë diellor.

Njëri nga planetet sillet rreth orbitës së “Gliese 887”, çdo nëntë ditë dhe tjetra çdo 21 ditë. Ndërkaq

studimet thonë se njëri nga dy planetet, gjendet brenda asaj që quhet zona e banueshme, ose zona Goldilocks. Bëhet e ditur se temperatura e planetit është e qëndrueshme, as e ftohtë apo edhe e nxehtë.

Ndërkohë sa i përket planetit të tretë, ai rrotullohet rreth orbitës çdo 50 ditë dhe ndodhet në zonën e Goldilocks, megjithëse të dhënat nga studimet nuk janë konfirmuar ende plotësisht.

“Ato janë të ngjashme me Tokën, dhe ka gjasa të jenë në thelb sikurse planeti ynë, në krahasim me gjigantët e mëdhenj si Jupiteri dhe Saturni”, tha astronomja Sandra Jeffers, nga Universiteti i Gotingen në Gjermani, autore e këtij studimi.

NGROHJA GLOBALE: ARINJTË POLARË RREZIKOJNË TË ZHDUKEN DERI NË VITIN 2100

Arinjtë polarë mund të zhduken deri në fund të shekullit, nëse qeveritë nuk ndërmarrin masa për ngrohjen globale, parashikon një studim.

Sipas mediave të huaja, përcjell Telegrafi, shkencëtarët thonë se disa krijesa e kanë arritur kulmin e mbijetesës së tyre, derisa akulli i Arktikut po tku- rret.

Mishngrënësit mbështeten në akullin e detit të Oqeanit Arktik për të bërë gjah.

Derisa akulli thyhet, kafshët detyrohen të bredhin në destinacione të gjata, për të gjetur ushqim në mënyrë që të ushqejnë këlyshët e tyre.

“Nëse akullnajat shkrihen, arinjtë polarë nuk kanë ku të shkojnë”, tha Peter Molnar nga Universiteti i Torontos në Ontario të Kanadasë.

Sipas një skenari të lartë të emetimeve të gazrave serrë, ka të ngjarë që të gjithë përveç disa arinjve polarë të zhduken deri në vitin 2100, zbuloi studimi.



SKELETI ROBOTIK I JEP PËRDORUESIT FUQI TË DYFISHTA

Robotët mund të bëjnë punë të rënda, monotone dhe nuk lodhen asnjëherë. Por robotët ende nuk mund kenë inteligjencën dhe gjykimin e njeriut në qasjen ndaj punës. Tani ekziston një zgjidhje hibride: një skelet robotik që mund të vishet nga njeriu i cili i jep përdoruesit fuqi të jashtëzakonshme. Korrespondenti i Zërit të Amerikës Matt Dibble sjell më shumë hollësi.

Megjithëse duket si një personazh i filmave me superheronjë, skeleti robotik Guardian XO është gati për punë. Skeleti i jep përdoruesve një forcë më të madhe. Chris Beaufait drejton kompaninë Sarcos Robotics që ka prodhuar skeletin robotik.

“Kushdo që vesh Guardian XO mund të ngrëjë deri në 90 kilogramë. Skeleti shton forcën dhe rendimentin e përdoruesit. Përdoruesi kryen lëvizje normale. Nëse shkoni të kapni dhe ngrini diçka, skeleti reagon ndaj lëvizjes tuaj dhe të jep forcën e duhur për të bërë atë aktivitet.”

Skeleti robotik mbart peshën dhe e transferon përgjatë këmbëve në tokë. Mbjakta e 90 kilogramëve ndjehet si vetëm 4.5 kilogramë, thotë zoti Beaufait.

“Pavarësisht përmasave dhe forcës, të gjithë përdoruesit mund të bëjnë të njëjtën detyrë.

Gjatë një demonstrimi, pjestarët e audiencës patën rastin të shohin se si krahu robotik u hep atyre super-forcë.

Veshja e skeletit mund të kryhet brenda pak minutash dhe menjëherë reagon ndaj lëvizjeve të trupit të përdoruesit. Tara Scranton me kompaninë “Sarcos Robotics” po demonstron skeletin robotik.

“Ky robot është shumë intuitiv. Ndjek veprimet e mia.”

“Skeleti robotik ka një sistem kontrolli që mundëson çdo përdorues të komandojë robotët që të çlirojnë rrugën dhe roboti ndjek udhëzimet”, thotë drejtuesi i kompanisë Chris Beaufait.

Skeletët e parë robotikë mund të gjejnë përdorim në ushtri dhe kompanitë ajrore si dhe në ndërtimtari.

“Arsyeja e dytë më e zakonshme që dikush të humbasë punën është lëndimi i shpinës”, thotë zoti Beaufait.

“Ata dëmtohen ndërsa ngrënë pesha të rënda dhe kryejnë veprime të përsëritura. Skeletët robotikë mund të marrin barrën nga përdoruesit dhe eliminojnë dëmtimet.”

Megjithëse ky skeleton robotik do të ishte shumë i dobishëm për punët e shtëpisë, tani për tani ai do të përdoret nga industritë që mund të përballojnë një qera prej 100 mijë dollarësh në vit.





Ju ofron:
Kushte bashkëkohore,
ushqim cilësor dhe të kontrolluar,
staf të kualifikuar.

Ju mirëpresim!



Lagja Perash, Bulevardi Mehmet Pashë Plaku,
Pranë Xhamisë Perash, Shkodër
+355 67 47 39389

- 1 Staf arsimor cilësor
- 2 Kushte arsimore sipas standarteve të larta
- 3 Aktivitete sociale, kulturore dhe sportive
- 4 Klasa dhe laboratorë të kompletuar
- 5 Ambiente familjare në konvikt dhe cilësi në ushqim



CIKLI FILLOR
(djem dhe vajza)
NGA KLASA E **1**-RË
DERI NË KLASËN E **5**-TË



“Në sajë të mëshirës
së Allahut,
u solle butësisht
me ta (o Muhamed).
Sikur të ishe
i ashpër dhe i vrazhdë,
ata do të largoheshin
prej teje...”

(Al Imran, 159)